



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 KORRIK 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. JULA 2016. GODINE**

**KORRIK - JUL
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-109 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-071 o Budžetu Republike Kosova za 2016.godinu,
2. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-108 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-049 o finansijama lokalne vlasti,
3. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Centralne Banke Republike Kosova za 2015. godine.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të caktuar me vendim të Kuvendit në seancën plenare të mbajtur më 7 korrik 2016.

Në sallë janë të pranishëm aktualisht 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për ta vazhduar punën.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisionet parlamentare, në pajtim me vendimin e Kuvendit të datës 7 korrik 2016 e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit. Urdhëro!

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne biseduam edhe me shumicën e kolegëve të të gjitha partive. Unë propozoj që, meqenëse është punë afati është afati i fundit sot, më 14 korrik, që të futet në rend të ditës Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për huan ndërmjet KFW dhe Qeverisë së Kosovës për programin Masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal.

Nga kjo marrëveshje, nga ky projektligj përfitojnë një numër i konsiderueshëm i komunave tona.

Prandaj, ju kisha lutur që edhe me pëlqimin e kolegëve, shpresoj dhe të grupeve të tjera parlamentare, të futet në rend të ditës, normalisht edhe besoj që do të kemi vota të mjaftueshme, meqenëse duhen 2/3 së pari të futet në rend të ditës, pastaj edhe ta ratifikojmë këtë marrëveshje.

Unë kisha propozuar që meqenëse shumica e deputetëve jemi këtu, pra në numër të nevojshëm, të shkojë si pikë e parë, nëse jo, ndërkohë të sigurohet edhe t'i kemi deputetët ta votojmë nëse jo si pikë të parë, atëherë pikën tjetër në vazhdim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një propozim konkret të kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në të njëjtën kohë e ka përkrahjen të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosja”, po Shqipe Pantina, edhe për pikë të parë të rendit të ditës në qoftë se e votojmë do të futet pikë e parë e rendit të ditës.

Vetëm kisha kërkuar që nga 89 deputetë sa kanë qenë të nënshkruar, le të vijjnë se na duhen 81, 77 janë aktualisht. Urdhëro, zonja Pantina!

SHQIPE PANTINA: Nuk jemi kundër, kështu që në rregull është nëse futet në rend të ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe a ka deklarim? Urdhëroni, zoti Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste podržace predlog Parlamentarne grupe Demokratskog Saveza Kosova. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”. Urdhëro, zonja Balja!

DUDA BALJE: I Parlamentarna grupa “6+” podržava predlog LDK:

KRYETARI: Faleminderit! Emilija Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Pre tri dana je obeležena 21-godišnjica Srebrenice. 11 jul je datum koji nas podseća na ogromnu patnju, koji su ljudi u stanju naneti jedni drugima. Ubijeno je hiljade muškaraca, dece i starih osoba je terorizirano, zlostavljeno i isterano iz svojih domova.

Jedna veća grupa ljudi zloupotrebila je svoju moć i vlast da bi uništila Zajednicu Bošnjačkih muslimana. Srebrenica je kulminacija razorne kompanije ekstremnog režima nacionalista, čiji je cilj bio da unište temelj Bošnjačkog naroda u celoj Bosni i Hercegovini.

To nije bila spontana vojna operacija, niti delo nekolicine osvetničkih nastrojenih šovenističkih vojnika. Genocid u Srebrenici predstavlja rezultat namernog plana, smišljenog na najvišim niovima političkog rukovodstva toga vremena.

Poricanje genocida u Srebrenici predstavlja iskrivljeno prikazivanje činjenica i nepoštovanja najviših pravnih odluka dva međunarodna suda ali i velika uvreda za sve žrtve.

Da bi smo poštovali prošlost žrtve, ali i one koji su preživeli Srebrenicu moramo nazivati jednim imenom, a to je - genocid.

Da bi smo išli napred i gradili budućnost poštujući jedni druge, moramo se svi jednoglasno suprostaviti kada se genocid poriče.

Genocid je čin koji su izvršili zločinci. Njegove žrtve su trajni gubitak, a njegovi tragovi neprobolni i večni.

Prema tome, za žrtve nema i ne može biti nikakve satisfakcije, ni pravne, ni moralne, ni materijalne.

Tragičan čin se ne može korigovati, niti se njegovi efekti mogu nadoknaditi.

Moralnu traumę prati i psihička bol čoveka, bol majke Srebrenice i sve žene Bosne i Hercegovine, i ostalih članova porodica ubijenih.

Ta psihološka frustriranost ostaje kao trajna posledica poniženog čoveka, kome nije omogućeno da se bori za svoj opstanak na mestu u kojem je rođen i gde je živeo.

Srebrenica je bez sumnje jedna od najvažnijih etičkih pitanja savremene evropske civilizacije. Osim stravične tragedije, predstavlja i sramotu za međunarodnu zajednicu.

Srebrenica je ime za jedan neoprostivi zločin ali ona istovremeno i ime za žrtvu. To su Srebreničanke, jedinstvena populacija u savremenom čovečanstvu, one su najveća koncentracija majki bez sinova, supruge bez muževa, kćerki bez očeva, sestara bez braće.

Poštovani predsedniče,

Kolege poslanici,

Bez razlike na nacionalno i partijsko opredeljenje, sa moralnog i ljudskog aspekta, pozivam vas da svi zajedno usvojimo rezoluciju o Srebrenici i u našem Parlamentu, koji je Evropski parlament u Srazburu usvojio, te se 11 jul zvanično proglašava Danom sećanja na žrtve odnosno dan sećanja na genocid u Srebrenici, kao najveći ratni zločin u Evropi posle Drugog svetskog rata, u kojem je ubijeno više od 8.500 nevinih ljudi, i time pokažemo našu bratsku solidarnost sa jasnom porukom da se Srebrenica nikad ne zaboravi, ali da se takav genocid i zločin nikada nijednom narodu više ne dogodi. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Rexhepi! Ndoshta propozimi juaj duhet të diskutohet në një seancë tjetër plenare. Megjithatë falënderoj për vëmendjen që e ngrite për një krim të tillë të rëndë.

Tani rikthehem prapë. I kishim deklarimet e grupeve parlamentare.

Kërkohet deklarimi me votim për propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri. Në bazë të procedurave duhen 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje për shmangie nga rregullorja.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash propozimin:

82 deputetë kanë votuar, 80 janë për edhe 2 abstenime. Dy votat me dorë i mora për.

Atëherë miratohet propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri, për plotësimin e rendit të ditës dhe për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për huan ndërmjet KFW Frankfurt Amain dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin Masat e efijencës të energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë.

Shqyrtimi i këtij projektligjit radhitet në fillim të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për huan ndërmjet KFW Frankfurt Amain dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin Masat e efijencës të energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë

Shqyrtimi i këtij projektligji do të bëhet në pajtim me vendimin e seancës së sotme plenare.

Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është ratifikimi i marrëveshjes për huan ndërmjet Bankës Gjermane për zhvillim KFW dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin Masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë.

Kjo marrëveshje i mundëson Qeverisë së Kosovës të marrë hua nga KFW në vlerë deri në 2,5 milionë euro për sektorin e energjisë.

Kjo kredi është në përputhje me objektivat e programit të Qeverisë 2015-2018, ku theksohet se zhvillimi i sektorit të energjisë është kyç për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Me këtë marrëveshje Qeveria e bart huan në tërësi te komunat dhe siguron se huaja do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë.

Komunat e përfshira janë Ferizaj, Prishtina, Gjakova dhe Gjiçani.

Qeveria, komunat dhe KFW do të përcaktojnë detajet në lidhje me kushtet e huadhënies për secilën prej komunave si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja në marrëveshje të veçanta.

Interesi për shumën e kreditë do të subvencionohen nga fondet e grandet nga korniza, investimet e Ballkanit Perëndimor deri në vlerën prej 1 422 milionë euro.

Sipas Marrëveshjes, Qeveria do t'i bartë të gjitha taksat dhe pagesat e tjera publike që gjenerohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë që lidhen me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje.

Të gjitha institucionet që involvohen në zbatimin e kësaj marrëveshjeje kanë qenë të përfshira në negociimin e marrëveshjes ndërmjet KFW dhe Qeverisë së Kosovës, të përfaqësuara nga Ministria e Financave.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshjeje unë ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj për ratifikimin e marrëveshjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Tani, të nderuar deputetë,
Pas prezantimit të projektligjit hap debatin për diskutim në parim.
E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Projektligji, respektivisht marrëveshja e nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe KFW Frankfurt ka për qëllim të financojë aktivitete që kanë të bëjnë me masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike në nivelin komunal në Kosovë.

Huadhënësi pajtohet t'i japë huamarrësit një kredi në shumë prej 2.5 milionë euro për realizimin e programit të efijencës së energjisë në ndërtesat publike.

Për komunat e Kosovës, si për Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë dhe një grand në shumë prej 3,68 milionë euro, si dhe subvencionimin e pagesës së interesit për shumën e kredisë nga fondet e grandit të KIBP-së dhe VBIF-së deri në shumën prej 1,42 milion euro.

Mjetet që do të përfitohen nga kjo marrëveshje janë në funksion të investimeve për zvogëlimin e konsumit të energjisë dhe të lëndës djegëse në baza fosile në objekte publike.

Me këtë rast, në nivelin komunal përmes investimeve të efijencës së energjisë, në të njëjtën kohë investimet në këtë program janë në funksion të përmbushjes së obligimeve të Kosovës në fushën e efijencës së energjisë, të cilat dalin nga Traktati i Komuniteteve të Energjisë dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë të Komisionit Evropian.

Marrëveshja do të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2016. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje do të jetë 12 vjet, deri më 2028. Afati i kthimit të kredisë do të jetë në greis periudhë në kohëzgjatje prej 3 vjetëve dhe afati i amortizimit 9.5 vjet.

Norma e interesit vjetor në shumën e tërhequr është 2%, taksa e angazhimit prej 0,25% vjetore në shumën e padisporuar të huas, taksa e menaxhimit 1% në shumën e kredisë.

Pagesa për interes janë zero, mbulohen nga subvencionimi, kurse pagesat për taksat e angazhimit dhe taksat e menaxhimit parashihet të jetë rreth 31 250 euro përgjatë kohëzgjatjes së kredisë.

Kthimi i kredisë do të fillojë nga 30 qershori 2019 dhe i cili do të përfundojë më 30 qershor 2028.

Kthimi do të bëhet më 19 këste të pagesës, çdo vit nga dy këste. Shuma e pagesës për një vit për dy këste është 262 mijë euro.

Ministria e Financave, në analizën e vlerësimit të ndikimit buxhetor të marrëveshjes, ka vlerësuar se zbatimi i këtij projekti për periudhën afatmesme 2016-2018 nuk do të ndikojë në koston shtesë

të buxhetit të Kosovës, pasi që aktivitetet që do të zhvillohen në pajtimin e komunave do të përfshihen në rishikimin e buxhetit të vitit 2016 dhe parashikimet buxhetore 2017-2018.

Duke vlerësuar rëndësinë dhe kushtet e marrëveshjes dhe përfitimet që do të sjellë, pasi është i kombinuar me një grand si dhe subvencionimin e interesit nga huadhënësi, Komisioni e ka përkrahur këtë marrëveshje dhe u ka rekomanduar deputetëve që ta votojnë.

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i LDK-së u rekomandon deputetëve që ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Stafete Hadërgjonaj, nga Partia Demokratike e Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet KFW dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin Masat e eficiencës së energjisë në ndërtimet publike në nivel komunal në Kosovë dhe ka ardhur në përfundim që ta përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Prandaj, i ftojme të gjithë deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe deputetët e tjerë që ta votojnë këtë marrëveshje dhe të bëhet e mundur ratifikimi i marrëveshjes së huas mes KFW dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, qëndrimi i kryetarit të Komisionit po ai.

Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zoti Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar.

GLAUK KONJUFCA: Është një projekt që ia vlen, kështu që do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Parlamentarna grupa Srpske liste razmatrala je Nacrt zakona o ratifikacije sporazuma između Vlade Kosova i KFW i mi ćemo podržati i usvojicemo preporuku Komisije za budžet i financije. Glasacemo za. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi “6+”, zoti Damka, fjala për ju.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi “6+” e përkrah propozimin dhe projektin për Kosovën.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Nait Hasani e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Marrëveshjen e kemi parë dhe është një marrëveshje e mirë, është një marrëveshje që jep një mundësi të mirë të zhvillimit të efikasitetit të energjisë.

Por, kjo marrëveshje nuk e përfshin pjesën kryesore, qytetin historik, qytetin e Lidhjes së Prizrenit, qytetin e kulturës, multietnicitetit, traditës dhe mbrojtjes apo zhvillimit.

Në qytetin e Prizrenit kemi pasur edhe shkatërrime të objekteve të trashëgimisë kulturore, kemi pasur rrëzime të objekteve, kemi pasur vdekje të fëmijëve atje dhe nuk kemi investuar për mbrojtjen e qytetit të Prizrenit.

Prandaj, në këtë marrëveshje nuk përfshihet qyteti i Prizrenit, përfshihet Gjakova, Ferizaj, Gjilani e Prishtina. Kjo do të thotë që ne duhet ta votojmë një marrëveshje, derisa tradita e kultura, turizmi është në Prizren, nuk është në Gjilan, nuk është në Gjakovë, as në Prishtinë.

Prandaj, unë nuk mund ta votoj një marrëveshje të tillë, e cila nuk e favorizon, nëse nuk i jap mundësi zhvillimit të Prizrenit si qytet historik edhe si qytet i vlerave dhe multietnicitetit.

Prandaj, më vjen keq, kjo marrëveshje është shumë e mirë, por nuk mund ta votoj.

KRYETARI: Naser Osmani e ka kërkuar fjalën, urdhëro!

NASER OSMANI: Kryetar!

Për mua vota e Naitit është goxha e rëndësishme dhe unë e kisha lutur që ta kuptojë që këto mjete kanë të bëjnë vetë me institucione, domethënë efikasitetin e energjisë për institucione, jo për objekte të tjera të kulturës e të traditës.

Prandaj, kjo është kuptimi i kësaj.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, një sqarim për hir të publikut, më tepër.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për ta sqaruar edhe një herë deputetin Hasani.

Ky është një program, i cili ka nisur më herët dhe komunat e tjera do të përfshihen në programin e ardhshëm, të cilin ne e kemi dakorduar me KFW. Mirëpo nuk mund të flasim për një program të ardhshëm pa e miratuar këtë program.

Prandaj, është e rëndësishme shumë edhe vota juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait, a të futemi në votim, a e do edhe një herë fjalën? Urdhëro, Naiti e ka fjalën dhe para votimit jemi.

NAIT HASANI: Veç desha ta falënderoj ministrin, nuk kam nevojë për sqarime.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pra, janë 90 deputetë të pranishëm në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Në fakt, nuk janë zëra shumë të mira ata që thonë se nuk po punon Kuvendi, a!

91 deputetë janë në sallë, 89 kanë votuar, 87 për, një kundër dhe një abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për huan ndërmjet KFW Frankfurt Amajn dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për programin Masat e efikasitetit të energjisë së energjisë në ndërtesat publike në nivel komunal në Kosovë.

Tani fjalën e ka kërkuar deputetja, zonja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, shumë i nderuar kryetar!

Kërkoj ndjesë që duhet ta prishim pak rendin e ditës, por sot mund të jetë dita e fundit që unë do ta marr fjalën nga kjo foltore.

Dhe kërkoja nga kryetari që të më jap mundësinë që ta shfrytëzoj rastin që të falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës që ma mundësuan që të jem pjesë e këtij parlamenti, që besuan tek unë për të më bërë përfaqësuese të tyre përgjatë këtyre dy mandateve.

Dua të them se ndihem shumë e respektuar dhe e privilegjuar që pata mundësinë të hyj në këtë sallë, për mua është e shenjtë. Ndihem e respektuar dhe e privilegjuar që pata mundësinë të punoj për të mirën e qytetarëve të Kosovës, për të mirën e shtetit të ri të Kosovës, për forcimin e shtetit të sfiduar të Kosovës.

Dua të them se asnjëherë nuk kam bërë llogari për rrugëtimin tim politik, as për gjatësinë e këtij rrugëtimi politik. Ajo për të cilën kam qenë e bindur dhe e vetëdijshme gjithmonë, ka qenë përmbajtja e këtij rrugëtimi. E përmbajtja nuk ka qenë kurrë politikë ditore.

Gjatë këtyre gjashtë vjetëve si deputete e Kuvendit të Kosovës jam munduar që me gjithë forcën time intelektuale dhe shpirtërore të bëj më të mirën, jam munduar të bëhem zëri i atyre që nuk kanë zë, jam munduar për konsolidimin e demokracisë së brishtë të Kosovës, për konsolidimin e sundimit të ligjit, për transparencën, për mbrojtjen e kufijve dhe sovranitetit të Kosovës.

E kam ngritur zërin për mbrojtjen e identitetit tonë kombëtar, kur kam parë se ideologji të rrezikshme po e sfidojnë atë, jam ngritur kundër instalimit të ideve primitive në shoqëri, duke besuar fort në idetë iluministe dhe properëndimor.

E kam ngritur zërin me qindra herë për të drejtat e grave, duke aspiruar për një shoqëri më të drejtë, një shoqëri pa diskriminim.

E kam ngritur zërin edhe për mbrojtjen e lirisë së mediave, liri në të cilën unë besoj fort, edhe pse ishin ato që shpesh abuzuan me këtë liri edhe në raport me mua.

Por, gjatë gjithë këtij rrugëtim politik, edhe pse i shkurtër, jam sfiduar shpesh. Jam sfiduar në aspektin e sigurisë sime personale, në aspektin e moralit, në aspektin e dinjitetit tim personal dhe familjar.

Jam sfiduar edhe në raport me origjinën time të lindjes, edhe pse thjesht, e formuar si një shqiptare, është thjesht një nocion gjeografik. E kam parë veten shpesh në qendër të cikloneve me prapavijë nga më të ndryshmet. Grupacione ekstremiste politike e fetare janë përpjekur të ma shkatërrojnë reputacionin vetëm sepse idetë dhe idealet për të cilat unë luftoj nuk përputhen me ato të tyre.

Por, unë dua t'i siguroj të gjithë përkrahësit e mi e më gjerë se edhe pse jam lënduar shpesh, ata kurrë nuk mundën të ma lëkundin sadopak dashurinë time për Kosovën. As idealizmin me të cilin kam ardhur këtu. Përkundrazi, këta shërbyen se kam vënë alarmin për mua që ta marr rolin që më takon si një qytetare që e do vendin e saj, e mbi të gjitha si një përfaqësuese e popullit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Së shpejti unë do ta nis një rrugë të re, po kaq të rëndësishme për shtetin e Kosovës, e që është përfaqësimi i tij jashtë.

Dua të them se më bën nder detyra ndaj Kosovës, më bën nder besimi, më bën nder vota e dhënë. Unë i njoh sfidat e kësaj detyre dhe ju garantoj se Kosova, vetëm Kosova, do të jetë prioriteti im i parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Të falënderoj për korrektësinë, për angazhimin veçanërisht për lidhjet me Parlamentin e Shqipërisë, për projektin “Heroinat” dhe për qëndrimin tuaj dinjitoz ndaj luftës kundër ekstremistëve. Të urojmë suksese! Faleminderit!

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisionet parlamentare, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 7 korrik 2016, e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Naser Osmani, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëro, kryetar!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa me një procedurë të përshpejtuar e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe ka propozuar 13 amendamente.

Ndryshimet e reja në buxhet janë për organizatat buxhetore janë në shumën 1 milion e 259 mijë euro, si dhe ka bërë disa transfere brenda të njëjtës organizatë buxhetore. Është propozuar të ndahen mjete shtesë për Kuvendin, për shkak të nevojave dhe aktiviteteve që priten të vazhdojnë. Janë ndarë mjete për Ministrinë e Integritetit Evropian, e po ashtu me kërkesën edhe të anëtarëve të komisionit përkatës dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbyesit civil, për të cilin e kemi edhe një amendament nga deputetja Xhevahire Izmaku, për çfarë rekomandojmë që ta tërheq pasi që janë ndarë 15 mijë euro për këtë institucion, për mallra dhe shërbime. Është vlerësuar e mjaftueshme, prandaj propozojmë që deputetja ta tërheqë amendamentin.

Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është ndarë buxhet për renovimin e stadiumit “Adem Jashari” në Mitrovicë, me qëllim të plotësimit të kushteve të stadiumit sipas kriterëve të FIFA-s me rastin e garave kualifikuese që do t’i zhvillojë Kombëtarja e Kosovës. Për këtë e kemi një amendament të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, që ne rekomandojmë ta tërheqë, por meqenëse deputeti në fjalë kërkon shumë edhe më të madhe se që ne e kemi ndarë.

Në Ministrinë e Punës së Brendshme është ndarë buxhet për projektin e krijimit të regjistrat unik dhe qendror për përdorimin e autoriteteve kompetente. Është ndarë buxhet për Zyrën e Presidentit në mallra dhe shërbime, ndërkaq amendamenti për Komunën e Leposaviqit është rregulluar brenda investimeve kapitale të komunës.

Një çështje e rëndësishme është ndarja e buxhetit prej 300 mijë euro për pagesën e specialistëve të shëndetësisë. Kjo është një zgjidhje e përkohshme për këtë vit sa i përket pagesës së specialistëve, ndërkaq komisioni i rekomandon ministrit të Shëndetësisë që faktikisht anëtarët e komisionit kanë kërkuar edhe informatë nga ministri me shkrim që të hartojë listën e saktë të specialistëve, që janë financuar nga buxheti i Kosovës me të cilat kanë specializuar dhe të cilët janë të papunë që i jap prioritet, po ashtu kërkon që të jap listën e saktë edhe të atyre që kanë specializuar dhe janë të pasistemuar, por të cilët nuk janë specializuar me mjetet e Qeverisë.

Po ashtu, ka kërkesë që meqenëse kjo në buxhet do të figurojë vetëm si shumë, në subvencione dhe transfere dhe nuk do të figurojë kërkesa e komisionit që ministri të ketë parasysh edhe ata specialistë të cilët janë në proces e sipër të trajtohen sipas nevojës dhe sipas mundësisë.

Sa u përket amendamenteve të propozuara nga komisionet dhe deputetët, ato nuk i përmbushin kushtet teknike, sepse janë propozuar të ndahen mjete të reja ndërkaq mungon propozimi për shkurtimin e buxhetit për të kompensuar këto mjete dhe shumicën prej tyre komisioni nuk i ka përkrahë. Prandaj, kërkoj nga deputetët që ato amendamente të cilat nuk janë të plota dhe nuk janë me përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa të mos votohen.

Amendamenti i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e komuniteteve dhe kthim që në përmbajtje është i ngjashëm me amendamentin e propozuar nga deputetja Emilija Rexhepi dhe deputeti Qerim Bajrami, është një çështje që i takon Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga diskutimet që janë zhvilluar me ministrin e Financave është kuptuar se këto dy ministri janë darkorduar lidhur me prioritetet e buxhetit të Ministrisë së Arsimit për këtë vit.

Komisioni ka pranuar edhe disa kërkesa të arsyeshme për projektet e reja, por duke ditur se jemi në fazën e rishikimit të buxhetit që kryesisht janë bërë rregullime të domosdoshme të ndarjeve buxhetore kanë vlerësuar se ato duhet të shqyrtohen gjatë fazës së buxhetit të rregullt. Unë si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa kam obligim që të falënderoj deputetët e komisionit për një bashkëpunim tejet korrekt dhe tejet maksimal dhe një angazhim të tyre si çdoherë dhe ne kemi arrit që ky rishikim të votohet me konsensus dhe i rekomandojmë Kuvendit që të votojë me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kemi ndarë këtë shumë për specialistët, por kërkojmë që në këtë kuadër të futen edhe specializantët. Pra, edhe ata të cilët janë në proces e sipër t'u krijohet mundësia që edhe ata ta ndiejnë veten të barabartë me të tjerët.

KRYETARI: Zoti Konjufca e ka fjalën, ndërkohë zoti Grabovci e rregulloni këtë çështje me kryetarin e komisionit.

GLAUK KONJUFCA: Zoti kryetar i Parlamentit,

Kjo seancë filloi me dy orë vonesë, na keni ftuar në orën 10:00 për të marrë pjesë në seancën e Kuvendit dhe seanca filloi në orën 12:00.

Unë e kuptoj kur njerëzit presin 10 apo 15 minuta, ama kur njerëzit presin dy orë, kjo pritje me të vërtetë nuk ka më kuptim. Dhe meqë jemi në pikën e buxhetit, unë e di saktësisht pse jemi vonuar dy orë. Jemi vonuar pikërisht për shkak të kësaj pike të cilën po e diskutojmë. Ju keni bërë deri para pak kohësh, deri në orën 12:00 kur u kthyem ne në seancë, dhe me siguri negociatat tuaja kanë filluar herët në mëngjes me Lidhjen Demokratike të Kosovës për ta kryer “aksham pazarin” e këtij leximi të dytë të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Çka tregon kjo? Kjo tregon që ju Buxhetin as që e konceptoni bile si një mjet publik për të krijuar të mira për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ju këtë buxhet si forca të koalicionit qeverisës, si parti të cilat e qeverisni bashkë Kosovën, ju më shumë e shihni këtë si njëfarë plaçke për të ndarë në hisen e secilit se ndryshe nuk ka kuptim që të vonoheni dy orë dhe të negocioni për buxhetin.

Pra, kjo tregon se në çfarë gjendje është qeverisja edhe në çfarë mënyre konceptohet Buxheti i Republikës së Kosovës dhe është e pafalshme që tash të vini tash e filloni udhëheqjen e seancës dhe asnjë fjalë për at vonesë dy orësh. A duhet të japë dikush përgjegjësi për këtë joseriozitet, apo po vazhdojmë kështu siç ia kemi nisur.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Konjufca!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. zoti Ismet Beqiri. Ademi prapë është lajmëruar, replikë a çka? Ok, le ta marrë Ismeti fjalën, pastaj ju.

ISMET BEQIRI: Unë, zoti kryetar, meqenëse kryetari i komisionit, zoti Osmani, e tha shumë qartë që në komision janë dakorduar pothuajse për të gjitha amendamentet dhe unë sa e kuptova

për të gjitha edhe nga fjala që u tha, me të vërtetë është për keqardhje deklarata e zotit Konjufca, sepse duhet të na e thotë, unë jam kryetar i Grupit Parlamentar dhe asnjë “aksham Pazar” dhe në asnjë bisedë s’kam marrë pjesë, as që është biseduar për buxhet.

Dhe, se pse është vonuar seanca, kryetari sigurisht mund ta thotë, sepse është kryetar dhe ai është vonuar që i ka arsyet dhe i thotë sigurisht, por ajo që unë them me përgjegjësi, kjo s’ka të bëjë me buxhetin. Fakti që e tha kryetari tekstualisht me konsensus ose pa asnjë votë kundër në komision janë dakorduar, kjo hedh poshtë tërësisht atë çka thotë zoti Konjufca dhe nuk qëndron, nuk është mirë për ta shfrytëzuar rastin për një pretekst sa për të thënë diçka tjetër, sepse është absolutisht e paqëndrueshme dhe buxheti shkruan qartë çka përmban, ku shkojnë ato mjete, si realizohen që janë procedura, në të cilat unë s’dua që të lëshohem dhe komisioni është kompetent dhe asnjë tjetër formë nuk ka se si të procedohet buxheti në këtë rast, për rishikim, përkatësisht amendamentimi i tij. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Grabovci e ka fjalën, pastaj janë deputetët.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë vetëm desha ta precizoj atë që e tha kryetari i komisionit, që të jem edhe më shumë preciz se është në pyetje të specializuarit dhe specialistët që ka qenë marrëveshje edhe është në interes të çdo qytetari të Republikës së Kosovës, sepse buxheti është i qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ne jemi të obliguar të vendosim në përputhje me interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Dhe, në këtë rast ne kemi të bëjmë me një kategori të veçantë të mjekëve, të cilët janë duke specializuar dhe janë kuadro shumë të rëndësishme për sektorin më të ndjeshëm dhe më të rëndësishëm të shëndetësisë dhe ata duhet ta ndiejnë veten të barabartë dhe nuk e besoj dikush në këtë Kuvend që është kundër apo ka diçka kundër asaj kategorie apo këtyre kuadro tonat të ardhshme, se për vonesat e për ato pazaret që thotë shefi i grupit, është absurde, po unë po them, më fal kryetar, se ju duhet t’i përgjigjeni, por le t’i lexojë... dhe ato i tregojnë se ku ka qenë kryetari dhe me kë ka qenë në takim.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe po të mos jetë nënkryetari janë nënkryetarët, Kuvendi s’mbetet keq. Po, të shkojmë kështu, më fal! Jo, e kam një radhitje! Besa u lajmërova pas Shqipërisë, Shqipëria pastaj hidhërohet, Xhevahire Izmaqi është e para, Shqipe Pantina, Gëzim Kelmendi, Besa Baftiu, Glauk Konjufca, replikë, dhe Shaip Muja.

Kjo është radhitja, Glauk a do replikë menjëherë?

GLAUK KONJUFCA: I humb rendi tani kësaj! Shiko, që kjo republikë, ky shtet është bërë pazar krejt prej koalicionit PDK-LDK, këtu nuk ka asnjë argument më të qartë se sa vetë marrëveshja e themelimit të koalicionit. Po ju, a e dini që aty në marrëveshje shkruan që PDK-ja me LDK-në ka për t’i ndarë krejt bordet e pavarura me militantët e tyre partiakë.

Kjo, jo që është Pazar, por është pazar ashiqare, është pazar publik, i cili nuk fshihet. Në njërin anë, siç ndodhi para disa javëve më parë, LDK-ja me PDK-në bëjnë pazar kështu: “Ju na jepni Autoritetin e Konkurrencës, na jua japim Këshillim Gjyqësor të Kosovës”, për ta dërguar njeriun

e Hajredin Kuçit. Po këtu më pazar më nuk po di qysh! Ky është pazar për sheshi, për fushe. Gjithçka është këtu Pazar! Ju e keni kthyer Kosovën në gjithçka, prej bordeve e agjencive të pavarura deri te drejtësia, deri te demarkacioni, deri te territori i Kosovës këtu po bëhet pazar.

KRYETARI: Kisha kërkuar në qoftë se ka mundësi të kthehem në pikën e rendit të ditës. Sa i përket kësaj çështjeje, edhe ju e keni pushtetin e shikoni kë po e vendosni në Prishtinë. Sa u përket bordeve të pavarura, vetëm pak në qoftë se ka mundësi, besoj shumë shpejt do ta kemi një kompani, e cila do të jetë prestigjioze ndërkombëtare dhe do t'i përcaktojë në mënyrë profesionale. Por, të mos futemi në këtë pjesë, të futemi vetëm te Buxheti.

Xhevahire Izmaku, e ka fjalën. Bëhet gati Shqipe Pantina.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë po e tërheq amendamentin duke e falënderuar komisionin që e ka përfshirë pjesërisht pjesën e kërkuar për buxhetin e shtuar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

Besoj që ata do ta shfrytëzojnë këtë në mënyrë racionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Pantina, fjala për ju. Përgatitet zoti Kelmendi.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Sa për korrektësi dhe qartësi, jo të gjitha amendamentet kanë kaluar me konsensus. Kushdo që mundet t'i shoh detajet mundet t'i shoh në procesverbal. Konsensusi ka qenë në amendamentin e 12, i cili ka të bëjë me mjekët specialistë dhe doli ministri, por unë desha t'i them edhe atij se është e papranueshme që problemet që i shkakton Qeveria, le që nuk i zgjidh po i bart mandej te Kuvendi, sepse ky është problem i shkaktuar nga Ministria e Shëndetësisë, po flas për mjekët specialistë, sepse çdoherë kushdo që e njeh këtë problem edhe pa i njohur mirë detajet, pa qenë mjek e di se specializimet ndahen, kurse këta njerëz le që nuk për të cilën pak ministria, Qeveria, ka investuar dhe pothuajse ua ka humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit të tyre për shkak se nuk i ka sistemuar me kohë në pozitat për të cilat tashmë u është ndarë atyre specializimi dhe vjen çështja që Kuvendi ta zgjidhë këtë problem dhe atë përkohësisht, sepse kjo shumë e ndarë nuk do ta zgjidhë problemin e këtyre specialistëve, sepse do ta zgjidhë problemin ndoshta financiar, por ende nuk dihet se ku do të sistemohen këta mjekë.

Në cilat klinika apo në cilat ambulanca do të sistemohen dhe ky do të mbetet problem edhe për vitin tjetër, për të cilin nuk po shihet që ministria ka ndonjë plan të qartë se si do t'i sistemojë.

Dhe, për fund, edhe një herë për komplet buxhetin, "Vetëvendosja" e ka miratuar amendamentin e 12 siç thashë, por ne nuk kemi marrë të paktën në komision fare në votim në buxhetin total, në rishikimin total të buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetar i komisionit, po dalin pazaret, pazaret për grupet, që janë për specialistë dhe në specializim, kjo ka qenë Glauk në qoftë se e konsideron pazar, po flitet për doktorë, specialistë dhe specializim.

Gëzim Kelmendi e ka fjalën, bëhet gati zonja Baftija pastaj.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar,

E arsyeja që më detyroi ta marr fjalën lidhet pikërisht me amendamentin e propozuar për çështjen, konkretisht zgjidhjen e problemit të specialistëve të papunë në Kosovë.

Unë si deputet i Kuvendit të Kosovës e mbështes fuqishëm këtë amendament, për zgjidhjen e problemit të tyre, konkretisht për punësimin e tyre ngase e dimë që mënyra dhe rrugëtimi i shkollimit të mjekësisë dhe specializimit është mjaftë i vështirë, por ajo që më bën kryesore të marrë fjalën është politizimi i kësaj çështje dhe padrejtësia përballë kuadrove tjera profesionale. Pse them këto dy pika? Politizimi ditëve të fundit që kemi parë ndërmjet rivalëve të koalicionit PDK-së dhe LDK-së në njërin anë nga ministria, pastaj nga komisioni tash na del edhe udhëheqësi i Grupit Parlamentar të PDK-së, të mos harrojmë se kjo çështje është zgjidhur shumë mirë në mandatin e kaluar nga ministri i Shëndetësisë sa ka qenë ajo ministri, konkretisht përgjegjësia bie mbi Ministrinë e Shëndetësisë.

Mandatin e kaluar nuk ka qenë asnjë specialistë i papunë, ndërsa zgjidhje e problemit edhe i specializantëve jo veç i specialistëve por edhe i specializantëve. Në këtë mandat i kemi parë që në shumë fusha këtë rast, edhe në këtë fushën e punësimit të specialistëve bëhet shumë politik e veçanërisht ndërmjet dy partnerëve të koalicionit, e që nuk është dashur të ndodhë një gjë e tillë.

Ajo që më shtyri, që më detyroi dhe e dyta ta marr fjalën për këtë pikë është se përveç që gëzohem dhe e mbështes këtë zgjidhjen e problemit të specialistëve, shpresoj edhe specializantëve do të zgjidhet është dilema ime për profesionalistët dhe intelektualët e fushave tjera në Kosovë. Mos harroni se kemi me mijëra tituj shkencor, magjistra të shkencave, doktorë të shkencave, të cilët janë të papunë.

Kush do të merret me ta tash? Mjekët e zgjidhën për momentin problemin që e kanë merituar dhe vërtetë ngase pa shëndetësi të shëndoshë nuk mund të kemi as shoqëri të shëndoshë. Por, kemi me mijëra magjistra të shkencave, të cilët kanë magjistruar kemi edhe doktorë shkencave që kanë doktoruar dhe janë të papunë. A duhet edhe ata të dalin të protestojnë? Unë personalisht nuk jam ithtarë i protestave dhe nuk përkrahi ndonjë formë të protestës, por sukcesi që është arritur me specialistët e ditëve të kaluara nëpërmjet protestës së tyre fillimisht para Ministrisë dhe tash para Kuvendit, jep të kuptojnë dhe inkurajon edhe intelektualët tjerë të fushave tjera, magjistra dhe doktorë të shkencave të protestojnë dhe ta fusin njëfarë rivaliteti ndërmjet partnerëve të koalicionit, pasi po shihet se vendi po shkon drejt zgjedhjeve që të fitojnë poenë politike.

Në anën tjetër të zgjidhet edhe problemi i këtyre, mos të bëjmë padrejtësi vetëm në një fushë, por tu japim gjithë atyre kuadrove të reja, të cilët vërtetë kanë derdhur mund dhe djersë që të studiojnë, të magjistrojnë dhe të doktorojnë. Është e pafalshme që 17 vjet pas luftës Kosova e ka një rini të shëndoshë me disa universitete publike në qendra rajonale dhe me dhjetëra kolegje private, por fatkeqësisht shumica e tyre janë të papunë. Detyrohen të punojnë nivelit më të ulët dhe një pjesë e tyre migrojnë në vendet e Bashkimit Evropian.

Prandaj, me një menaxhim të tillë të buxhetit të Kosovës, duke ndaluar korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet t'i zgjedhim dhe ta ndihmojmë perspektivën e shëndoshë edhe këtyre intelektualëve të tjerë, sikurse që u zgjidh problemi i specialistëve. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe ti s'mbete pa fushatë. Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Unë ato që pata t'ua them, shumicën i tha kolegja ime Shqipe Pantina, por isha ndërlidhur me shefin e Grupit Parlamentar, Adem Grabovci, i cili edhe ai deshi të përfitojë lidhur me mbështetjen apo përkrahjen e specialistëve apo të specializantëve.

E shumë mirë e dimë se ne në Kuvend, këtu në Komision të Shëndetësisë e kemi ngrehur si Lëvizje "Vetëvendosje" shqetësimin e një numri të madh të specializantëve dhe të specialistëve, të cilët tanimë janë të papunë. Janë pa rroga, kryejnë specializimin, ndërsa e dimë në çfarë kushtesh janë. Prandaj, ne si Lëvizje "Vetëvendosje" i mbështetim të dy këto kategori, si specializantët, po ashtu edhe specialistët.

Ndërsa, është ajo tjetra, që këto dy grupet në pushtet po duan të përfitojnë politikisht në këtë drejtim. E unë mendoj që kjo duhet të jetë në përkrahje të gjithë neve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Adem, e do fjalën? Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë se këtu çdo gjë po bëhet për politikë, por ne, në fund të fundit, në politikë jemi. Por, koleges së nderuar i them që nuk kam fort nevojë të bëj fushatë, sepse i kam votat e sigurta sa herë që të dalim në fushatë, por unë po them me sinjeritetin më të madh këtë çështje e kemi diskutuar gjerë e gjatë në komision.

Jemi dakorduar që të gjithë që tu japim mbështetje dhe tu ofrojmë zgjidhje këtyre kategorive, unë kërkova vetëm një precizim mu duk si kryetarit i shpëtoi pak pa e precizuar pak më qartë desha të precizojë specialistëve dhe specializantëve dhe këtë kur të vijë radha e votimit të këtij amendamenti kërkoj që të futet me këtë plotësim, të votohet ky amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Shaip, a ka mundësi, replikë ka kërkuar Besa.

BESA BAFTIJA: Zoti Grabovci tha se ne nuk kemi nevojë, se i kemi votat, sa herë që del edhe i fiton votat, mirëpo ne e dimë se pasi e keni Buxhetin, i keni edhe votat, kështu që sa herë që ju dilni e i blini votat, normalisht se paragjykoni se do t'i keni edhe votat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse është politizuar, unë i kisha lutur të gjithë kolegët të flasin në mënyrë profesionale e analitike, sepse ky nuk është politizuar, por është keqmenaxhuar si problem nga vetë Ministria e Shëndetësisë.

Në dhjetor të vitit të kaluar, kur është miratuar buxheti, me këmbëngulje unë dhe disa deputetë të Partisë Demokratike kemi kërkuar që specialistët dhe të specializuarit në mënyrë shumë të thuktë të analizohen nga Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Rektorati dhe të sistemohen në dobi të shërbimit të sistemit shëndetësor.

Kjo çështje nuk ka kaluar dhe është e turpshme për ne. Unë ndihem i turpëruar, sepse kemi ofruar shërbim shëndetësor më të mirë nga të gjitha partitë, sepse një shtet, i cili nuk ka shëndetësi e arsim, ai shtet nuk ka perspektivë.

Në këto dy sisteme, ne jemi duke çaluar, nga padija apo nuk po duam, ose dikush po na mëson për të keqmenaxhuar, kjo mbetet të shihet.

Dje ne e kishim një bisedë në komision me zotin ministër. Ia shtrova pyetjen: Më trego, në bazë të statistikave mjekësore që i paraqet Organizata Botërore e Shëndetësisë, nga sistemi primar, sekondar dhe terciar, a jemi të mbuluar me kuadro? Nuk ishte në gjendje të përgjigjet dhe e di që nuk është në gjendje, sepse nuk i kemi të plotësuar. Ne duhet të punësojmë më shumë njerëz.

Por, sikurse ministri i Financave të kishte analizuar se sa kemi evazion fiskal vetëm nga shërbimet që i blejmë jashtë Republikës së Kosovës, duke ikur njerëzit, jo vetëm që i paguajmë ne ato si buxhet, por edhe që ikin pa pyetur në shtetin fqinj, në Maqedoni, qytetarët tanë paguajnë mbi 35 milionë euro në vit, shërbime të cilët ne kishim mundur... dhe nuk kishte qenë problem ky punësim, pra nëse do të kishte pasur një menaxhim më të mirë.

Nëse Ministria e Shëndetësisë e kishte bindur Kabinetin qeveritar se kuadri mjekësor është duke u plakur, me statistika kuadri mjekësor në Republikën e Kosovës është duke u plakur. Dhe, në kuadër të analizave që i kam, ata janë duke ikur nga Kosova dhe momentalisht rrezikohen 2-3 spitale regjionale të mbesin pa kuadro të specialistëve, po ashtu edhe Qendra Universitare.

Për këtë, shtetet si Maqedonia dhe Serbia i kanë ngritur shqetësimet e veta se u kanë ikur kuadrot dhe u janë plakur kuadrot. Kush do t'i zëvendësojë këto?

Po ashtu, edhe kolegja nga Vetëvendosje, nëse di të tregojë se a e ka planifikuar Vetëvendosja shërbimin primar me këtë ministër në politikën e zonimit, që quhet në planifikimin shëndetësor, me kuadro, atëherë mund të vijë dhe të mburret për ta sulmuar në aspektin profesional edhe shërbimin terciar dhe sekondar.

Në Prishtinë, ju si qytetarë, të cilët banoni këtu, zonimi, së pari, nuk është i mbuluar siç duhet dhe secili kryetar që ka qenë në Prishtinë ka thënë - do të bëjmë. Zonimi është shërbim primar, do të thotë ambulanca kryesore.

Kur të hyjmë në fushatë, të gjithë themi do ta bëjmë një spital regional për Prishtinën që është huqje profesionale, sepse Qendra Universitare e Prishtinës ka 45% hapësirë të pashfrytëzuar. Kjo është e studiuar shkencërisht, nuk është zbulim dhe është studim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organizatat e specializuara, të cilat i analizojnë këto çështje.

Prandaj, këtij ministri dhe ministrave të kaluar ua kam ngjitur emrin se janë “ministra të krizave të tullave”. Këta dinë veç të bëjnë ndërtim, por nuk mund të bëjnë funksionim. Prandaj, kësisoj e kemi këtë dhe sa për punësim ne nuk jemi duke bërë hair, ne jemi duke treguar se jemi të paaftë dhe këta duhet punësuar sa më shpejt dhe t’i sistematizojmë, sepse paratë janë në sistemin e përgjithshëm, por nuk analizohen çka fitojnë.

Një shembull konkret ia kisha treguar ministrit, se një vend pune sa i kushton për një patolog në Spitalin e Vushtrisë. Mbi 2 mijë euro kushton komplet një patolog brenda një muaji dhe për 12 muaj është 24 mijë. Mirëpo ai, me punën e tij, mund t’i ndalojë një 20 sëmundje, të cilat mund të kushtojnë nga 5 mijë euro nga xhepi qoftë i qytetarit që shkon e i paguan vetë, ose hipotetikisht po themi një 5 vetëve po ua paguan Qeveria e Kosovës. Prandaj, ai vendin e punës e paguan vetë, mirëpo ne po ua ndalojmë atyre mjekëve dhe po merremi me sensacione me mjekë për paaftësi të cilat jemi duke i prodhuar vetë me keqmenaxhim.

Sot kemi shumë afera të cilat janë të prodhuara nga keqmenaxhimi i shtetit dhe po u atribuohen mjekëve.

Ka shumë gjëra të cilat ne duhet t’i diskutojmë dhe të cilat ndoshta ky buxhet pas aprovimit, duhet bërë seanca të veçanta edhe për shëndetësi dhe disa sektorë tjerë të cilët lidhen me ekonominë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shaip, sidoqoftë, unë po ju dëgjoj, s’jam specialist dhe nuk e njoh mirë këtë fushë, por mendoj se Kosova është për Libër të Gjinisë për shërbimet që i bën pa lekë në spitale - në shëndetësi dhe ne duhet pasur tjetër buxhet për t’i arritur standardet për këtë.

Fjalën e ka zoti Baxhaku. Por, për replikë meqë është lajmëruar, regjia ia jepni zonjës Baftija fjalën!

BESA BAFTIJA: Pasi zoti Shaip Muja e përmendi komunën e Prishtinës dhe shërbimin primar në nivel të komunës, unë po i them zotit Muja që le të bëhen shërbimet sikur që kryhen në nivelin primar në shëndetësi në komunën e Prishtinës.

Janë qytetarët ata të cilët e vlerësojnë punën që po bëhet në kujdesin primar në komunën e Prishtinës dhe nuk është Shaip Muja, i cili e dha këtu një vlerësim, prandaj po ua lëmë qytetarëve të tregojnë se a janë të kënaqur. Bile janë shumë të kënaqur sepse ka një ndryshim shumë të madh në krahasim me të kaluarën në sistemin shëndetësor të komunës së Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Shaip, për kundërreplikë, e keni 1 minutë!

SHAIP MUJA: Jo, i kam 2 minuta, sepse një replikë e kam për juve, zoti nënkryetar dhe 1 minutë e kam për “Vetëvendosjen”.

Për çështjen e fondeve, të kisha sugjeruar zoti nënkryetar, mos u futni, sepse fondet janë të mjaftueshme. Ekzistojnë matematikat, por thashë se keqmenaxhimi dhe keqplanifikimi po e sjellin këtë situatë.

Ndërsa për këtë çështje kërkoja edhe debat, ose të mbahet edhe një seancë. Të bisedojmë pa inati, t'i sheshojmë gjërat, po i shohim ligjet, po i shohim paratë, po i shohim mundësitë. Ne s'kemi nevojë të krijojmë konflikte.

Sa i përket zonjës, unë thashë për "Vetëvendosje", sepse komuna e Prishtinës është kryeqendra e Republikës së Kosovës. Nga këtu duhet të fillojë shembulli për komunat e tjera.

Dhe, më vjen keq që kolegja mundohet të më kundërshtojë në mënyra profesionale, sepse unë nuk bëj sondazh me qytetarët, por bëj sondazh me planifikimin shëndetësor, dhe kur thashë për zonimin, duhet kuptuar profesionalisht çka kam kërkuar.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Unë diçka dua të të them, Shaip! Kam qenë nëpër spitale, bile shumëkund në Evropë. Kurrë afër spitalit barnatore s'kam parë dhe as ambulanca të tjera private. Pra, rreth spitalit nuk kam parë. Këtu ka. Zoti Baxhaku e ka fjalën!

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha të jem sa më i shkurtër në lidhje me amendamentin, i cili e rregullon zgjidhjen e përkohshme të punësimit dhe pagave për mjekët specialistë.

Unë dje e mora një informatë nga disa kolegë se edhe për specialistët do të bëhet një zgjidhje dhe Partia Demokratike është e gatshme, por LDK-ja po e kundërshton këtë zgjidhje. Dhe, në bazë të diskutimeve këtu, unë i besova asaj informate tash, kurse dje thashë se nuk është e mundshme, sepse edhe Partia Demokratike, edhe ne e dimë sa janë mundësitë buxhetore lidhur me zgjidhjen e problemit të specialistëve, numri i të cilëve është shumë i madh, diku rreth 400, zoti ministër, ashtu sillet për afërsisht që janë me vetëfinancim apo grupin B.

Prandaj, sipas diskutimit të kryetarit të Grupit Parlamentar, i cili u angazhua këtu që të bëhet edhe zgjidhja e problemit të specialistëve, unë tash jam i prirë t'u besoj atyre informatave të kolegëve të mi se gjoja LDK është kundër zgjidhjes së çështjes së specialistëve.

Unë besoj se edhe LDK nuk është kundër zgjidhjes së çështjes së specialistëve, por problemi është në mundësitë financiare, dhe për momentin besoj që nuk janë.

Prandaj, në qoftë se të gjitha partitë e tjera janë për zgjidhjen edhe të çështjes së specialistëve, unë po deklaroj këtu haptazi, dhe le ta dinë të gjithë ata mjekë specialistë se edhe LDK-ja, bile më shumë është e interesuar të zgjidhet çështja e tyre. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Shaip, shumë shpesh po lajmërohesh. Vetëm pak, të lutem. Kisha kërkuar të fuziononi drejt materies, sepse ka shumë diskutues. Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën. Janë të lajmëruar 10 vetë për diskutim, Armend.

Atëherë, më lejoni Adem, le ta marrë fjalën Armendi, pasi që e kemi jurist, ta lexojë dhe le të jetë administrata shumë profesionale.

Pas paraqitjes së raportit nga Komisioni Funkcional, të drejtën për diskutim e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët, neni 58 paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit.

Ju lutem, nëse e do fjalën, merre!

ADEM GRABOVCI: Kryetar, a bën ta marr fjalën unë një herë?

KRYETARI: Adem, për procedura e kam, nëse ka mundësi! Dhe, të mos dalë në publik se unë po e shkel Rregulloren. Urdhëro, Salih!

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryetar! Ne jemi në leximin e dytë të këtij Projektligji dhe nëse deputeti ka amendament, mund të diskutojë, por jo me hap debat sikur në leximin e parë. Prandaj, ne po kërkojmë të zbatohet Rregullorja. Nëse deputeti ka amendament, le të diskutojë, por jo të vazhdojë kështu, sikur në leximin e parë, që na shtyn të mbesim edhe 3-4 orë, dhe s'po bëjmë zgjidhje. Ju lutem, zbatoheni Rregulloren! Pra, si kryetar i Kuvendit zbatohet Rregulloren dhe të ecim përpara.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Profesor, sepse sekretari - administrata këndeje po më mban në presion se kam të drejtë. Qartësojeni, ju lutem, me vendimin e profesorit kryhet interpretimi i Rregullores, edhe kështu kryetari i Kuvendit e ka interpretimin, ashtu sikurse e thotë edhe Profesori.

SABRI HAMITI: Faleminderit! Unë po të mendoja që s'kam të drejtë të flas, nuk do të dilja këtu. Pra, shumë saktë e keni shpjeguar dhe kanë të drejtë deputetët të flasin. Kaq, sa i përket Rregullores.

Tjetër është puna që shpeshherë te ne, kur u pëlqen merren vesh dhe s'kanë nevojë të flasin, edhe s'flasin, por, nëse ka nevojë.

Zoti kryetar i Kuvendit, kolegë deputetë,

Thashë nëse do të mendoja se s'kam të drejtë të flas në këtë fazë të diskutimit, edhe pse është leximi i dytë, nuk do të flitja. Por vetë kryetari i Komisionit, i cili foli shkurtimisht dhe raportoi, saktë unë do të thosha, për amendamentimet që i ka dhënë komisioni dhe për atë që i kanë dhënë të tjerët dhe që s'i ka përkrahur, me të cilët do të ndeshemi edhe ne, unë do të flas vetëm për 2, që ai i përmendi dhe u diskutuan këtu. Njëri u diskutua e njëri jo, por meqë tjetër herë s'do ta marr fjalën, atëherë po e shfrytëzoj momentin. Është fjala për amendamentin 12, për të cilin u

bisedua dhe u dhanë edhe disa variante, nuk e di a janë amendamentime apo mendime, këtë e shohim më vonë, edhe amendamentin 5 që ka të bëjë me Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket këtij 12-shit, përpiqem të dëgjoj mirë, por edhe shkruaj çka thuhet këtu. Kryetari i Komisionit tha saktësisht - specialistët, dhe e përmendi një shumë, unë kujtoj që ishte 300 000 që ka të bëjë me specialistët, dhe sa kuptova unë, i bie që janë të nevojshëm dhe të bëhet e mundur që ata të punojnë dhe të marrin shpërblimin për punën që e bëjnë. Unë kështu e kuptova. Jepen 300 000.

Nuk u tha sa vetë janë. U përmend se janë dy kategori, një të cilën e ka financuar paraja publike - shteti, dhe të tjerët që e kanë financuar vetveten. Nuk u thanë numra, por u tha se janë dy kategori.

Sa i përket kategorisë tjetër, këtyre u bie se janë studentë të mbaruar, ose njerëz që e kanë kryer shkollën. Këta të tjerët - specialistët, i bie se janë ata që ia kanë nisur ose do të nisin, nuk dihet kush i financon, por duhet të ketë edhe këtu të tjerë që e financojnë shkollimin e vet dhe të tjerë që i financon shteti, ose paraja publike.

E tash, sa u përket të dytëve, kemi nuancime. Kryetari i Komisionit e tha - specialistët të trajtohen sipas nevojave dhe mundësisë. Pikë! Është e regjistruar. Dhe, nëse unë s'e them drejt, është e regjistruar.

Varianti tjetër, është, e që doli në diskutim që, meqë duhet ose është mirë të ndihmohen me 300 000 specialistët, pse të mos hyjnë në këtë kategori edhe specialistët, për të cilët prapë s'dihet numri sa është dhe si shkollohen. As për të parët nuk kemi numër. Unë jam përpjekur ta gjej një numër, se nga pak hulumtoj, por s'dua ta jap unë nëse s'e dini ju ose s'e jepni.

Dhe, unë po ndalem këtu. Tash, zoti Kelmendi e tha, unë për të mirë po ta përmend emrin dhe në daç repliko, në daç jo, punë për ty është. Është fjala për Gëzimin. Është i mirë kujdesi i këtij vendi, i këtij shteti për të diturit në të gjithë lëmenjtë, por reduktohet me punë të specialistëve të mjekësisë - mjekëve.

I uroj lobit të medicinës, brenda këtij Kuvendi, në Qeveri dhe në krejt shoqërinë kosovare që e bëjnë çështje të Kosovës vetëm këtë. Por unë, jam në Kuvendin e Kosovës dhe nuk mund të mos them: Le të jetë ky kujdes, por le të jetë kujdes për kualitet, në të gjithë lëmenjtë: në shkencat ekzakte që mungojnë, që nuk i shkollojmë, që nuk merremi me ta, që pata s'bën; në shkencat humanitare; në shkencat ekonomike; në kulturë; në art.

A ka menduar në këtë formë kjo Qeveri, në sistem tash po flas, jo ad hoc, dhe kjo është punë që po bisedohet në rishikimin e buxhetit, dhe s'e marr unë shumë seriozisht këtë, sepse këto duhet të planifikohen. Kjo është të ngjitësh harrna të vegjël nëpër shtjerra.

Prandaj, nëse mendohet qysh u pretendua të mendohet fuqishëm, unë po them - në të gjithë lëmenjtë, që ka dijetarë që presin vend pune dhe nuk e marrin se s'ka konkurrencë të vërtetë kualiteti, kjo është filozofia me të cilën duhet të merret edhe Parlamenti, edhe Qeveria edhe ministrat e resorëve, edhe deputetët.

Tash po kaloj te problemi, zoti kryetar, i amendamentit 5, sepse ka të bëjë me Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha Raportet e progresit që jepen për institucionet e Kosovës, na thonë: Kuvendi i Kosovës duhet ta hartojë buxhetin e vet të pavarur. Ne kemi vërejtje.

Bisedojmë për këtë vite të tëra. Nuk e krijojmë këtë standard. Dhe, kush po na ndalë ta krijojmë? Dhe tash ne do të grindemi këtu për kërkesat që Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rekomandim të Komisionit të Kuvendit, bën vendim të Kryesisë së Kuvendit dhe trajtohet në orën 5 para 12-ve, problemi i saj, dhe në fund gjendet një zgjidhje e cila është me minus 90 000 euro, nëse e kam lexuar mirë dhe prapë më korrigjon kolegu, sepse unë i lexoj letrat dhe e pashë që 90 000 i bie minus që i merr nga kërkesa.

Atëherë, nuk më vjen mirë hiq që nevojat e Kuvendit që janë të domosdoshme, janë minus 90 000. Por, s'është punë vetëm imja, sepse jam 1 prej 120. Dhe, meqë jam 1 prej 120, unë i them edhe kryetarit, Kryesisë, Kuvendit dhe Komisionit për ligjin për Kuvendin.

Ne e kemi një ligj - Projektligj të ndërtuar nga ekipet që financohen nga Bashkimi Evropian, për të cilat financohet Hungaria që t'i ndihmojë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai ligj është në duart e Kuvendit që një vit. Është ndërtuar një komision. Kemi pasur konsensus të të gjitha partive e grupeve parlamentare. Përnjëherë u ndal, u tha se është shumë i mirë e pa të s'bën, ligj që, mes tjerash, e realizon këtë për çka po flas unë - problemin e buxhetit të pavarur të Kuvendit. Përnjëherë u tha - jo, s'na vyen më ligji. Bile edhe evropianët po na thonë s'ju duhet ligji.

Ata e pruan, ne thamë po, ndërtuam komision dhe përnjëherë erdhi jo, por po ndiej që do të thuhet po.

Nëse është po, atëherë koha është që Kuvendi të krijojë ligj për vetveten siç duhet, dhe më në fund, edhe Qeveria e Kosovës të ketë ligj për Qeverinë, se nuk ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë, profesor, edhe për sqarimet. Ne po vazhdojmë radhën e diskutuesve të deputetëve dhe si të dalim te amendamentet i votojmë. Bekim Haxhiu e ka kërkuar fjalën dhe le të bëhet gati Veton Berisha.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E mora fjalën edhe për çështjen, të cilën kryetari i Komisionit tha se i ka dorëzuar 2 amendamente, prandaj edhe kur të vijë radha e amendamenteve do ta kërkoj fjalën, por së pari do ta arsyetoj amendamentin tim të parë që ka të bëjë për investime shtesë në Stadiumin Olimpik "Adem Jashari".

Komisioni i ka ndarë 790 mijë euro, 290 mijë të planifikuara nga ato 400 mijë që kanë qenë me projektbuxhetin e vitit 2015, por të pashfrytëzuara dhe nga ato 290 mijë euro janë edhe 500 mijë euro të cilat i ka ndarë Qeveria e Kosovës ditët e fundit dhe ato bëhen 790 mijë dhe nga planifikimet e reja që kanë qenë për këtë vit, planifikime parciale për disa stadione, palestra sportive dhe objekte sportive, që në total janë 844 mijë euro dhe kam kërkuar që edhe këto 844

mijë të investohen në “Adem Jashari”, dhe që “Adem Jashari” në këtë vit të përgatitet për gara ndërkombëtare.

Është një vërejtje që në vazhdimësi viteve të fundit e kam paraqitur tek ministrat e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nëse ju kujtohet edhe në këtë Kuvend kam thënë se do të vijë momenti që Kosova do të pranohet në UEFA e FIFA dhe ne nuk do të kemi ku t’i zhvillojmë ndeshjet ndërkombëtare, prandaj Federata e Futbollit të Kosovës është dashur të bëjë marrëveshje me Federatën e Futbollit Shqiptar për të zhvilluar ndeshjen e parë historike për kualifikime për Kampionatin botëror në Elbasan.

Është një përgjegjësi, të cilën ministri i Sportit e bartë në barrën e vet, ndërsa e kemi mundësinë ta përmirësojmë me këtë rishikim të buxhetit.

Arsye tjetër pse duhet mbështetur këtë është se në vazhdimësi është investuar në palestra sportive dhe janë afër 20 palestra sportive të investuara nga paslufta, ndërsa FIBA ka pranuar vetëm 3 nga to, që do të thotë se palestrat e tjera sportive janë bërë jashtë standardit të FIBA-s, për arsye se Federata e Basketbollit nuk është konsultuar dhe Komisioni për infrastrukturë i Federatës së Basketbollit nuk është konsultuar fare nga Ministria përkatëse.

Dhe tani kemi ardhur në një situatë që edhe stadiumi i Prishtinës, i cili filloi këto ditë të rinovohet dhe me mbështetjen e të gjithë deputetëve, po edhe të Ministrisë, është kërkuar nga UEFA që stadiumi të ketë një rishikim nga ekspertët e tyre, me kusht që ai pas investimeve të pranohet nga ta. Përndryshe, nëse anashkalohet Federata e Futbollit dhe UEFA për pranimin e këtyre stadioneve, sigurisht se ne mund të investojmë në to, por ato nuk do të pranohen. Janë investime koti.

Dhe, te palestrat e tjera regjionale dhe stadiumet regjionale, që Ministria parciaisht planifikon të investojë shuma minimale, ato nëse nuk e kanë mbështetjen e komisioneve infrastrukturore të federatave përkatëse, janë investime koti, për arsye se nuk do të shfrytëzohen dhe nuk do të licencohen.

Ne kemi nevojë që në vitin 2017, bashkë me Ministrinë e Sportit të planifikojmë, po flas për amendamentin tim, zoti Grabovci, dhe po flasim për stadiumet, të cilat mund t’i planifikojmë që të kemi një në Ferizaj, një në Prizren, në Mitrovicë, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan, ku mund t’i zhvillojnë garat federatat e futbollit të Kosovës për kategoritë e reja U15, U17, U19 dhe të kemi stadione nacionale, dy stadione, në Mitrovicë dhe Prishtinë, për gara ndërkombëtare.

Kjo mund të bëhet me një planifikim serioz dhe me një gatishmëri dhe bashkëpunim të tëgjitha palëve të interesit, në këtë rast besoj që këto palë të interesit janë edhe deputetët, e në veçanti për interesin dhe zhvillimin e sportit.

Nuk mund të anashkalohen ata të cilët janë përgjegjës për hartimin e këtyre projekteve.

Prandaj, kërkesa ime që përveç shumës, të cilën e ka ndarë në amendamentin 9 Komisioni për Buxhet dhe Financa, t’i shtohet edhe shuma të cilën e kam projektuar unë.

Gjithsesi do ta arsyetoj edhe amendamentin tjetër që është amendamenti i dytë imi për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze në lagjen Jasharaj dhe kur jemi te çështja e specialistëve dhe specializantëve, nëse ju kujtohet, të nderuar deputetë, në vitin 2015 ka qenë pyetja ime parlamentare për ministrin, ka qenë pyetje parlamentare edhe e zotit Ibishi dhe e deputetit Muja, edhe disa kolegëve të tjerë deputetë.

Është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht i ministrit të Shëndetësisë menaxhimi human sipas Ligjit të shëndetësisë, neni 9.

Dhe, derisa ne nuk kemi pasur një menaxhim human nga Ministria e Shëndetësisë, këtë problem ne duhet ta zgjedhim si deputetë, për arsye se ky menaxhim human ka munguar, ka munguar nga planifikimi i specializimeve, ndarja e tyre dhe pastaj sistemi i këtyre kuadrove.

Se ne do të kemi probleme kadrovike, mungesa të kuadrove në këtë sektor është më se e evidente, por se në Kosovë ka kuadro, edhe ata duhet të protestojnë në vend të punës, është krejtësisht një keqmenaxhim dhe një keqtrajtim me vite dhe, së fundi, nga Ministria e Shëndetësisë.

Prandaj, ne po ndërhyjmë në këtë sferë si deputetë për të bërë një zgjedhje jo të përkohshme, por ne duhet të bëjmë një zgjidhje afatgjate dhe kjo zgjidhje afatgjate u takon atyre që kanë marrë përgjegjësinë, votën e këtij parlamenti për të udhëhequr me Ministrinë e Shëndetësisë që kjo zgjidhje vërtet të bëhet e të mos jetë pastaj një temë e diskutimeve mes deputetëve për poenë politike, po për zgjidhjen e këtij sektori edhe kësaj problematike në interesin e profesionistëve shëndetësorë, e në veçanti në interesin e pacientëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Veton Berisha, pastaj të bëhet gati zoti Danush Ademi.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni të jap disa konstatime brenda vetë ligjit aktual dhe propozimet për amendamente.

Duke qenë të vetëdijshëm që jemi në rishikim të buxhetit dhe mundësi për t'u bërë më tepër ndryshime dhe përtë pasur mundësi ndikimi për ndryshim të gjendjes është i vogël. Ne këtu, të paktën, e kemi mundësinë të deklarojemi dhe të shprehim qoftë kënaqësitë apo pakënaqësitë për implementimin e ligjit aktual, i cili është në fuqi. Përgjegjësitë e së cilës kemi marrë në janar të këtij viti dhe më saktësisht shprehë pakënaqësinë time rreth mos implementimit të nenit 10 të Ligjit aktual për buxhet të vitit 2016, i cili nen ka paraparë implementimin e programit për komunitetet, ndërsa deri më tani nuk kemi asnjë lëvizje, e cila ka filluar të implementohet.

Në anën tjetër, atë kohë, më kujtohet shumë mirë se ka qenë një prej kompromiseve më të mundshme që komunitetet pakicë t'i mbërrijnë çështjet, të cilat kanë qenë në interes vital për ta dhe tani në korrik jemi e nuk ka asnjë lëvizje.

Dhe, në atë kohë nuk kemi pasur mundësi të parashohim linja buxhetore për çështje të caktuara, sepse ka pasur të bëhej programi dhe brenda atij programi të implementohet. Atëherë cili është

mesi i kësaj dhe mbi cilën bazë dhe cila është garancia jonë që tani edhe në rishikim nuk ka pasur mundësi, por edhe në buxhet në nenin 10, cila është garancia që brenda këtyre 4-5 muajve të bëhet diçka dhe të hartohet programi.

Është jashtëzakonisht shqetësuese, sepse kërkohet që thuhet që për komunitetet ka fonde të mjaftueshme dhe duhet vetëm të aplikohet.

Vetëm po ju rikujtoj kanë mbetur 700 mijë euro nga Zyra e Kryeministrit për çështje të komuniteteve, ka pasur mbetje dhe, në anën tjetër, aty mbesin projekte të cilat nuk janë të implementuara.

Nëse po mendohet që vetëm prej këtyre zyrave të kursehet buxhetidhe të parashihet dhe të zhvillohet, atëherë mendoj se nuk është e logjikshme, sepse vërtet nga shqetësimet që janë edhe sot këtu komunitetet nuk arrijnë të kenë qasje në këto fonde.

Unë mendoj që në ato zyra ku janë të përqendruara fonde të komuniteteve, qysh është Ministria për Kthim, Zyra e kryeministrit për Çështje të Komuniteteve, duhet të ketë gjithë përfshirje, secili të jetë aty dhe të shikojë se si ka mundësi të implementohen.

Po e lus zotin ministër dhe Kabinetin qeveritar që të fillojnë me draftimin e programit, në mënyrë që nga ai program ta kemi mundësinë e ndikimit dhe qasjes tonë në program edhe në projekte dhe të mos jemi në komunitetet këtu të kushtëzohet votën për zero të cilat vërtet janë obliguese për ju, Qeveri e nderuar, dhe nuk është në rregull që ne të flasim dhe të kushtëzohet votën tonë për çështje elementare, ku ky shtet ka obligim ndreqjene jetësë njerëzve dhe të krijojë kualitet më të mirë.

Unë mendoj që komunitetet duhet të kalojnë nga kjo fazë e kërkesës dhe të kushtëzimit të votave për gjëra elementare, të kalohet në dhënie të kontributit në zhvillim të Kosovës, dhënie të kontributit në çështje që janë më madhore, por jo elementare.

Po ju them që në Komisionin e Komuniteteve dje është kërkuar dhe është insistuar të jenë tre bunarë në Buxhetin e Kosovës, vërtet është qesharake dhe është absurde një lloj i tij që të tentohet të krijohet jetë më e mirë përmes buxhetit të Kosovës.

Mendoj që secila njësi buxhetore duhet ta parashohë në fillim të vitit cilat janë nevojat e komuniteteve, cilat janë nevojat e gjithë qytetarëve dhe të parashohë programe dhe t'i zhvillojë komunitetet.

Çështja e dytë, po mendoj se duhet të japim kontribut, jam paka shumë i familjarizuar me problemin e specializantëve dhe specialistëve, sepse ata e kanë një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe në raport me trajtimin e qytetarëve në secilën formë, kushdo qoftë ai.

Nuk mendoj që do të kemi kualitet edhe trajtim të pacientëve në rast që të gjithë ata specializantë e kanë pothuajse të barabartë përgjegjësinë me mjekë, të cilët janë specialistë. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre nuk kompensohen, po në anën tjetër, ka edhe specializantë, të cilët gjatë ndërrimeve kanë përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe 24-orëshe dhe jeta e qytetarëve varret në

duart e tyre, ndërsa ata nuk kanë asnjë motivim për të qenë aktivë dhe të rregullt edhe ta kryejnë punën qysh duhet.

Mendoj, që ministri dhe vetë Komisioni ka sugjerua se duhet ta përkrahim që edhe specialistët, specialistët dhe kategori të tjera të cilët janë të rëndësishme për ne të mbrohen dhe të stimulohen. Zoti ministër, kemi para vetes aktualisht në Komisionin për Komunitete Ligjin për shërbyesit civilë.

Është neni 11, i cili parash rreth 10% të komuniteteve të jenë të punësuar minimumi, ndërsa statistikat janë jashtëzakonisht të pandershme me ato të dhëna që dalin dhe normalisht që duhet ndryshuar kjo gjendje.

Së shpejti do të vijë në Kuvend dhe do të rekomandojmë në raport me implementimin e atij neni. Ndërsa kudo që kemi shkuar, secila njësi, secili ministër, secili drejtor ka vullnet politik. Asnjëherë nuk thuhet jo, gjithmonë thuhet po, sepse tash po bëjmë politika, po më duket fushatë kudo që shkojmë edhe asnjëri nuk thotë jo, por kërkon që të parashihet buxhet nga vetë Ministria për Financa parashihet buxhet, sepse ata nuk kanë mundësi t'i paguajnësadoqë kanë vullnet. Atëherë ta kryejmë punën tonë si Kuvend, t'u japim mundësi buxhetore të gjitha ministrive të linjës dhe njërive të tjera, të cilat kanë për obligim të kenë persona të punësuar në administratë publike dhe mendoj që atëherë do t'u japim mundësi që ata të mos ankohen në buxhetin. Nëse jo tani, atëherë në buxhetin e vitit 2017 do të parashikojmë edhe me kohë dhe të mos vijmë në situata ku brenda ditës do të votojmë edhe nuk dimë çka po votojmë.

Mendoj që ka ardhur koha të ndryshohet qasja ndaj komuniteteve, edhe të mos ketë kushtëzime, të cilat vërtet janë qesharake, po të na bini në atë situatë që ne të kontribuojmë për zhvillimin e vendit, të njëjtën kohë, dhe të zhvillohemi bashkërisht me juve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ademi, fjala për ju, le të bëhet gati Shukri Buja, Qerim Bajrami e ka fjalën pastaj ministri dhe unë në fund.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kolegë deputetë,

Nuk desha ta marr fjalën, por të diskutojmë kemi të drejtë, s'kemi të drejtë dhe vendosa ta marr fjalën, duke llogaritur se kolegu im Gëzim Kelmendi e tha që është mirë të mendojmë për të diturit, njerëzite shkolluar, po unë dua ta them edhe një fjalë ndryshe: të diturit duhet të mendojnë edhe për të varfrit.

Këtë dua ta them, sepse shtresa e varfër është harruar nga Qeveria e Republikës së Kosovë.

Përderisa kolegu im e përmendi kërkesën, të cilën ne e kemi parashtruar amendamente në vitin e kaluar, i kemi parashtrua disa amendamente dhe kolegu Veton Berisha vetë ka qenë atëherë, ka qenë kundër këtyre amendamenteve, këtoi kam këtu para vetes dhe po ia kujtoj që i kemi kaluar, ky Kuvend i ka kaluar këto amendamente dhe deri më tani asnjëherë nuk janë aprovuar.

I jemi drejtua Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, neni 211 nënparagrafi. Projekti i konsoliduar për Kthim dhe Komunitete në kod 462 në tabelën 3.2, projekti me kod 12-380,

projekti për kthim dhe ndërtim për shtëpitë, nga këta një milion euro në dispozicion i kemi kërkuar 500 mijë euro të ndahen për komunitete dhe në këtë Kuvend i kemi aprovuar dhe asnjëherë nuk është implementuar.

Nënprogrami projekti konsoliduar për të kthyerit me kod 462, në tabelën 3.2, projekti me kod 12-714, projekt për komunitete, ku shuma është një milion e 900 mijë euro, kemi kërkuar 950 mijë euro të ndahen nga ky kod dhe në këtë Kuvend është aprovuar dhe asnjëherë nuk është bërë implementimi i këtij projekti.

Nënprogrami i projektit të konsoliduar për të kthyerit me kod 462, në tabelën 3.2, projekti për kthim ndërtim të shtëpive për të kthyerit në kodin 12-380, shuma e këtyre projekteve është për këto komunitete, të cilat i kemi kërkuar në vazhdimësi, por edhe në këtë Kuvend është aprovuar nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, Zyra e kryeministrit asnjëherë nuk janë pranuar, ku për komunitetin boshnjak kemi kërkuar 150 mijë euro, për komunitetin turk kemi kërkuar 125 mijë euro, për komunitetin ashkali kemi kërkuar 170 mijë euro, për komunitetin egjiptian janë kërkuar 60 mijë euro, për komunitetin rom janë kërkuar 30 mijë euro, por edhe këto mjete, të cilat janë aprovuar në këtë Kuvend, asnjëherë nuk është bërë implementimi i këtyre projekteve.

Ku projekti i konsoliduar për të kthyerit me kod 462, në tabelën 3.2, ku projekti për komunitete me kodin 12-714 i kushtohet projektit... si në vijim për komunitetin boshnjak janë kërkuar 285 mijë euro, për komunitetin turk 240 mijë euro, për komunitetin ashkali 170 mijë euro, për komunitetin egjiptian 120 mijë euro, për komunitetin goran 75 mijë euro dhe për komunitetin rom janë kërkuar 60 mijë euro dhe po në këtë Kuvend është aprovuar me shumicë të votave dhe asnjëherë nuk është bërë implementimi i këtyre projekteve.

Mu për atë, i nderuar kryetar, ne nuk kemi bërë amendamentetë reja, kemi pritur që ministritë të marrin planin e veprimit, të ndajnë mjetet për këto komunitete, të cilët veç i kemi aprovuar në këtë Kuvend dhe unë mendoj që edhe tash është momenti që ne si komunitete dhe unë personalisht do t'i votoj kundër këto amendamente, të cilat kanë ardhur këtu, sepse asnjë amendament i vitit të kaluar që është bërë kodi i veçantë për këto komunitete nuk është aprovuar dhe për atë e thashë në fillim. E mora Gëzim Kelmendin si shembull, të mendojmë pak për të edukuarit, të mendojnë për njerëzit e mençur, por unë e thashë prapë, i bëjë thirrje këtij Kuvendi, edhe ministrive le të mendojnë edhe për shtresën e varfër, e cila është anashkaluar dhe është lënë anash.

KRYETARI: Faleminderit! Vetoni ka replikë.

VETON BERISHA: Po mendoj përnjëmend po i vjen era fushatë pak, faktikisht nuk jam referenca unë, është Qeveria, janë problemet, implementimine ligjit e ka obligim Qeveria dhe nëse mendohet në këtë formë, mendoj se ka të drejtë plotësisht për shqetësimet, nuk janë vërtet ato çka i thotë, sepse ka arkiv edhe vërtetohet.

Në anën tjetër, është t'indrejtoheni Qeverisë për mosimplementim, po jo mua, sepse nuk mendoj se fitohen votat këtu, po atje përpara.

KRYETARI: Faleminderit! Mos e entuziazmoni shumë opozitën para kohe. Zoti Buja, fjala për ju, Danush, të pashë prapë, kundërreplikë. Zotëri Buja, Danush, po të kalojmë disi. Regjia Danush Ademiti ia jep fjalën.

DANUSH ADEMI: Nuk është fjala këtu për zgjedhjet, sepse vetëm ato nuk do të bëhen vetëm për mua dhe për Vetonit sigurisht, por bëhen për të gjithë kur t'i vijë koha.

Desha t'ia kujtoj Veton Berishës, se atëherë kur i kemi kërkuar ne këto amendamente që i ceka, ka qenë kundër.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Buja e ka fjalën, le të përgatitet zoti Qerim Bajrami, Shqipja, pastaj.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,

Edhe pse është leximi i dytë, e mora fjalën pas shumë diskutimeve të deputetëve dhe qytetarët që po na dëgjojnë sigurisht krijojnë përshtypje sikur i kemi zgjidhur të gjitha hallet e Kosovës dhe ka mbetur ta zgjedhim vetëm hallin e fundit, të specialistëve dhe specialistëve. Dhe normalisht duhet ta përkrahim buxhetin për specialistë dhe specialistë, edhe pse e dimë se në Kosovë shumë qytetarë kanë varfëri të skajshme, por normalisht që ne duhet t'i përkrahim specialistë dhe specialistë sepse qytetarët e varfër do të sëmuren dhe duhet dikush t'i kontrollojë, t'iu përshkruajë barnat, në qoftë se i kanë paratë, i blejnë, në qoftë se jo Zoti u ndihmoftë!

Normalisht që duhet ta përkrahim këtë buxhet për specialistë dhe specialistë, sepse shumë qytetarë të Kosovës nuk mund t'i shfrytëzojnë skemat sociale, sepse ky Kuvend ka aprovuar një ligj, i cili nuk i lejon ata që nuk kanë fëmijë nën moshën 5-vjeçare ta shfrytëzojnë këtë skemë, edhe atyre Zoti u ndihmoftë. Besoj që specialistë dhe specialistë të fushave të psikiatrisë munden t'u ndihmojnë.

Po ajo më e fundit është që duhet ta përkrahim këtë buxhet për specialistë dhe specialistë, sepse duhet të kemi gjithësi specialistë që bëjnë obduksionin e kufomave për qytetarët, të cilët bëjnë vetëvrasje për shkak të gjendjes ekonomike, e në veçanti atyre që bëjnë vetëvrasje, ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për shkak të gjendjes ekonomike.

Besoj që duhet ta përkrahim buxhetin për specialistë dhe specialistë të shëndetësisë, sepse si duket, në Kosovë nuk ka specialistë dhe specialistë të fushave të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami, fjala për ju, të përgatitet zonja Pantina.

QERIM BJRAMI: Faleminderit, kryetar!
Zahvaljujem predsedavajući!

Ja samo na startu hteo da odmah razjasnimo jednu stvar uzimajući u obzir da imam i ja ovde propoziranamandaman. Hoćemo li dobiti kasnije pravo da svako od nas obrazloži svoj amandman, ili to činimo odmah sada, s obzirom da je poslanik Haxhiju već to uradio.

Dali glasamo u paketu dakle, ili idemo amandman po amandman, trebamo znati, na čemu smo.

KRYETARI: Zoti deputet, do të shkojmë për shkak të sensitivitetit amendament për amendament, një nga një. Regjia, ju lutem, ia jep fjalën prapë deputetit.

QERIM BAJRAMI: Pra, unë do të lajmëroj kur vjen rasti ta sqaroj këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Në rregull, faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën, le të përgatitet zonja Tërmmkolli.

SHQIPE PANTINA: Megjithatë unë po jap vërejtjet për të gjitha amendamentet fillimisht, sepse kështu m'u krijua përshtypja se filloi diskutimi në përgjithësi për amendamentet, të cilat pastaj në tërësi do të hidhen në votim.

As në Komision, por as tash ne nuk do ta përkrahim amendamentin 3 që ka të bëjë me buxhetin e RTK-së, sepse vetëm në seancën e kaluar ky Kuvend nuk ia miratoj raportin, i cili dëshmon se ky institucion asnjëherë nuk i ka shpenzuar si duhet mjetet, të cilat ky Kuvend ia ka ndarë. Prandaj, ne nuk e përkrahim këtë amendament.

Vërejtje po ashtu kemi edhe tek amendamenti 5. Ndonëse ka disa nënkategori brenda këtij amendamenti, të cilat janë të arsyeshme dhe do të duhej të mbështeteshin, megjithatë mënyra siç janë grumbulluar si në tërësi, nuk do të mund të mbështeten. Për shembull, vërejtjet serioze që i kemi diskutuar edhe brenda Komisionit, por që deputetët përkundër faktit që nuk janë pajtuar me këto kalime, transfere, prapë në fund për shkaqe politike i kanë kaluar, janë, ta zëmë, shumat që shkojnë për subvencione dhe transfere, gjegjësisht shtatë mbështetës të Kuvendit. Janë diku 120 mijë euro që i jepen shtesë Kuvendit për këto dy kategori, të cilat do të mbulojnë vetëm udhëtime jashtë vendit për Zyrën e kryetarit.

Asnjë nga këto ndryshime, ndoshta ju na i shpjegoni tash pse kërkojnë 60 mijë euro shtesë, vetëm për kategorinë për stafin mbështetës politikë dhe të tjerat, të cilat të paktën në Komision janë thënë se do të jenë për udhëtime zyrtare, sepse kjo kategori tashmë është shpenzuar për paga dhe mëditje dhe sa kjo mandej shkon në funksion të rritjes së performancës së Kuvendit.

Po ashtu, të gjitha këto ndryshime nuk shkojnë mirë as në krijimin e kushteve më të mira për stafin, i cili punon. Tash e vetmja kategori e cila ia vlen të mbështetet është rritja prej 4 anëtarëve shtesë, të cilët do të shkojnë në punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe shpresojmë se edhe këtu nuk do të ketë keqpërdorime dhe këto pozita do të mbështeten fillimisht duke ofruar një përshkrim pune se çka do të bëjnë këta katër persona dhe pastaj edhe punësimi i tyre nuk do të bëhet me mbështetje politike, por në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht.

Neni tjetër, amendamenti tjetër, i cili vetëm të mërkurën ka ardhur në mbledhjen e Komisionit, nuk është diskutuar edhe të enjten, ka të bëjë me Zyrën e presidentit, gjegjësisht është amendamenti numër, më falni se nuk e di edhe si amendament, për të cilin zyra e presidentit i kërkon 200 mijë euro shtesë. Prapë edhe ajo nuk është arsyetuar sa duhet, aty janë sjellë në fakt fatura të shpenzimeve tashmë të krijuara, por nuk janë shpjeguar mjaftueshëm dhe po ashtu ka ardhur vetëm të mërkurën si amendament. E di që edhe ky ka kaluar po ashtu, përkundër vërejtjeve të deputetëve, ka kaluar për shkak të mbështetjes politike, por ne nuk e mbështesim dhe mendojmë se kjo formë është po ashtu e papranueshme.

Amendamenti të cilin ne e kemi mbështetur edhe në Komision, përveç specialistëve, është ai për renovimin e stadiumit “Adem Jashari”. Por, edhe këtu dua të bëj disa vërejtje.

Ndonëse është e nevojshme që ky stadium të rinovohet, Ministria e Kulturës është mirë që paraprakisht të tregojë se ku shkuan të gjithë ata miliona që u investuan në këtë stadium. Çka ndodhi që brenda një viti, ende pa u bërë një vit, ky stadium ka nevojë për riparime të tjera dhe e kemi parë nëpër media gjendjen në të cilën është sjellë tashmë ky stadium, ku edhe kushtet elementare në fakt mungojnë. Përkundër faktit se në këtë stadium janë investuar miliona.

Është e nevojshme që fillimisht të bëhet një hetim, ndoshta jo vetëm nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, por edhe nga Prokuroria për mënyrën se si janë shpenzuar ato para dhe ku shkuan, të cilat kanë qenë të destinuara për t’u investuar në aeroportin “Adem Jashari”, para se pastaj të kërkohen para shtesë.

Mirëpo nga që është e domosdoshme renovimi i tyre, ne nuk e kemi kundërshtuar këtë amendament.

Po ashtu nuk është dhënë shpjegimi i mjaftueshëm pse duhet t’i merren Ministrisë së Arsimit për t’i kaluar Ministrisë së Integritetit Evropian.

Ne e dimë gjendjen çfarë është Ministria e Arsimit, dhe si shtet është më se e nevojshme të investohet në përmirësimin e cilësisë në arsim, e jo për të dhënë para për fushata, të cilat edhe ashtu nuk përkthehen në rezultatet për të cilat dedikohen, por janë thjesht disa tenderë për kompanitë të cilat më vonë organizojnë fushata, në fakt, për zgjedhje për subjekte të ndryshme politike. Kështu që këto amendamente ne nuk i përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Pasi është kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, m’u duk më tepër ke arsytim ndaj partisë, se si mbani qëndrim. Ato në Komision për Buxhet, për Kuvend e ke parasysh auditorin, i ka të gjitha gjetjet, nuk besoj se ka dalë institucion më i mirë se sa Kuvendi.

Sa i përket një shume të parase, për hir të publikut, jo vetëm për ju, sepse ju të nderuar vetë e keni kaluar këtu 5 Shtatorin Ditën e Bamirësisë. Në përvjetorin e parë do të ketë nga kryesia e Kuvendit për zgjedhje një familje të varfër, e cila do të jetë, pasi është ditë e bamirësisë do të ndërtohet një shtëpi për një familje të varfër, të cilën Kryesia e Kuvendit e përcakton, kjo është arsyeja pse janë kërkuar mjete shtesë.

Sido që të jetë, mirë është, për paranë publike kur reagoni, veç mos të bëhet keqpërdorim. Urdhëro, po e ke fjalën. Shqipe, e ke fjalën, e kisha lutur se po ndërrohen prapë, po shtohen. Faton Topalli, jo Shqipja, njëherë Faton, edhe zonja Besa Gaxherri, pastaj e ka fjalën ministri dhe unë në fund 1 minutë.

SHQIPE PANTINA: A vërejtjet e mia tek amendamenti 5 që janë për organizatën buxhetore Kuvendi janë për pikën 1.1 dhe 1.2. Janë 60 mijë euro shtesë që shkojnë për anëtarët e Kuvendit edhe për stafin mbështetës politik. Në komision është diskutuar se këto janë kryesisht para që do të shkojnë për udhëtime zyrtare, për blerjen e biletave. Kështu është diskutuar atje, pa u dhënë

ndonjë sqarim shtesë pse do të ndodhë kjo, sepse këto kategori tashmë janë shpenzuar për mallra dhe shërbime dhe duhen para shtesë. Këtë nuk e kemi mbështetur dhe nuk do ta mbështesim as këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e ka fjalën, i kërkoj ndjesë se e kemi kaluar, Faton, edhe publikisht e përmenda, pastaj jeni ju menjëherë Faton dhe përgatitet zonja Gaxherri. Urdhëroni!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Shumë shkurtimisht nja dy fjalë. Natyrisht mendoj që duhet të miratohet ky ligj, por po më bëjnë pak përshtypje nganjëherë përpjekjet për politizim të disa çështjeve që mendoj se s'është mirë.

Ne e pamë këtu një përpjekje për politizim të çështjes së specialistëve, specialistëve, e tjerë, e tjerë. Mendoj që nuk është e arsyeshme e as e nevojshme të bëhet një gjë e tillë. Thjesht, ata njerëz nuk kanë nevojë as për lëmoshë dhe as Qeveria nuk ka asnjë arsye që t'u ofrojë një lëmoshë. Ata njerëz i duhen këtij shteti, i duhen këtij vendi për t'u punësuar. Edhe mendoj që Qeveria definitivisht duhet të marrë një qëndrim rreth kësaj çështjeje për punësimin e tyre.

Këto janë fusha ku duhen ekspertë, dhe kam frikë që në ato fusha ku na duhen më tepër njerëz të specializuar kemi deficit, përkundër asaj që në ato fusha ku s'na duhen shumë, kemi tepriçë, kemi mbipopullim, dhe mendoj që është koha e fundit ndoshta Qeveria të fillojë një politikë të re në fushën e punësimit, politika të reja në ripërcaktimin e nevojave, sepse kemi edhe një ndryshim të kërkesave të qytetarëve. Kemi nevojë jashtëzakonisht të madhe për gjyqtarë, kemi nevojë jashtëzakonisht të madhe për numër më të madh të shumë fushave të tjera ku kërkohen njerëz të specializuar, kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Topalli, fjala për ju, zonja Gaxherri bëheni gati.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Alma Lama bëri diskutimin e fundit këtu në Kuvend dhe e kuptova si diskutim të fundit dhe po e shoh që të gjithë deputetët po diskutojnë sikur kjo të jetë vërtet edhe seanca e fundit. Duket që shumë prej tyre kanë informacione që ky Kuvend po e përfundon mandatin.

Nëse është kështu, na e thoni të gjithëve, të diskutojmë të gjithë, le të jetë për të gjithë diskutimi i fundit. Në anën tjetër, duhet të them që njëfarë mënyre e keni humbur kontrollin në udhëheqjen e kësaj mbledhjeje të Kuvendit, sepse nuk po e dimë për cilën pikë të rendit të ditës, respektivisht për cilin amendament jemi duke diskutuar. Ka një konfuzitet të përgjithshëm, po flasim për të gjitha çështjet, ndërsa kështu mund të na shkojë mbledhja deri në nesër në mëngjes dhe prapë nuk kemi rregulluar çështjen.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Unë singerisht nuk dëshirova të marr fjalën për arsye se jam anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, këtë pikë të rendit të ditës e kemi diskutuar aq sa na është dhënë mundësia.

Sidomos, PDK - LDK janë pajtuar për të gjitha amendamentet, edhe unë kam menduar që nuk ka nevojë të marr fjalën, por pas gjithë këtij debati unë u nxita dhe dua t'i them disa fjalë.

Unë e kam parasysh dhe i kuptoj deputetët e opozitës kur e marrin fjalën, kur kritikojnë edhe me vend edhe pa vend, por unë nuk mund ta kem të qartë qysh në dy partitë politike, PDK dhe LDK, vijmë në seancë për ta aprovuar rishikimin e buxhetit e pajtohemi në komisionet përkatëse, ndërsa këtu dalin deputetë të caktuar dhe shprehin vullnete, pakënaqësi etj. Është e vërtetë që ka Rregullore të Kuvendit, edhe unë jam në mandatin e katërt, nuk e di administrata juaj tash qysh po ua interpreton Rregulloren, veç kur hyjmë në diskutim, jo po në aprovim të ligjit në leximin e dytë, çfarëdo ligji, nuk ka debat, ka amendamente.

Deputeti mund ta marrë fjalën kur propozon amendament. Në leximin e dytë aq më pak kur diskutojmë për Ligjin e Buxhetit që ka specifika të veçanta. Çdo propozim që del nga këtu sot dhe nuk është me miratimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, duhet të shkojë ligji në leximin e tretë, se ndryshe nuk mundet të kalojë.

Më vjen shumë keq nga kolegët e mi, sidomos nga zoti Adem, i cili është anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe dje hiq më larg e kemi diskutuar këtë ligj dhe jemi pajtuar për amendamentet dhe kur është fjala për specialistët që u bë këtu temë, dhe u derdhën lot krokodili edhe nga kolegët e mi, të cilët e kanë shkatërruar shëndetësinë e kanë sjellë në këtë gjendje që është, që sot të vajtojnë me lot, t'iu dhimbsen edhe shëndetësia, edhe specialistët, edhe specialistët. Por ne jemi pajtuar dje që kemi ndarë buxhet brenda mundësisë, brenda kornizës buxhetore, kemi ndarë buxhet për specialistët, ndërsa për specialistët kemi mbetur të diskutojmë që deri në fund të vitit të marrim vendim.

Sot nuk mund të kalojë ndryshe amendamenti, vetëm në qoftë se tërhiqemi nga seanca, shkojmë e diskutojmë, bëjmë amendament tjetër dhe vijmë në seancë e aprovojmë. Pastaj, edhe sa i përket këtij buxheti për Kuvendin, u nxita t'i them 2-3 fjalë. Kuvendi ka kërkuar rishikim 509 mijë euro. Më erdhi mirë, zoti Veseli, që ju e dhatë një sqarim që keni kërkuar para për ndërtimin e një shtëpie për të varfrit dhe që administrata nuk ka ditur ta prezantojë atë ditë në Komision për Buxhet dhe Financa dhe ne s'kemi ditur për çka jeni kah i ndani mjetet. Por sot edhe më çudi po më vjen që Kuvendi merr këso iniciativë të ndërtojë shtëpi për njerëz të varfër, kur ne e kemi një Qeveri, zoti Veseli. Edhe i kemi ndarë fondet për gjëra të tilla dhe tash në qoftë se ne do ta krijojmë edhe në Kuvend të Kosovës një Qeveri tjetër, atëherë ne duhet ta bëjmë një ligj për Kuvendin, dhe ta dimë që Kuvendi ka saq buxhet dhe Qeveria ka saq buxhet.

Sepse, nuk ka mundësi Kuvendi të ndërtojë shtëpi. Ne i drejtohem Qeverisë në emër të Kuvendit dhe Qeveria duhet ta ndërtojë atë shtëpi në qoftë se Kuvendi merr vendim. Por t'i ndajmë ne buxhet Kuvendit që të ndërtojë shtëpi për të varfrit, kjo është nonsens. Prandaj, përveç kësaj në rishikim, zoti Veseli, në rishikim është për stafin politik kërkesa për 60 mijë euro për bileta, edhe pse e ka buxhetin 600 mijë i ka për paga e mëditje, 60 mijë i ka pasur për mallra dhe shërbime, s'i kanë dalë stafit tuaj politik, jeni duke i kërkuar edhe 60 mijë tjera, dhe i kemi aprovuar, zoti Veseli.

Prandaj, ju kisha lutur kolegëve, ne kemi rishikuar mirë buxhetin, kërkesë për kërkesë. Nuk është as më e arsyeshme kërkesa e Kuvendit, as e presidentit, as e Ministrisë së Shëndetësisë, të gjitha

i kemi analizuar pa politikë në komision. Ju kisha lutur kolegëve, në radhë të parë sidomos ju që i përfaqësoni partitë politike, mos bëni politik kur vijmë këtu në Kuvend, ne sidomos që jemi në koalicion. Le t'ua lëmë opozitës që të marrë rolin e vërejtjeve ose të politikës, ndërsa ne duhet të punojmë.

Kryetarët e grupeve parlamentare është dashur të merren vesh për të hyrë në seancë të përgatitur. Unë s'po di deputetët që janë prezentë në koalicion s'kanë diskutuar fare në grupet parlamentare apo vërtet janë duke bërë këtu politikë, apo vërtet s'duan ta aprovojnë ligjin edhe po shkojmë në zgjedhje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sa më shumë po flasin deputetët, po zgjerohet lista e diskutimeve, pak pa emocione. Ne e kemi auditorin dhe i shikon. Për mua ndalni çdo gjë sa herë udhëtoj, udhëtoj në klasën e dytë çdoherë për hir të publikut, pasi më jepet këtu mundësia.

Edhe, shiko auditorin dhe ju që po udhëtoni çdo ditë, ndaluni pak, se unë s'kisha udhëtuar një herë në dy vjet për qejf. Urdhëro, zoti Muja, pesë herë e ke marrë fjalën, një minutë e ke, jo më shumë. Edhe zoti Kurteshi edhe njëherë e keni fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, vetëm një sugjerim desha për shëndetësi. T'i sugjeroj disa deputetë, qoftë pozitës ose të opozitës, ta lexojnë një punim të CISCO-s. Thuhet: "Kur doni të arrini diçka ndryshime të fuqishme në shëndetësi, filloni t'i edukoni politikanët".

Nëse shikohen të gjithë deputetët këtu, ose kanë aspirina ose paracetamola nëpër çanta, dhe mendojnë se e shërojnë vetveten, por nuk e mendojnë që edhe ata specialistë që janë pa para duke punuar, edhe duke u edukuar, varen prej nesh, e de facto jemi duke i dëmtuar edhe ata, edhe vetveten. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, fjala për ju.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Unë vetëm desha të them se janë dy gjëra që e karakterizojnë këtë projektligj në lidhje me rishikimin e buxhetit. Njëra është mikromenaxhimi, siç është ndarja e mjeteve për njerëz, të cilët nuk janë të punësuar, e që kjo Qeveri duhet të angazhohet dhe të krijojë mundësi të punësojë, sepse ne kemi nevojë për mjekë të cilët edhe për të tjerët, të cilët i kryejnë i shkollat në Kosovë dhe zgjidhjen e kërkojnë në Gjermani, edhe për njerëz, të cilët fare nuk ka nevojë ky shtet dhe paguan, siç keni marrë një vendim ose po i paguani pa vendim ata të Mbrojtjes Civile dhe nuk e di prej nga i merrni ato para, kjo është njëra anë.

Dhe, ana tjetër, për të cilën këtu pak u bë fjalë, shumë para po shkojnë për luks. Për shembull, këtu një gjë që u vërejt dhe askush s'e përmendi, Zyrës së Presidentit, i cili edhe ashtu e ka pasur për mallra dhe shërbime 940 mijë euro, ua keni dhënë edhe nga 200 mijë euro, do të thotë një shkollë, sepse kjo zyrë sigurisht ka nevojë edhe më tepër që t'i japim, sepse luksi nuk ka fund.

Unë mendoj që do të ishte mirë që kur shikohen këto gjëra të mos merremi me mikromenaxhime, por t'i plotësojmë nevojat reale të vendit dhe sidomos të shkurtojmë atje ku ka mundësi. Ato bëhen sidomos në situatat ku bëhet fjalë për luks, siç janë këto zyrat e këtyre shefave të mëdhenj.

Dhe, në fund, është krejt e padrejtë, totalisht e padrejtë që mjetet të merren nga Ministria e Arsimit dhe të çohen kudo qoftë tjetër.

Nëse diku kemi nevojë që të investojmë, duhet të investojmë në Ministrinë e Arsimit, mos merrni aty mjete se edhe ashtu shumë pak kemi ndarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, fjala për ju. Nuk ka më diskutues, edhe unë e kam një, pas meje kushdo të replikojë, po tani shkojmë në votim, edhe unë një minutë.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është mirë që problemi i shëndetësisë, respektivisht këtë rast i specialistëve dhe specializantëve po trajtohet kështu, sepse ky problem nuk është bërë këto dy vjetët e fundit. Ne ende s'i kemi bërë dy vjet që jemi në këtë Kabinet qeverisës dhe në listën që deri tash e kemi përpiluar në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ka specialistë që presin prej pak muajve e deri në 8 vjet për punë. Kjo demanton at që u tha më herët se në qeverisjen e kaluar nuk ka pasur specialistë të papunë. Shifra e këtyre specialistëve të papunë po rritet çdo ditë, sepse çdo ditë në Ministrinë e Shëndetësisë në mundësinë që ua kemi bërë në ueb faqen zyrtare po paraqiten me emër, mbiemër dhe shënimet të tjera të sakta të gjithë ata që kanë specializuar në fusha të mjekësisë dhe janë të painkuadruar në sistemin tonë shëndetësor. Po e theksoj këtë "të painkuadruar në sistemin tonë shëndetësor", sepse ka disa nga ta që me vjet kanë qenë të angazhuar në institucione të tjera qoftë ndërkombëtare, qoftë nëpër kompani të ndryshme farmaceutike dhe organizata të tjera dhe nuk kanë shprehur vullnetin që të prezantohen, sot i kemi edhe ata në listë.

Unë desha të them që sot po fillon, nëse bëhet ndarja e buxhetit, po fillon vetëm zbutja e këtij problemi, sepse 300 mijë euro nuk mjaftojnë për t'i mbuluar këta pesë muajt e ardhshëm nëse inkuadrojmë ata në sistemin tonë shëndetësor për pagesën e pagave për këta 100 e sa. Problemi është që duhet në ligjin e ri të buxhetit ne të sigurojmë vende të reja të punës, në mënyrë që këta specialistë t'i sistematizojmë në punë të përhershme dhe jo sikur tash që është bërë zgjidhje e përkohshme. Por specialistët e kanë informatën që zgjidhja me këtë buxhet është vetëm e përkohshme.

Një tjetër problematikë të specialistët e papunë është ajo çka e tha deputetja Tërmkolli, se në disa profile kemi mbingarkesë dhe është vështirë t'i sistemojmë nëpër klinika dhe spitale tona, sepse për profilet e caktuara nuk paraqitet nevoja konform standardeve, që disa herë u përmendën këtu.

Në anën tjetër, kemi fusha ose profile të specializimit dhe specialistëve, të cilët janë shumë deficitare në Kosovë dhe ata duhet të kalojnë disa vjet për t'u specializuar dhe për tu krijuar si kuadro. Unë në këtë rast dua të them që këta specialistët e papunë sot është dashur të kalojnë nga 6 vjet shkollim bazik dhe nga 5 deri 6 vjet shkollim specialistik dhe që do të thotë që kjo problematikë sot po reflektohet, a në fakt, gjenezën e ka shumë vjet më përpara, kur nuk është bërë një planifikim i mirë i regjistrimit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë konform nevojave të shërbimeve tona shëndetësore ose institucioneve tona.

Sot në Kosovë e kemi numrin e specialistëve ose të mjekëve, në fakt, për 1 mijë banorë më të ulët në Evropë, është 1.2 dhe e kemi faktin tjetër që sot po e debatojmë, kemi specialistë të papunë, por kemi edhe mjekë të përgjithshëm, të cilët janë të papunë dhe këtë të mos e harrojmë.

Unë po kaloj te kjo pjesa e dytë e specializimeve që është shumë më e ndërlikuar dhe unë dua të dëshmoj që Ministria e Shëndetësisë në këtë periudhën njëvjeçare e gjysmë ka punuar shumë në stabilizimin e kësaj fushe. E para që është bërë, është nxjerrë vendimi nga ministri i Shëndetësisë, nga unë do të thotë, që të ndërpritet mundësia e ndërrimit të specializimeve, sepse ka qenë një praktikë, të nderuar deputetë, që me vullnetin individual të specializantëve të ndërrohet specializimi një, dy e tri herë derisa ka përfunduar stazhi specialistik. Dhe, kjo sigurisht që e ka dëmtuar edhe arritshmërinë e përgatitjes profesionale të individëve të caktuar.

Prandaj, për ta stabilizuar këtë fushë unë e kam nxjerrë këtë vendim, të cilin e kemi modifikuar më vonë dhe që iu lejon individëve në specializim të ndërrojnë specializimin, por kanë disa kushte, sepse Kosova nuk e ka luksin të financojë specializime, të cilat më vonë nuk ka mundësi t'i sistemojë në sistemin e vet shëndetësor.

Unë po jua jap disa shënime se çka ka ndodhur, dhe e dyta që kemi bërë, jo, jo, i nderuar deputet, u ngrit çështja se s'ka shënime. Këtu i kemi disa kategori të specializimeve dhe sikur të ishin menaxhuar drejt dhe sikur të ishin përkrahur me buxhet politika e kuadrove në shëndetësi, nuk kishin ndodhur kategoritë A, B, C dhe Ç të specializimeve. Sot i kemi në sistem të specializimit 714 specializantë, pa llogarit 50 të mjekësisë familjare dhe deri në fund të vitit 2020-ne do ta kemi problemin e hapur. Do të specializojnë të gjithë këta dhe për të gjithë këta duhet të kemi ne vende të lira të punës.

Vetëm 252 specialistë të inkuadrohen në sistemin tonë shëndetësor janë mbi moshën 60-vjeçare, që nënkupton se deri në vitin 2020 me këtë numër të vendeve të punës që i ka sistemi ynë shëndetësor mund të inkuadrohen lirshëm 252 specialistë, sepse kaq janë mbi moshën 60-vjeçare.

Unë nuk po dua t'ju lodhi shumë. Nevojat për buxhet shtesë, jo jo duhet t'i jap disa sqarime edhe pak, nevojat për buxhet shtesë këtë vit për pagesën e specializantëve të papunë janë në 325 mijë euro. Vitin tjetër do të jetë 1 milion e 900 mijë euro shtesë dhe me kalimin e kohës kjo shumë do të zvogëlohet, por duhet menduar që ata specializojnë dhe prapë na paraqitet neve numër i madh i specialistëve të papunë. Ne duhet të bëjmë zgjidhje që tash edhe për buxhetin, për pagesën e atyre që s'paguhen, por edhe për krijimin e vendeve të reja të punës.

Unë kam ende shënime dhe t'u përgjigjem gjithë atyre akuzave, por nuk pajtohem dhe është shumë normale që unë e kam trashëguar këtë dhe po mundohemi ta stabilizojmë dhe ta sanojmë gjendjen. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit!

KADRI VESELI: Faleminderit! Këtë pjesën e Rregullores nuk po e interpretoj, edhe pse administrata po më jep shumë, do të ndalem vetëm tek amendamenti 12.

Në fakt, në bazë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë 100 milionë euro kalojnë çdo vit, bile kjo është e dhënë e vjetër. Vetëm në spitaline Maqedonisë, në varfërinë tonë. Në të njëjtën kohë nuk e dimë sa kalojnë në Serbi dhe në Shqipëri, kemi probleme të cilat janë të rënda, dinjitet i cenuar i mjekëve tanë, mjekë të papunë, edhe specialistë, të cilët punojnë edhe deri në 36 orë edhe kini parasysh se në çfarë situatë janë ata.

Krejt kjo situatë ka lindur para 7-8 muajve, pasi jemi edhe para publikut, një grup i specialistëve ka ardhur dhe kanë kërkuar takim pas shumë mundimeve tyre dhe njëri prej tyre, pesë ishin, në fakt. Njëri prej tyre tha: “Unë jam mbajtës i familjes” dhe “keni parasysh, unë duhet t’i mbaj fëmijët. Më duhet të punoj 24 orë në klinikë”. Familja e vet, prindërit e vet, pastaj edhe shoqëria kishte investuar për të gjashtë vjet sigurisht tash ishte në specializim. Tha: “Punoj në pjesën e emergjencës”, ministër i Shëndetësisë, tha edhe pas 20 orëve, 24 orëve që i bëj, kam edhe 12 orë se më duhet ta mbaj familjen, në Klinikën emergjente në Mitrovicë ishte ky doktori.

“Edhe llogaritni se çfarë gjendje psikologjike kam unë, sa mund të jem i qetë, t’i kontrolloj pacientët në qoftë se vijnë në mënyrë emergjente”.

Mendoni secili prej veti ta dërgoni fëmijën tuaj te ai mjek, atë mjek mund ta dërgoni në burg, e kryhet ajo punë, po atë fëmijë e humbni. Kështu e kemi gjendjen shëndetësore në Kosovë, më vjen keq, nuk është faji i askujt, nuk jemi këtu për fajësi, as ministrit aktual të Financave, i cili e ka problem buxhetin, se e kemi edhe guvernatorin atje lart, ka qenë ministër i Financave në të kaluarën, as i ministrit aktual i Shëndetësisë.

Është një vazhdimësi e probleme të cilat është kjo situatë, ne duhet ta zgjedhim. Ky shtet, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin përgjegjësi, të mos na terrorizojnë në rend të parë fëmijët kur sëmuren çdo ditë, të kërkojnë ndihma. Duhet marrë përgjegjësi ky shtet, edhe duhet t’i lëmë shakatë mes nesh, askush s’do të bëhet rehat në qoftë se mendon se ka para më shumë dhe do të arrijë të krijojë siguri të shëndetit të vet dhe të familjes së vet në qoftë se shohim fëmijë që s’mund të shërohen.

Mjekët në mënyrë të dinjitetshme duhet të fillojmë t’i trajtojmë, çdo kuadër duhet të mos i lëmë të ikin, edhe kjo lidhet me këta specialistë. Nuk guxojmë t’i lëmë në udhë. Dje apo pardje u bë një gabim, kanë kaluar vetëm specialistët që e kanë kryer. Jo, jo, duhet të kryhen edhe specialistët, të cilët janë në procesin e kryerjes, për arsye se nuk ka më turp për një shoqëri, për një Parlament, për një Qeveri se sa kur njerëzit doktorë mbesin rrugëve dhe punojnë roje.

12 vjet shkollë edhe prapë rojtar, çfarë kuadri është ai. Vendi më i varfër, jep para më së shumti, dhe në të njëjtën kohë kemi kuadro të tepërt, këto shaka duhet t’i lëmë definitivisht, duhet të merrni përgjegjësi ju dhe ne për arsye se veç mendojeni, secili prej juve ka familje, dërgojeni familjarin tuaj te ai specialist 36 orë e le t’ua kontrollojë, le t’ia japë ndihmën e parë në emergjencë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli e ka kërkuar fjalën.

FISNIK ISMAJLI: Zoti kryetar i Kuvendit, ju po flitni për turpin që po ndodh në Kosovë me sistemin e shëndetësisë, dhe nuk po flitni se kush e ka sjellë këtë sistem të shëndetësisë në këtë gjendje.

17 vjet ju keni udhëhequr bashkë me partnerët tuaj që i keni sot në koalicion, qysh mund të thoni ju se shëndetësia është në gjendje kaq të rëndë, kur vetë e keni sjellë këtu. Qysh keni fytyrë të arsyetoheni kur vetë e keni sjellë gjendjen deri këtu dhe qysh mund të thoni që ne s'guxojmë t'i dërgojmë fëmijët tonë nëpër spitale, kur asnjëri këtu s'i çon fëmijët nëpër spitale të Kosovës? Ndoshta janë 2-3 raste, edhe unë vetë nganjëherë, por kur ka rast të rëndë, edhe vetë detyrohem të dal jashtë shtetit.

Edhe mua më vjen shumë keq për këtë punë, edhe prindërit e mi është dashur t'i dërgoj jashtë shtetit s'ka mundur askush t'i ndihmojë këtu. Ju e keni sjellë në këtë gjendje, edhe ju nuk duhen së pari të brengoseni për fëmijët e njerëzve këtu që i çojnë jashtë shtetit fëmijët e vet të shërohen, por njerëzit që s'kanë pare e që vazhdimisht kërkojnë ndihmë gjithandej veç unë sa postimet në Facebook i bëj në javë për t'iu ndihmuar njerëzve për të mbledhur para, e është e turpshme kjo për t'i dërguar të shërohen jashtë vendit.

Edhe ju flisni këtu qysh të rregullohet sistemi shëndetësor tash e tutje, e 17 vjet jeni ju pikërisht ata që e keni sjellë në këtë gjendje.

Qysh s'ju vjen turp, more? Unë s'di qysh keni fytyrë, më së pari! Hiquni! S'di qysh keni fytyrë të rrini këtu, të dëgjoni dhe të bëheni kinse kurrgjë s'ka ndodhur për 17 vjet.

Bëni diçka, ose prisheni koalicionin sot dhe po hyjmë në zgjedhje, se këtu na e keni pru!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Veseli!

KADRI VESELI: Jo, kundër-replikë vetëm 1 minutë!

Në rend të parë, fytyrën e ka secili prej vete. Thjesht, ne po flasim për çështje të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesin e njerëzve, e ajo nëse prishet apo s'prishet ky koalicion, vendosim ne që jemi partnerë të koalicionit. Kjo s'varet nga ju. Por, te çështja e tematikës, urdhëro e voto po apo jo. Kjo është! Sot e kemi Buxhetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën!

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot po flasim, dhe e kemi një temë për disa qindra specialistë dhe njerëz që kanë specializuar, dhe është mirë që po merremi me këtë temë dhe këtu nuk po krijohet vetëm një buxhet për t'u dhënë rrogat vetëm për 6 muaj, por këta specialistë duhet paraparë si të punësuar gjatë tërë kohës, deri sa të dalin në pension.

Mirëpo, desha vetëm të ndërlidhem në një çështje. Ne sot i kemi 35 mijë njerëz që përfundojnë procesin e shkollimit dhe arsimin dhe të dalin në tregun e punës. Vetëm 9 mijë prej tyre, gjejnë vend pune. Diku 23 mijë nuk do të kenë vend pune fare, prandaj rëndësia e trajtimit të këtyre

çështjeve duhet të jetë prioritet i Qeverisë dhe i të gjithë deputetëve në mënyrë që këta 23 mijë njerëz të mos breshin rrugëve dhe të mos kenë synim shkuarjen jashtë Evropës.

Prandaj, shumë më brengosës janë këta 23 000 që do të mbeten gjithnjë pa punë se sa ndoshta 200 - 300 specialistë për të cilët jemi duke biseduar plot 2 orë rresht.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, në këtë projektligj janë propozuar 21 amendamente.
Amendamentet 14 deri 21 janë pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL, përkatësisht amendamenti 16 është tërhequr nga vetë zonja IzmaKu.

Ne do t'i votojmë amendamentet një nga një, për hir të korrektësisë.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Regjia, ju lusim, i thirrni deputetët!

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL e ka fjalën!

NASER OSMANI: Meqenëse në opinion ka një shkrim lidhur me këtë, për arsye se Qeveria e ka marrë një vendim lidhur me disa ministri, unë, si kryetar i Komisionit kërkoj që ministri i Financave të sqarojë çështjen e tërheqjes së mjeteve të Ministrisë së Integrimit nga Qeveria, sepse me këtë del sene kemi ndarë mjete në një vendim të Qeverisë, e cila i ka tërhequr. Prandaj, ministri e ka për obligim ta sqarojë çështjen e mjeteve të Ministrisë së Integrimit.

KRYETARI: Ministër i nderuar, nëse s'përton, merreni fjalën!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Më lejoni të ju informoj se në muajin prill, me kërkesë të ministrit të Arsimit dhe në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, janë ndarë 300 mijë për programin e bursave - fullbreit.

Këto mjete janë ndarë nga Ministria e Arsimit, janë marrë nga buxheti i Ministrisë së Arsimit nga mallrat dhe shërbimet.

Atëherë jemi pajtuar dhe kemi marrë vendim në Qeveri që të kontribuojnë 5 ministri të ndryshme, në fakt 6, duke e përfshirë edhe Ministrinë e Arsimit.

Ligji nuk na lejon që ne atëherë të marrim buxhet nga 5 ministri të ndryshme dhe t'i dërgojmë ato mjete në Ministrinë e Arsimit. Atëherë, kemi marrë vendim në Qeveri që 300 mijë euro të ndahen nga Ministria e Arsimit dhe në proces të rishikimit të marrim mjete nga 50 mijë nga 5 ministri të ndryshme, dhe t'i dërgojmë në Ministrinë e Arsimit dhe ta kompensojmë Ministrinë e Arsimit dhe të kontribuon Ministria e Financave, e Integritetit, Punës, Mirëqenies Sociale, Tregtisë, Industrisë dhe Bujqësisë. Pra, janë 6 ministri të ndryshme.

Është vendim i Qeverisë dhe sot është bërë edhe publik në ueb-faqen e Kryeministrit ku tregohet se si janë ndarë këto mjete. Dhe tash në rishikim, ne kemi marrë mjete nga 5 ministri dhe i kemi dërguar 250 mijë euro në Ministrinë e Arsimit.

Tash ju keni vendosur që t'i ktheni mjetet nga Ministria e Arsimit në Ministrinë e Integritetit, një shumë prej 30 mijë euro.

Kjo është e vërteta për këto mjete. Në procedurë, transparente. Në Qeveri mund ta shihni procesverbalin e mbledhjeve të Qeverisë, mund ta shihni vendimin e Qeverisë. Kjo është e vërteta për këto mjete, kryetar i Komisionit.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit Funkcional e kërkon fjalën.

NASER OSMANI: Kryetar, ishte më tepër kërkesë e imja që të jemi më transparentë para qytetarëve, për shkak të shkrimeve në media që ka dalë lidhur me këtë, gjëja si falsifikim. Kjo ishte ideja. Do të thotë, meqë kemi të bëjmë me para dhe financa, e nganjëherë qytetarët nuk na kuptojnë, kërkoja që ministri ta sqarojë qartë vendimin e Qeverisë dhe ne si Komision që e kemi prurë këtë amendament të kemi arsyetimin e plotë.

KRYETARI: Atëherë, gjithçka është në rregull.

Jemi te amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë të pranishëm 81 deputetë.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kush është kundër?

Meqenëse këtu, te amendamenti 11, shkojmë me elektronikë, pasi që ka kundër.

Së pari, pyes kush është pa kartelë?

Pra, të përgatitemi të votojmë amendamentin 11.

Tani, fjalën e kërkon kryetari i Komisionit, zoti Osmani!

NASER OSMANI: Para votimit, është e rëndësishme që deputetët të kenë të qartë se ky amendament të cilin e ka bërë Komisioni e ka bërë me qëllim që të krijojë mundësi Presidencës që të mund të funksionojë si institucion meqë presidentja e mëhershme në katërmujorin e saj i ka harxhuar më se 80% të Buxhetit. Dhe, pasi kishim mungesë të mjeteve, sidomos në mallra e shërbime, jemi detyruar që presidentit t'i qesim mjete në kuptimin e funksionimit të plotë të Presidencës.

KRYETARI: Faleminderit! Situata është e qartë dhe po e vazhdojmë votimin.

Lus regjinë dhe deputetët të votojmë për amendamentin 11 dhe votojmë tash!

80 deputetë kanë votuar. 67 deputetë janë për, 12 kundër dhe 1 abstenim.

Kalon amendamenti 11.

Jemi te amendamenti 12.

Në ndërkohë, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës e kanë një propozim. A doni ta lexoni, zoti Grabovci?

Nëse jo, po e lexoj unë propozimin.

Te amendamenti 12, pika 1.1, ku është “specialistëve”, shtohet “dhe specialistëve”.

Pra, ky është ndryshimi. Pra, shtohet dhe futet edhe kategoria e specialistëve për pagesë.

Atëherë, votojmë amendamentin 12, nëpërmjet elektronikës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kush është kundër?

83 deputetë kanë votuar.

79 janë për, 2 kundër dhe 2 abstenime.

Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14, i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e dëgjova arsyetimin që e dha kryetari i Komisionit për Buxhet, se kanë pasur vështirësi t'i strukturojnë këto, megjithëse këtu s'kemi të bëjmë me aq shumë mjete, ndoshta 40 - 50 mijë euro dhe është një sektor shumë vital për klimën investuese dhe për sigurinë e investitorëve.

Natyrisht disa janë çuditur pse ka shkuar nga Komisioni ynë dhe kjo ka shkuar për arsye se është fjala për kontekstet biznesore, dhe kemi pasur ankesa nga komuniteti i biznesit non-stop.

Ne e kemi trajtuar në Kuvend, janë aprovuar rekomandimet, janë aprovuar rekomandime në Këshillin Nacional për Zhvillim Ekonomik, kemi diskutuar dhe pastaj, dhe i falënderohem kryetarit të Këshillit Gjyqësor, që shumë seriozisht i ka marrë, për dallim prej shumë herë më parë, rekomandimet e Kuvendit, që shpeshherë nuk po ndodhë kështu, ka ardhur, ka biseduar dhe ka bërë një plan se si të tejkalohen këto probleme, sepse kontekstet biznesore janë duke zgjatur tej mase. Prej 800 konteksteve para 3 vjetëve, tash janë bërë gati 2 000 lëndë, dhe kontekstet zgjasin me vite.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor ka propozuar dhe nuk e di pse s'janë aprovuar këtu në procedurën e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Financave. Ai na e ka dërguar një letër në Komision dhe ne e kemi bërë këtë amendament për arsye se është për një çështje shumë të rëndësishme.

Unë e kuptoj edhe Komisionin për buxhet. Mund ta kuptoj edhe arsyetimin, e unë bisedova edhe ministrin e Financave dhe ne duhet të bisedojmë ndoshta për këta 4-5 muaj që kanë mbet dhe me një ristrukturim brenda ta zgjedhim këtë problem, por ju lutem që të kuptojë edhe Ministria e Financave, dhe të gjithë në këtë Kuvend, që prej vitit të ardhshëm çështja në këtë sektor të Gjyqësorit duhet të rregullohet. Nuk është kjo çështje e një komisioni, është çështje e një konsistence se a po duam ne të kemi investitorë, a po duam investitorë të rinj që janë të mbrojtur dhe të zgjidhim kontekstet brenda muajve e jo brenda disa viteve, sepse atëherë, vetëm flasim për investime.

Unë do të votoj për propozimin e Komisionit, por kërkoj që tani e tutje kjo çështje të merret seriozisht, dhe në qoftë se Kuvendi rekomandon dy herë, tri herë, duhet kuptuar seriozisht. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Zemaj e ka fjalën, le të bëhet gati kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Unë desha të shtoj apo të them se mbështes arsyeshmërinë që e dha kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, por kjo kërkon trajtim të veçantë dhe mendoj që Komisioni për legjislacion e ka mbështetur kërkesat buxhetore që kanë ardhur nga Këshilli gjyqësor, Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë dhe pothuaj të gjitha institucioneve që kanë apo bien në fushëvepritimarinë e sigurisë dhe sundimit të rendit e ligjit në vend.

Ajo për çka jemi dakorduar për këtë fazë, është që të rishikohet mundësia, sidomos në këto 3-4 dikasteret që të shtohet numri i zyrtarëve apo mbështetësve ligjorë, të cilët quhen bashkëpunëtorë profesionalë, por kjo duhet të shkojë apo të rishikohet me rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend.

Çështja për departamentin ekonomik është diskutuar edhe në të kaluarën dhe mendoj se duhet të bëhet zgjidhje adekuate, sepse rritja e numrit të lëndëve të cilat janë në procedurë bien pengesë në atë, që e tha edhe Profesori me të drejtë që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik apo edhe të pakënaqësisë të bizneset dhe investitorët.

Mirëpo, mbi të gjitha, nga këtu, nga sot po edhe nga rekomandimet që i kemi dhënë edhe për Ministrinë e Financave, por edhe për Komisionin për Buxhet e Financa, janë 3-4 kategori që i quajmë normal edhe kushtetuese, sidomos Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, është Avokatura Shtetërore për të cilën ka mbetur pak a shumë e pazbatueshme mënyra e financimit apo pagat e tyre sipas ligjit i cili është në fuqi dhe Këshilli Gjyqësor e Këshilli Prokurorial.

Andaj, nuk e di në këtë fazë se sa do të gjejë mirëkuptim ky amendament ose vetëm për këtë pjesë, por kjo duhet rishikuar për tërë sistemin gjyqësor në vend, sidomos për atë gjyqësor dhe prokurorial. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Osmani e ka fjalën, pastaj zonja Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Konsideroj që sado të kërkojmë dhe sado që ndajmë mjete për sektorin e drejtësisë, përsëri nuk do të mjaftojnë.

Ne kemi pasur kërkesa të shumta milionëshe, të cilat i kemi trajtuar dhe kemi konstatuar se ato do t'i trajtojmë me buxhetin e rregullt, sepse me rishikim është e pamundur.

Unë e kam kuptuar qartë pse ka ardhur kjo kërkesë prej Komisionit për Zhvillim, e që ka të bëjë thjeshtë me kompetencat që i takojnë Komisionit për legjislacion, sepse lëndët të cilat trajtohen në gjykatë, e që kanë të bëjnë me ankesa sidomos ato që kanë të bëjnë me Administratën Tatimore, në ndërkohë është pranuar drafti i ri dhe pritët të procedohet në Kuvend Ligji për Administratën Tatimore, ku këto lëndë do të kërkohej të rikthehen ashtu sikur që kanë qenë më herët dhe të mos trajtohen në gjykatë, por të trajtohen në Bordin e Ankesave, prandaj unë konsideroj se përkundër dëshirës së mirë të kryetarit të Komisionit për Zhvillim që të mbetemi pas qëndrimit të Komisionit Funkcional që ato amendamente që janë pa përkrahje të mos votohen, sidomos amendamentet të cilat nuk janë të plota, sikur ky që nuk është i plotë, sepse ky vetëm kërkon kohë të qiten mjetet por nuk precizon se ku duhet të bëhen shkurtime për t'u destinuar këto mjete të kërkuara.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Osmani, urdhëroni!

VJOSA OSMANI: Faleminderit kryetar!

Para një kohe KDI ka publikuar një studim sipas të cilit aty thuhet se është një paradoks që Kuvendi i Kosovës i ka diku 20 e më shumë juristë, përderisa janë me mijëra e mijëra lëndë të pazgjedhura në gjykata.

Në fakt unë këtë s'e shoh si paradoks, sepse nuk ka asnjë lidhje në mes të asaj se sa juristë janë në Kuvend dhe sa lëndë, sidomos kontekste biznesore, janë të pazgjedhura sepse nuk janë deputetët ata që i zgjidhin këto kontekste, mirëpo i vetmi kontribut që ne mund të japim si deputetë Kuvendit të Kosovës në këtë fushë është që gjyqësorit dhe në përgjithësi sistemit juridik në vend t'i ofrojmë një infrastrukturë, jo vetëm ligjore, por edhe infrastrukturë me njerëz të përgatitur e të cilët do të kenë mundësi t'i zgjidhin ato lëndë.

Kontribut natyrisht mund të jepet nëpërmjet numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve dhe personelit, e po ashtu edhe duke zhvilluar metodat alternative për zgjidhjen e konteksteve.

Por pse është me rëndësi sot që ky amendament të votohet në mënyrë që të hapet rruga që zgjidhja e konteksteve biznesore të kuptohet sa i përket rëndësisë së saj.

E para, siç u tha më herët, është për shkak të investitorëve të jashtëm, të cilët para se të lidhin kontrata, qoftë për të investuar, qoftë për biznese të Kosovës, i marrin parasysh ndër të tjera si pjesë e sundimit të ligjit edhe ligjet që i kemi miratuar ne, sa aplikohen ato, sa janë në përputhshmëri jo vetëm me 'acquis communautaire', por me standarde ndërkombëtare në përgjithësi e po ashtu edhe sa përmbahen vendimet dhe brenda çfarë afati mund të marrin ata një përgjigje apo një vendim nga gjykatat e Kosovës.

Deri tani, ne kemi qenë në nivel jashtëzakonisht të ulët edhe në krahasim me rajonin, sa i përket afatit kohor brenda të cilit i japim përgjigje bizneseve në kontekstet që lindin në mes tyre.

Kjo i dëmton jo vetëm bizneset vendore që mund të kenë çdo ditë kontekste në mes tyre, por mbi të gjitha interesimin e investitorëve të rëndësishëm.

Dhe, e fundit. Ne kemi dëgjuar kohë pas kohe këtu, sidomos Ministrinë e Drejtësisë, duke thënë - ne punën tonë e kemi përfunduar, u kemi rritur pagat gjyqtarëve, e kemi rritur numrin e prokurorëve, e kemi rritur mbrojtjen e tyre sa i përket sigurisë, e kemi ndërtuar Pallatin e Drejtësisë, e tjera, e tjera dhe tash ka mbetur vetëm politika për të mos u përzierë në drejtësi.

E po tash, ky amendament sot, po e dëshmon të kundërtën, sidomos me kërkesat për personel shtesë nga Këshilli Gjyqësor apo nga sektorë të veçantë po e dëshmojnë që një prej arsyeve është se nuk ka personel, nuk ka njerëz sidomos të specializuar në fushën më me perspektivë sot në Evropë, e cila është e drejta biznesore.

Prandaj, është me rëndësi që, edhe nëse do të ketë vështirësi t'i gjejmë mjetet, ne sot ta bëjmë hapin e parë. Pra, ne sot të tregojmë se duam t'u krijojmë kushte normale për punë këtyre gjyqtarëve, sepse për derisa shtetet tjera të zhvilluara krijojnë gjykata të veçanta, qoftë për falimentim, qoftë për konteste tjera të natyrës komerciale, ne sot po hezitojmë t'u japim atyre 2-3

punëtorë. Prandaj, do të ishte gabim të refuzojmë një amendament të tillë, siç është ky i propozuari sot nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik.

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë, fjalën e ka kërkuar zoti Rexhepi. Profesor, fjalën do ta merrni në fund, pas deputetëve.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë mendoj që Komisioni për Buxhet ka bërë gabim të madh. Nuk e ka vlerësuar drejt amendamentin e propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, aq më parë kur pjesa dërmuese janë ekonomistë dhe besoj që secili nga ta e dinë peshën dhe rëndësinë çfarë e kanë kontestet biznesore. Ka modalitete të ndryshme për të cilat u fol këtu dhe mundësi të ardhshme për t'u zgjidhur ato, por ne mendojmë se propozimi është shumë me vend, nuk janë mjetet më buxhetore, ndërsa kjo seriozisht do të ndikojë në zgjidhjen e këtyre kontesteve biznesore të cilat kanë po ashtu peshë të madhe, siç u tha, për sigurinë edhe të investitorëve por edhe të bizneseve në Kosovë.

Pra, është një temë që e ka përcjellë jetën ekonomike në vend, është një problem shumë i madh, prandaj unë mendoj se amendamenti i Komisionit për Zhvillim është me vend dhe duhet votuar në këtë Parlament.

Nëse ka ndonjë paradoks, siç e pashë sot këtu, që është debati prej 2 orëve që është bërë për marketing të gjitha grupet politike dhe që e keni votuar një amendament pak më herët, që i bie se nuk është në harmoni aspak me politikën buxhetore, me politikën që duhet të përfshihen të gjithë sektorët dhe të gjithë njerëzit në Kosovë, të jenë të barabartë.

U tha këtu nga shumë kolegë, e sidomos nga deputeti profesor Hamiti dhe të tjerë, prandaj unë po e përfundoj me këtë: Nëse keni bërë paradoks, edhe shkelje dhe gabim të rëndë ka bërë Komisioni për Buxhet dhe të gjitha ato kalkulimet që u thanë këtu në emër të asaj që nesër t'i fitojnë disa vota. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka profesor Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Po, unë mund t'i kuptoj vështirësitë dhe arsyetimet, që në qoftë se teknikisht është problem, mund të merremi vesh dhe në këta 3-4 muaj t'i tejkalojmë por unë po plodoj këtu që kjo të kuptohet se është problem dhe të zgjidhet, që është një problem me prioritet.

Kam përshtypjen se nuk është duke u kuptuar se është problem me prioritet, problem shumë i rëndësishëm për investitorët. Prandaj, unë mund ndoshta ta kuptoj teknikisht problemin dhe sa të mund ta lëmë kështu, por më nuk i pranoj arsyetimet për të ardhmen. Nuk mund të kalojmë në vitin e ardhshëm pa e zgjidhur këtë problem me buxhetin e ardhshëm. Nuk mund të kalojmë, ju lutem!

Prandaj, ne mund ta lëmë këtë amendament për 2-3 muaj, që kushton nja 30 mijë euro dhe OK, mund ta lëmë dhe mund të bëjmë ndoshta një përshtatje me dy ministrinë dhe me Këshillin Gjyqësor e ta tejkalojmë këtë problem deri në dhjetor, nëse veç është aq problem i madh ky. Por,

problemi im është për vëmendjen që po i kushtohet kësaj çështjeje. Prandaj, unë edhe kësaj here mund ta pranoj këtë, por prej buxhetit të ri e më tutje, nuk mund ta pranoj. Faleminderit!

KRYETARI: Profesor, zoti Zemaj e ka fjalën, se jemi afër votimit. Urdhëroni!

ARMEND ZEMAJ: Po diskutohet një çështje me të drejtë edhe nga fushëveprimtaria e një komisioni, i cili interesohet për zhvillimin ekonomik të vendit.

Ne jemi në bashkërendim të aktiviteteve me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial.

Sa për informim tuajin, vetëm këtë vit është konkursi për 61 gjyqtarë, domethënë për 48 gjyqtarë dhe 115 anëtarë të stafit mbështetës nga Marrëveshja e Brukselit dhe ky buxhet total duhet të gjendet për vitin e ardhshëm, sepse këtë vit buxhetor edhe ashtu nuk janë paraparë.

Andaj, mendojmë nëse nuk ekziston mundësia në këtë fazë për këtë numër të mbështetjes së profesionistëve, edhe kjo të futet si kërkesë plotësuese që në vitin 2017 të plotësohen këto vende, nëse e përcjell kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Çështja e bartjes së kësaj kompetence në Gjyqësor nga Administrata Tatimore, domethënë nga Bordi i Pavarur që ka qenë për Ankesa ka krijuar problematikë të vazhdueshme dhe nuk e ka zgjedhur këtë element, edhe sot është duke u diskutuar që kjo të rikthehet në formën e vjetër. Kështu që të mos ngutemi, sepse kjo do një analizë më të madhe dhe një konkludim ndërmjet dikastereve që janë të veçanta, të cilat i përmenda paraprakisht.

Sido që të jetë, unë e potencova që është mirë të shikohet mundësia e fundit e vlerës monetare që të përkrahet gjyqësori në të gjitha kategoritë, domethënë mënyra e kursimit mund të bëhet në shumë dikastere, por këtu nuk duhet të kursejmë.

KRYETARI: Faleminderit! Profesor, fjala e fundit është për ju dhe na trego të votojmë a të mos votojmë, apo do ta shtyjmë për 2017.

MUHAMET MUSTAFA: Po, shiko, këtu është amendamenti i Komisionit. Unë teknikisht e kam vështirë të jap zgjidhje. Mirëpo le të kuptohet problemi, le të bëhet një zgjidhje, dy ministritë edhe Këshilli Gjyqësor në buxhetin e ardhshëm, ju lutem, të mos kemi nevojë të diskutojmë më këtë çështje. Kaq!

KRYETARI: Ndërkohë zonja Tërmkolli e ka kërkuar fjalën dhe shkojmë në votim.

MELIHATE TËRMKOLLI: Shkurtimisht unë, ndoshta po më duhet ta përsëris edhe një herë këtë çështje.

Së pari, zoti kryetar, do të lutesha, ne s'kemi këtu as profesor, as doktor, as nuk kemi deputetë. Jo, deputetë jemi krejt, sa profesori është këtu, duhet të gjithëve t'u drejtohem profesorë, ose thuaju të gjithëve ose le. Nejse, kjo çështje nuk është krejt teknike, por ok!

Sa i përket amendamentit që u përmend, ju lutem shumë, unë ndoshta më së paku jam adhuruere e zgjidhjeve ad hoc. Kosovës nuk i duhen zgjidhje ad hoc, nuk duhet sot t'i marrë 2-3 veta në punë edhe prapë të mos zgjidhet problemi.

Unë, ju lutem shumë, po kërkoj edhe një herë nga Qeveria fillimin e hartimit të një politike të re të burimeve njerëzore në përgjithësi në institucionet shtetërore, sepse pa një politikë të re, nuk ka zgjidhje të problemeve. Ne kemi kërkesa të reja, janë kërkesa të reja edhe të qytetarëve, edhe të institucioneve.

Prandaj, me një rishikim të buxhetit këto nuk mund t'i zgjidhim ne sot, thjesht nuk mund t'i zgjidhim. Prandaj, ju lutem, le të mbetet kjo që ka thënë Komisioni për Financa, edhe për vitin e ardhshëm buxhetor duhet të mendohet shumë, shumë seriozisht për kërkesat, sidomos në profesionet deficitare që kemi dhe në kërkesat ku kemi deficit të zgjidhjes së çështjeve dhe problemeve me të cilat përballet vendi ynë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë po shkojmë në votim drejtpërdrejt.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë amendamentin 14 të propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Në dash po të them, profesor, në dash deputet, po amendamenti juaj kaloi. Urime!
36 vota për, 32 kundër dhe 10 abstenime. Kaloi.

Amendamenti 15.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Zonja Hadërgjonaj e ka kërkuar fjalën, të njëjtën kohë edhe zonja Zhivković.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dua të debatoj për çështje, të cilat u debatuan deri këtu, por dua ta them një gjë që është shumë e rëndësishme.

I kisha lutur deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i përkrahin amendamentet, të cilat në fakt i ka përkrahur Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës është ligj specifik, çdo amendament që përkrahet jashtë amendamenteve, të cilat i ka përkrahur Komisioni për Buxhet dhe Financa, ligjin e dërgon në lexim të tretë, sepse është e pamundshme të vazhdohet më tutje.

Ne e votuam më parë një amendament, ku flet për shtimin e numrit të të punësuarve, këtyre duhet t'u shtohet numri i të punësuarve në kategorinë paga dhe mëditje, por njëkohësisht iu kalkulohen edhe pagat këtyre të punësuarve. Prandaj, këto janë procedura, janë rregulla buxhetore dhe unë kërkoj nga deputetët që të jenë të vëmendshëm gjatë votimit dhe amendamentet, të cilat nuk janë votuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të mos votohen.

Dhe kisha kërkuar që të rikthehet edhe një herë në votim amendamenti i mëparshëm, përndryshe ne nuk mund të vazhdojmë tutje me miratimin e amendamenteve të buxhetit, por duhet të shkojë buxheti në lexim të tretë.

KRYETARI: Zonja Zhivković, fjala për ju.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Moje javljanje u vezi amandmana 15. Ako nastavljamo sa amandmanima ja bi samo da dam kratko pojašnjene vezano za amandman 15.

Komisija za zajednice je objedinila pojedinačne amandmane poslanice Emilija Redžepi i poslanika Čerima Bajrami, koji su imali isti cilj vezano sa ovim amandmanom i predložila Komisiji na usvajanje sa potpunim obrazloženjem.

Zamoli ću vas da poslanik Čerim Bajrami u ime Komisije da detaljnije pojašnjene u potrebi usvajanja ovog amandmana. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Bajrami, fjala për ju.

ČERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Zahvaljujem gospođi Živković na pojašnjenju,

Istovremeno koristim priliku da zahvalim svim članovima Komisije za zajednice, bez obzira na etničku i političku pripadnost, koji su jednoglasno podržali da se usvoji ovaj amandman, odnosno da Komisija za budžet i finansije još jednom razmotri svoj odluku odbijanju dva predložena amandmana i da prihvati amandman.

Takođe zahvaljujem ministru Arsimu Bajrami koji je ovde prisutan, i sa kojim smo raščistili neke pojmove koji su bili problematični tokom donošenja budžeta za 2016. godinu i u međuvremenu smo smanjili tražena sredstva na samo 50 hiljada, a tada je kao što svi znate bilo traženo 70 hiljada.

Dakle, traži se smo 50 hiljada evra za kategoriju plata i dnevnice da pređe na Univerzitet “Ukšini Hoti” u Prizrenu u organizacioni kod 0941, za otvaranje još jednog smera na bosanskom jeziku na Ekonomskom Fakultetu Univerziteta u Prizrenu.

Pozivan gospodina ministra financija Abdulaha Hotia, sa kojim smo takođe imali dogovor, da on sam odredi budžetsku kategoriju iz koje će preći ova sredstva od minimalnih 50 hiljada evra s obzirom da ovo što smo ovde predložili za transfer ne mora da bude kako je predloženo, a ono najbolje zna od dakle može se uzmu 50 hiljada za transfer za plate i dnevnice u Prizrenu.

Ne želim da spominjem ovde da ovaj smer čeka već tri godine za redom da bude otvoren. Da je bošnjačka zajednica bila razočarana što prošle godine nisu izglasana dodatna sredstva za budžet za ovu godinu, i da ove godine očekuje ovaj minimalni korak od svih poslanika iz ove skupštine da se uradi kao gest dobre volje za otvaranje tog smera za Bošnjake Kosova i za druge studente koje žele da studiraju na bosanskom jeziku.

Ja se u napred zahvaljujem svima vama i pozivam sve poslanike ovdje da jednoglasno izglasaju ovaj amandman, i istovremeno normalno odustajem od svog amandmana broj 20 a vjerujem da će i gospođa Emilija Redžepi takođe odustati od svog amandmana s obzirom da je cilj i namena isti. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë ministri i Arsimit ka kërkuar fjalën, fjala për ju, zoti ministër, akademik, profesor.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit shumë, i nderuar kryetar!

Dëshiroj vetëm të përkujtoj Kuvendin e Kosovës që me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2016, kur kjo çështje është ngritur atëherë, bashkë me ministrin e Financave kemi diskutuar dhe kemi kërkuar mirëkuptimin e deputetëve të komuniteteve pakicë që kjo çështje të shtrohet me rastin e rishikimit dhe e kemi gjetur këtë mbështetje dhe unë ju ftoj të përkrahim këtë amendament. Bëhet fjalë për hapjen e programit në gjuhën boshnjake në Universitetin e Prizrenit.

Jemi dakorduar mirë edhe me menaxhmentin e universitetit. Ky program do të akreditohet paraprakisht dhe ne po bëjmë gjithçka që nga 1 tetori të hapim këtë program në gjuhën boshnjake që pa dyshim është edhe dëshmi e qasjes proaktive të Kosovës ndaj mësimit për komunitete. Nuk është një shumë e papërballueshme, kështu që unë mendoj që ne duhet të gjejmë mirëkuptim dhe ta përkrahim këtë amendament.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani e ka fjalën, ndërkohë zonja Rexhepi le të përgatitet për fjalë.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit, zoti Naser Osmani, e ka fjalën.

NASER OSMANI: Shpesh po na i luajnë fjalët këta ministrat tonë. Unë domethënë nuk mund ta kundërshtoj si kryetar i Komisionit, për shkak se ministri ka kërkuar që nga mjetet e Ministrisë t'i barten mjetet përsëri në kuadër të ministrisë, po vetëm një kodi buxhetor.

Unë, kryetar, kam një vërejtje tjetër që po keqpërdoret nganjëherë edhe pozita e deputetit apo funksioni i deputetit për çka është i ngarkuar.

Komisioni për Komunitete nuk mund të bëjë amendamente për individë duke u thirrur vetëm që është komunitet.

Komisioni për Komunitete ka përgjegjësinë e saktë për çka i bën rekomandim Kuvendit, por jo të bëjë amendament vetëm pse i takon si individ komunitetit, kjo është e padrejtë dhe e papranueshme dhe kjo nuk ishte dashur të lejohej as rregullorë.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi, fjala për ju.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedniče!

Ja neću odustati od mog amandmana broj 19 i daću obrazloženje u skladu sa Ustavom Republike Kosova, član 57. tačka 4. i u skladu sa odgovornosti države prema manjinskim zajednicama i o

poštovanju Pravilnika o radu Skupštine. Vidite kako se zahvaljujem Komisiji za pravo interes zajednica i moramo se svi upitati i vi poslanici ovde da poslanici koji dolazi iz redova manjinskih zajednica utiču na jako važne odluke u Parlamentu Kosova, a u zadnje vreme svi predlozi i odluke koje donosi Komisija za interes zajednica se ovde ne poštuju.

Tako da gospodine Osmani molim vas da ovo što je naš ministar Arsim Bajrami danas dao kao predlog da se ovaj to uvrsti u budžetu, ja neću odustati od mog amandmana i daću obrazloženje u tački 19. Zahvaljujem!

KRYETARI: Zonja Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Ja ću pokušati da budem vrlo kratka sa pojašnjene o onome na šta Komisija ima pravo.

S obzirom da je Komisija za zaštitu i prava interese zajednice je stalna Komisija i da je obaveza i da je to Ustavna Komisija i da jeste obaveza Komisija da radi na svakom zakonu kako na svakom dakle i na Nacrtu budžeta i da Komisija ima više nego veći pravo da predloži amandmane, pogotovu ovaj amandman se ne tiče pojedinačne osobe, nego se tiče univerziteta. A ponavljam da se vrlo lako odbacuju amandmani one koje Komisija za zaštitu prava i interese predloži s obrazloženjem da ima drugi prioriteta. Nažalost u te prioritete se nekad moraju uključiti i potrebe zajednica i da apsolutno Komisija za zaštitu prava i interese zajednica ima pravo da daje amandmane a na samoj Skupštini odluka hoće te amandmane prihvatili ili ne. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e votimit, nuk ka deputet të lajmëruar për diskutim.

Shkojmë në votim të amendamentit 15. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 72 deputetë, 56 janë për, 8 kundër dhe 8 abstenime. Kalon amendamenti 15.

Më lejoni të theksoj një gabim, i cili është imi si kryetar i Kuvendit. E falënderoj administratën profesionale. Amendamenti i profesorit Muhamet nuk ka kaluar. Për arsye se i ka pasur 36 vota për, 32 vota kundër dhe 10 abstenime. Gjithsej janë 78 vota, do të duhej t'i kishte minimum 40 vota, ta keni parasysh se nuk ka kaluar.

Jemi te amendamenti 17. Deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Urdhëro, zoti deputet!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pas pranimi të Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA është më se e domosdoshme që të përgatisim këtë vit stadiumin “Adem Jashari” për garat ndërkombëtare dhe ka filluar renovimi i stadiumit të Prishtinës, i cili do të përfundojë vitin e ardhshëm.

Në muajin maj 2016, në vazhdimësi që nga ky muaj dhe tutje instruktorët e UEFA-së kanë qenë në Kosovë dhe kanë dhënë sugjerimet e tyre për dy stadiumet ndërkombëtare, të Prishtinës dhe të

Mitrovicës dhe sipas sugjerimeve të tyre stadiumi “Adem Jashari” është më për së afërmi për t’u përgatitur për garat ndërkombëtare.

Andaj, nevoja që të alokohet buxhet shtesë që është më se e nevojshme, që punimet të përfundojnë dhe që Kosova të luajë ndeshje kualifikuese për Kampionatin Botëror në Kosovë. Gjithashtu projekte të reja të përgatitura për investime në stadione të futbollit nga Ministria e Kulturës, Rinisë në të ardhmen të përgatiten bashkërisht me Federatën e Futbollit të Kosovës. Ky propozim imi, do të thotë 790 mijë euro të alokuara me amendamentin 9 dhe 844 mijë e 340 euro të planifikuara me amendamentin tim, do të bënë një shumë e cila do mundësonte përgatitjen e stadiumit “Adem Jashari” për gara ndërkombëtare.

Në tabelat buxhetore janë të planifikuara se ku të merren këto mjete dhe ku po dedikohen saktë, nuk bën asnjë ndryshim tabelor në kuptimin e makrobuxhetit, por ndryshimi është që disa projekte të vogla, 100 mijë e 200 mijë euro të planifikuara si projekte të reja këtë vit, të shtyhen për vitin tjetër. Ndërsa këtë vit ta përgatisim stadiumin “Adem Jashari” për garat ndërkombëtare dhe që vërtet sportdashësit tanë të kenë mundësi.

Ky amendament duhet të përkrahet edhe për një fakt tjetër, për arsye se në gjatë viteve të kaluara kemi pasur investime edhe në palestra sportive, për të cilat janë bërë pa konsultimin e federatave përkatëse, e Federatës së Basketbollit dhe Hendbollit.

Prandaj, sot nga FIFA kemi vetëm tri palestra të licencuara për gara ndërkombëtare. Ndërsa që të mos na ndodhë një çështje e tillë edhe në futboll, atëherë kërkojmë që investime të reja në stadione të qyteteve, si në Ferizaj, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë dhe në Gjakovë dhe në qytete të tjera të bëhen në koordinim edhe bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës, me komisionet infrastrukturore të tyre që këto stadione të licencohen për gara ndërkombëtare sipas kriteresh së FIFA-së. Në pajtueshmëri për këto investime shtesë është edhe çështje e Ministrisë përkatëse për Kulturë, Rini dhe Sport.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta mbështetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Haxhiu! Tani jemi para votimit. Jemi tek amendamenti 17 i sponsorizuar nga Bekim Haxhiu.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 29 për, 33 kundër dhe 3 abstenime. Nuk kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18. Deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Urdhëro, zoti deputet!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Gjithashtu te amendamentet, të cilat i propozojmë ne deputetët po anashkalohejmë në vazhdimësi nga ana e Komisionit përkatës, kur po trajtohen. Mendoj që do të ishte shumë e rrugës që kur kemi amendamente edhe në komisionet përkatëse parlamentare të bëjmë arsyeshmërinë e tyre.

Gjithashtu është një amendament shumë me rëndësi që të kalohet, ka të bëjë me konservimin dhe restaurimin e shtëpive në lagjen Jasharaj. Kam propozuar që këtë vit të startojmë me një shumë

të caktuar të mjeteve, të cilat pastaj në vitet në vijim do të planifikohen sipas projektit, të cilin do ta hartojë ministria përkatëse.

Duke ditur se liria të cilën e gëzojmë sot është arritur falë luftës heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe sakrificës së Jasharajve dhe popullit shqiptar në luftën e fundit. Kërkoj që të ndahen mjete për konservimin dhe restaurimin e shtëpive muze në lagjen Jasharaj.

Kompleksi memorial në Prekaz vizitohet çdo ditë nga mijëra qytetarë dhe prej pas përfundimit të luftës nuk është bërë konservimi e as restaurimi i shtëpive muze në lagjen Jasharaj. Është nevojë emergjente konservimi dhe restaurimi i këtyre shtëpive, sepse ato tani po rrezikohen të shemben dhe kështu do të humbnin faktin historike nga historia jonë më e re.

Prandaj, kërkoj mbështetjen dhe votën tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të këtij amendamenti.

Jemi te amendamenti 18, i sponsorizuar nga Bekim Haxhiu, votojmë tash:

Kisha lutur kolegët deputetë, të cilët janë prezentë këtu, të vijnë të votojnë. 59 deputetë kanë votuar, 33 për, 20 kundër dhe 6 abstenime.

Votojmë për ose kundër, po s'mund të procedojmë se nuk konsiderohet as i rrëzuar e as i kaluar.

Edhe një herë do ta përsëris për hir që të tentojmë ta përfundojmë këtë rend të ditës.

Ndërkohë deri sa të vijnë deputetët, zëvendëskryeministri e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Shala.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që për një projekt të tillë fonde do të duhej të kërkoheshin brenda skemës, po diku tjetër, sepse Kalaja e Prizrenit dhe e Novobërdës janë projekte të kontraktuara në ato shuma dhe kjo i bie që ne s'do të mund të realizojmë as projektin dhe s'do të mund të përmbushim detyrimet e kontratës nëse i marrim nga ato dy pozicione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I lus deputetët të votojnë. Amendamenti 18, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu. Votojmë tash:

60 deputetë kanë votuar, 40 për, 16 kundër dhe 4 abstenime. Ende nuk e kemi numrin e votave, duhet 61 deputetë të votojnë.

Atëherë, do ta vëmë edhe një herë në votim.

Kalojmë te amendamentet e tjera, e rikthehemi edhe një herë.

Secili e ka qëndrimin e vet, e voton si deputet.

Duhet 61 deputetë të votojnë, të kenë parasysh, përndryshe kjo mbetet, në fund të fundit, votoni ose për ose kundër. Bekimi e ka dhënë propozimin, ne që e përkrahim e përkrahim, ata që nuk

donë ta përkrahin le të dalin burrërisht, le të thonë jo edhe ndalni, bile veç të kalojmë, mos e bllokoni buxhetin krejt.

A të shkojmë një herë tek amendamenti 19, pastaj rikthehemi edhe një herë, se nuk po kalon.

Kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Beqiri, e ka kërkuar fjalën, edhe zonja Rexhepi po ashtu, po sigurisht për amendamentin 19.

ISMET BEQIRI: Unë nuk e di a dëgjuan të gjithë deputetët. Nga punët e kontraktuara nuk mund të merren mjetet, është veprim joligjor. Ju lutem, po na veni në një situatë, sepse po flasim për një kompleks të rëndësishë së veçantë që e kuptojmë plotësisht, por kjo çështje është dashur të sqarohet në Komision dhe Komisioni për Buxhet e Financa, për arsyet që janë profesionistë për momentin nga mungesat buxhetore apo ku e di unë, nuk e kanë paraparë këtë shumë, mos na vini në një situatë tash të luajmë, kushtimisht. Së pari po flasim me ndjenja, me emrin, vetë kompleksi e ka emrin Adem Jashari dhe tash kush është për, kush është kundër. Veprimi është joligjor, e tha ministri, nga punët e kontraktuara të merren paratë, kur është kontraktuar puna dhe mbesim as atje, as atje, nuk realizohen projektet. Nuk ke të drejtë ligjore, është e paligjshme, kolegë.

Po ju lus, mos na vini në një situatë të tillë që ne të votojmë për shkak se është veprim i paligjshëm të merren mjetet. Jo që nuk dëshirojmë t'i kemi këto mjete për kompleksin ose restaurimin, ose konservimin, ose ndryshimin, rregullimin e kompleksit.

Prandaj, vetëm po e sqaroj edhe një herë. Veprimi është i paligjshëm, amendamenti është i paligjshëm, sepse s'mund të marrësh para atje ku janë paratë e kontraktuara me projekte të tjera, kudo qofshin ato. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Emilija, a e keni kërkuar fjalën për amendamentin 19 apo për këtë.

Atëherë zotëri Haxhiu e ka fjalën. Shkojmë edhe një herë në votim, por po bllokohet gjithë projektligji, ta keni parasysh.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Para se deputetët dhe ministri të diskutojnë, është mirë ta kenë lexuar amendamentin dhe t'i kenë shikuar tabelat buxhetore, të cilat janë propozuar me ndryshim.

Ky është projekt i ri, ashtu siç është projekt i ri i paraparë për vitin 2016, ndryshimet të cilat i potencoi ministri. Nëse ministria ka bërë planifikime për këto projekte pa e pasur miratimin e Kuvendit si projekt të ri, është çështje ligjore për ata që kanë bërë kontrata pa e siguruar buxhetin, por ky propozim është shumë ligjor, bazohet në tabelat buxhetore, me ndryshime ligjore dhe planifikohet edhe për vitet 2017 dhe 2018 që vërtet restaurimi dhe konservimi i shtëpive muze në lagjen Jasharajve të ndodhë sipas planifikimeve.

Është planifikuar në mënyrë korrekte, prandaj kërkoj votën tuaj që vërtet kjo të fillojë këtë vit dhe pastaj vitin në vijim të vazhdojë.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë amendamenti 18.
Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.
Edhe një herë zëvendëskryeministri para votimit kërkon fjalën.
Urdhëro, zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Edhe një herë sipas Ligjit për Buxhetin 2016 Kalaja e Prizrenit dhe Kalaja e Novobërdës janë projekte të kontraktuara në këto shifra dhe propozimi i tillë nuk është i ligjshëm. Janë para të kontraktuara, aty po zhvillohen punimet dhe duhet të përfundojnë brenda këtij viti dhe brenda këtij viti ne duhet t'i paguajmë.

Nëse i marrim nga 50 mijë euro te secila, i bie që ne s'mund të paguajmë gjysmën e kontratës së Prizrenit dhe gjysmën e kontratës së Novobërdës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Besoj që është e qartë nga të dyja anët.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim,
82 deputetë janë në sallë, votojmë tash!
44 vota, 34 për, 7 janë kundër dhe 3 abstenime. Amendamenti mbetet kështu si është.
Vazhdojmë tutje.

Do të dalim në pjesën në fund, do t'u japim të gjithëve fjalën ta interpretojnë rregulloren, edhe në fund pastaj, po s'po mundem unë sepse secili ka interpretim të vetin.

Amendamenti 19.
Deputetja Emilija Rexhepi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, urdhëro, zonja Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvajulje predsedniče!
Ja sam Komisiji za budžet za politiku i financije podnela amendmand baziran na Ustav Republike Kosova, član 57 o pravima zajednica, i član 58 o odgovornosti države prema zajednicama i školovanju na maternim jeziku, iz razloga zato što imamo javnom podršku ministra Arsima Bajramija, i on je pozvao poslanike da glasaju. Takođe imamo podršku funkcionalne Komisije za pravu i interese zajednica.

Ja vas molim, molim sve poslanike iz redova PDK partije, LDK partije, Vetëvendosja, Liste srpske i "6+" da podrže ovaj moj zahtev i otvorimo novi smer na multietničkom universitetu u Prizrenu, smer ekonomie. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Unë jam i obliguar në bazë të procedurave, derisa ka ardhur para jush, unë nuk mund me vendim individual ta tërheq. Urdhëroni, votoni edhe e tërhiqni. Zoti Zemaj e ka fjalën.

Regjia, të lutem!

Vetëm pak, të shkojmë në bazë të Rregullores, të mos bëjmë gabime e që pastaj dalim thuajse s'kemi bërë asgjë.

Shkojmë e votojmë, ju e vendosni është çështje procedurale.

Amendamenti 19.
Deputetja Emilijja Rexhepi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash:

Faleminderit! 55 deputetë kanë votuar, 37 për, 14 kundër dhe 4 abstenime.

Më lejoni të theksoj diçka për arsye se po ka debat rreth çështjes kur nuk po kalon kuorumi në votim.

Administratës i kanë sjellë aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të procedojmë Projektligjin për buxhet pa votuar. U bënë dy amendamente, votoni për, kundër, abstenim, përndryshe jemi duke shkuar vetëm kot në procedura, se projektligjin nuk mund ta votojmë. Unë i jap fjalën secilit që dëshiron për procedura, po nuk mund ta votojmë, për arsye se është i dyti amendament e nuk po jepni përgjigje. Konsiderohet pothuajse i pavotuar, nuk ka kuorum.

Do t'u kthehemi amendamenteve 18 dhe 19 edhe një herë, ose duhet kaluar këtë pikë të rendit të ditës pa votim.

Amendamenti 20.

Deputeti Qerim Bajrami, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, urdhëro zoti Bajrami!

ČERIM BAJRAMI: Poštovani predsjedniče!

Ja ću govoriti veoma polako, da bi smo se svi razumeli.

I amandman broj 20, i amandman broj 19, i amandman broj 15 je isti amandman. Mi smo ovde ispred Skupštine glasali amandman 15, prošao je za, i ja sam rekao da ću povući svoj amandman 20.

Predložio kolegici, a ne mogu da namestim nikome ovde pored njoj, da takođe i ona to učini, i zašto se to nije uradilo ne znam, to je njena pravo da obrazlaže, ali da ne bi smo dovodili Skupštinu u nezgodnu poziciju, dakle mi smo izglasali istu stvar, s tim što da budem decidivan - u amandmanu br. 19 je drugi kod i nema izvor odakle uzeti sredstva. Prema tome, ako izglasate za ili u protiv, idu 100 hiljade evra za univerzitet u Prizrenu, što je mnogo dobro ako budu išli. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami, unë do të ju pyes, pasi janë të njëjtë: po të kishte qenë amendamenti 15, po të mos kalonte, a do të kishte thënë njëjtë?

Duhet të votojmë, kjo çështje është për hir të publikut, nuk e kam sjellë unë, e ka sjellë komisioni, është obligative që ne të procedojmë tani. Duhet të votojmë për secilin një nga një.

Zonja Emilija e merr fjalën, por ne do të votojmë prapë, e kemi obligim të votojmë për secilin një nga një.

EMILIJA REDŽEPI: Gospodine predsjedniče!

Da ne bi došlo do zablude i zašto je jedan pre toga ili drugi posle toga, apsolutno nije važno, pozivam Ministarku Bajrami još jednom da obrazloži kako će se ovaj Zakon glasati. Hvala!

KRYETARI: Ndërkohë, zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën. Ministri nëse e do fjalën, le të urdhërojë.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Kërkoj falje se këtu përnjëmend po bëhet, nuk do ta quaj “pazar”, sepse deputetët kanë të drejtë të paraqesin amendamente, ashtu siç kanë drejtë edhe komisionet.

Konkretisht, është për të njëjtin amendament, për të njëjtën shumë, për të njëjtin kod buxhetor që janë tri amendamente. Unë po ju kuptoj që ju jeni të detyruar sipas Rregullores ta hidhni në votim, por duhet vetë këta deputetë që i kanë propozuar, sepse si për amendamentin 15, me kod buxhetor, me kërkesë të njëjtë buxhetore, me institucion të njëjtë, ku merren këto mjete, është njëjtë sikur amendamenti 19 dhe sikur amendamenti 20.

Nuk e di çka po përsëritet dhe çka po kërkojnë që të përsëritet. Nëse e kanë për marketing për të treguar se duhet, se këta janë propozuesi, ose Qerimi, pse Emilija ose komplet komisioni i komuniteteve është diçka tjetër, dhe për këtë arsye edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa është detyruar që ta paraqesë këtu listën e amendamenteve.

Domethënë ky është amendamenti i njëjtë. Ju kisha lutur që për hir të transparencës, mund ta lexoni ju, ose ta lexojnë këta vetë, ose ta lexojë ministri i Arsimit.

KRYETARI: Kjo çfarë tha deputeti i nderuar është shumë korrekte. Zonja Emilija do ta kesh fjalën.

Të nderuar deputetë,

Përcaktohuni ose tërhiqni, se po flasim për të njëjtën çështje, vetëm po i ndërrojmë subjektet. Nuk e di se si është lejuar kjo në aspektin pse komisioni na e ka sjellë kështu. Ministri Bajrami e ka fjalën, pastaj zoti Osmani e ka fjalën dhe më pas Emilija.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Unë i ftoj deputetët e Listës “6+” që të kenë mirëkuptim, sepse ne e votuam te amendamenti 15 këtë çështje.

Dhe, kjo është me rëndësi, tash mendoj se amendamentet tjera në këtë çështje duhet të tërhiqen, janë krejtësisht pa objekt. Ne e votuam, e siguroam fondin për Universitetin e Prizrenit dhe të gjitha amendamentet tjera janë të parëndësishme. Kështu që, për shkaqe procedurale, është mirë që ato të tërhiqen që të mos votohen.

KRYETARI: Zoti Osmani e ka fjalën, zonja Rexhepi bëhet gati.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Po konsideroj që edhe deputetët janë lodhur nga pak, e tregoi saktë ajo që ka ndodhur. Deputetja Emilija Rexhepi ka bërë amendament dhe deputeti Qerim Bajrami ka bërë amendament, që janë dy amendamente të njëjta.

Dhe, Komisioni për Buxhet dhe Financa, të hënën, kur e ka shqyrtuar rishikimin, kur e ka amendamentuar, i ka shqyrtuar këto dy amendamente. Meqenëse ne nuk u kemi dhënë përkrahje të hënën, këta kanë shkuar të martën te Komisioni për Komunitete dhe ndikimin e tyre e kanë ushtruar që komisioni ka bërë amendament në emër të këtyre dyve dhe tash i kemi tri amendamente të njëjta. Dhe, me kërkesën e ministrit ne e aprovuam amendamentin, domethënë

bëmë bartje dhe tash është vetëm përsëritje dhe është pak vështirë për ta kuptuar pse ta tërheqim amendamentin, i cili është aprovuar.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Rexhepi, zoti Hasani, do të shkojmë pesë minuta në pauzë. Jo, do të qëndrojmë në sallë, vetëm duhet të mos na bllokoni. Duhet marrë një zgjidhje për arsye se proceduralisht jemi peng të procedurave pastaj.

EMILIJA REDŽEPI: Gospodine predsjedniče, g. Zemaj, Za procesverbal, i ako je bitno da čak i negativnih iskustava koje imamo u prošloj godini kada je "6+" grupa je predložio da se kod iz Ministarstva za zajednice i povratak i ured kancelarije premijera prebaci na nekom drugom kodu, to se nije do sada ostvarilo, i zbog toga tražim objašnjenje ponovo od gospodina Ministra kako ćemo i gde ćemo naći sredstva, nije uopšte problem da neko od nas povuče ovo, kako ćemo naći sredstva, i da li će se naši studenti septembra, oktobra i novembra upisati na tom fakultetu. Imamo jako negativnih iskustava i nećemo glasati budžet ukoliko ne podržite ovu tačku. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi duke u futur në diskutime shumë gjatë. Unë po e shoh se e kanë zorin e elektoratit, por sido që të jetë jemi duke u futur u zgjatur.

Zoti Hasani e ka fjalën, zonja Balje, zoti Berisha e ka kërkuar fjalën, por në fund do ta bëjmë një pauzë brenda sallës që të konsultohemi kryetarët e grupeve parlamentare dhe me deputetët që i kanë propozuar amendamentet këtu përpara.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për Qeverinë,

Kërkoj edhe një herë që amendamentin 17 ta futni në votim pikërisht për çështjen e fushave sportive, për rregullimin e tyre.

Ne veç sa jemi pranuar në UEFA dhe nuk e kemi asnjë stadium të rregulluar që i plotëson të gjitha kushtet. Prandaj, kthimi dhe një herë dhe votimi, dhe marrja e buxhetit nga fondi rezervë i shtetit është e mirë që ka mundësi ta zgjidhë këtë çështje.

Unë po kërkoj që deputetët ta votojnë amendamentin 17 dhe Qeveria ta sigurojë nga fondi rezervë buxhetin pikërisht sepse ndërtimi i këtyre palestrave sportive apo stadioneve do të japë mundësi që ne t'i rregullojmë, të paktën të jemi në garë për UEFA-n në futboll. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë cila është arsyeja që ne po kërkojmë të miratojmë edhe Ligj për sponsorizime të sportit. Nëse nuk i kemi këto, qysh duhet t'i kemi ato tjerat? Për buxhetin për 800 mijë euro ne mbetemi tash që asnjë klub nuk i ka plotësuar kushtet. Atëherë kur ishte festimi për "Ferronikelin" që po merr pjesë në garat e kupës së kampionëve, doli se nuk e ka plotësuar gjendjen financiare dhe nuk ka mundësi që Kosova të marrë pjesë.

Dhe, kjo tregon që ende nuk jemi të përgatitur. Pra, shtimi i këtij buxheti në rregullimin e fushave të sportit e krijon mundësinë edhe të pjesëmarrjes në UEFA. Prandaj, po kërkoj edhe një herë që deputetët dhe ju ta ktheni amendamentin 17 në rivotim.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Balje e ka fjalën, zoti Ibishi e paska kërkuar ndërkohë.

DUDA BALJE: Predsedniče!

Ja mislim da oko ovog amandmana za Univerzitet u Prizrenu nepotrebno napravili problem. Nama je amandman prošao, amandman je bio od strane g. Čerima Bajramija, podržan od strane Komisije za zajednice, Ministar je lepo objasnio i rekao odakle sredstva idu gde, a ja se uopšte se ne plašim da sredstva neće doći jer imamo obećanje od Ministra i ne vidim zašto. Vi možete da stavite na glasanje, ali ne vidim zašto poslanici da dva puta glasaju za istu stvar. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ibishi tash e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

I nderuar zoti deputet Bekim Haxhiu.

Lidhur me amendamentin 18, ju kisha lutur, pasi veç u fol më herët, mirëpo pasi që ka të bëjë për një shumë më të madhe në tre vjetët e ardhshme buxhetore, ju kisha lutur që të bëhet një kompromis dhe të bëhet një zgjedhje e mundshme me qëllim që ky vend, të them i shenjtë, të përmbillet, qoftë këtë vit buxhetor, por edhe vitet e ardhshme pasuese. Vetëm këtë desha.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, a ka mundësi deputetët të kthehen në sallë, po futemi në votime të të gjitha amendamenteve edhe një herë. Zonja Emilija, jemi në votim!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Lus deputetët të kthehen për votim, po vazhdojmë me çdo amendament një nga një. Urdhëro, zoti Sadriu dhe kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së e kanë kërkuar fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne sot ishim dëshmitarë të miratimit të disa amendamenteve që përmbajnë në vetvete implikime buxhetore, pa sqarimin se ku do të merren ato mjete.

Dhe, unë, jo që mendoj, por jam shumë i bindur që çdo amendament, i cili i kalon kufijtë buxhetorë, e vë tërë ligjin jashtë procesit të vlerës ligjore. Po më habit ministri i Financave, është dashur t'ua thotë këtë, dhe ta stopojmë. Më brengosi shumë kur biseduam për specialistët dhe specializantët. Edhe për specialistë nuk kishte kalkulim, e të mos flasim për specializantët. Ti po e merr një vendim si Kuvend duke e ditur paraprakisht që s'ke mjete për t'i paguar.

Prandaj, të mos marrim hapa të tillë se ju edhe Kuvendi përgjithësisht bien në pozitë të keqe.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në fazën e përgatitjes për votim të amendamenteve 18, 19, 20 dhe 21, e pastaj e kemi një propozim. Po shkojmë njëherë një nga një.

Jemi te amendamenti 18 edhe një herë. Bekim Haxhiu e ka fjalën, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E mbështes edhe propozimin e deputetit Hasani që të kthehet edhe neni 17, por kur jemi te neni 18 për Kompleksin “Adem Jashari”, restaurimin dhe konservimin e shtëpive-muze në Lagjen Jasharaj, që të kompletohet kjo. Në amendamentin tim i kam paraparë fondet edhe për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Tregoj që shuma e propozuar që të mos ketë ndryshime apo dëmtime anësore në projektet që ka Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që kjo shumë në dakordancë me ministrin e përkatës të jetë 50 mijë euro këtu dhe 50 mijë euro nga rezervat buxhetore shtetërore për këtë vit, dhe që kështu ta votojmë dhe në vitet në vijim pastaj të kompletohet sipas propozimit dhe amendamentit për vitet 2017 dhe 108, ashtu siç është e planifikuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi propozim konkret. A futemi në votim se kam disa të lajmëruar. Futemi në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për propozimin e deputetit Bekim Haxhiu.

Votojmë tash amendamentin 18.

67 deputetë kanë votuar. 87 për, 4 kundër, 6 abstenime.

Kalon amendamenti.

Jemi te amendamenti 19.

A shkojmë drejt në votimin e amendamentit 19, i deputetes Emilija Rexhepi, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Lus regjinë dhe deputetët të shkojnë në votim. Votojmë tash!

Faleminderit! 63 deputetë kanë votuar, 32 për, 28 kundër, 3 abstenim.

Ka kaluar amendamenti.

Tash amendamenti 20, deputeti Qerim Bajrami, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Zoti Bajrami, fjala për ju, në qoftë se e ke tërhequr që të mos futemi në votim fare. Regjia të lutem, deputetit Qerim Bajrami fjalën.

QERIM BAJRAMI: I nderuar kryetar!

Për shkak të seriozitetit të Kuvendit, duhet të jemi edhe ne seriozë. Unë kam thënë, në qoftë se nuk e keni kuptuar boshnjakisht, në rregull, që po e tërheq amendamentin tim 20, për shkak që të kalohet amendamenti 15.

Edhe të mos bëjmë shaka këtu, se opinioni po na përcjell. Tash e keni votuar, të ju them faleminderit edhe një herë për dy kodet 100 mijë euro për të njëjtën gjë. Faleminderit se Universiteti i Prizrenit ka nevojë për 100 mijë euro për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, është tërhequr amendamenti 20, deputeti Qerim Bajrami e tha atë që u desh. Jemi te amendamenti 21, zoti Mustafa, urdhëroni!

MUHAMET MUSTAFA: Unë vetëm sa për sqarim, të kuptoj çka kemi votuar, për arsye se zoti Bekim Haxhiu te amendamenti 18, nuk e pata të qartë nëse e tërheq tekstin që ka të bëjë me buxhetin e viteve 2017, 2018 dhe 2019, apo jo?

Sepse, ne sot nuk mund të votojmë për buxhetin e atyre viteve. Mund të votojmë vetëm për buxhetin e këtij viti. Kjo duhet të jetë e qartë në tekstin e amendamentit tij, pikërisht për hir të seriozitetit e mora fjalën.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, kemi votuar, tashmë kot e sqaron, ne votuam. Urdhëroni, zoti Haxhiu, por ne votuam.

BEKIM HAXHIU: Desha vetëm t'ia sqaroj Profesorit, sigurisht që s'e ka pasur vëmendjen në diskutim. E thashë ndryshimi për vitet 2016, 2017, 2018 mbetet sipas amendamentit të propozuar.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Kryetar, vetëm desha të sqaroj që amendamentet e propozuara në Ligjin për Buxhetin nuk futen si amendamente, por futen vetëm shumat. Domethënë tash në këtë rast shtohet shuma te Ministria e Kulturës vetëm për 100 mijë euro, por nuk shënohen këto fjalët tjera. Prandaj, është e panevojshme të intervenohet më tutje.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryetar, e kërkoja më herët fjalën, pikërisht te amendamenti 18, i cili u përkrah në formën dhe në propozimin të cilin e dha kolegu Haxhiu.

Mendoj që sa më shpejt duhet ta kemi një seancë në të cilën do të trajtohet raporti i Auditorit Gjeneral për vitin 2015 dhe të shihen edhe keqpërdorimet e parasë publike, konkretisht te Kompleksi Memorial "Adem Jashari". Qindra mijëra euro, jo në një vit, por çdo vit, dhe dikush duhet të japë përgjegjësi. Nëse ka mbetur që aty të vidhet paraja publike, atëherë nuk e di cili është obligimi ynë për të kërkuar përgjegjësi nga ata që e menaxhojnë këtë kompleks memorial. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç ta dallojmë kompleksin, në qoftë se ka diçka është çështje e gjyqësisë, por kompleksi duhet të dallohet. Atëherë, shkojmë tek amendamenti 21. Bekim Haxhiu e ka fjalën, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit, Besoj që vota e deputetëve ishte votë pro rregullimit të konservimit dhe restaurimit të shtëpive-muze, se kush keqpërdor dhe tek keqpërdor, unë e inkurajoj zotin Zemaj që të shkojë në organet e hetuesisë dhe t'i lajmërojë dhe unë e kërkoj një llogari edhe nga Qeveria, por edhe nga të tjerët, për arsye se investimet në Kompleksin "Adem Jashari" tani kanë mbetur në gjysmë dhe janë përfunduar apo s'janë përfunduar, kjo është për atë që e thotë zoti Zemaj, por jo për këto investimet e reja të cilat duhet të bëhen në shtëpitë-muze në tërë Lagjen Jasharaj, dhe ato të cilat janë në Kompleksin Memorial "Adem Jashari".

Por, për atë që e tha zoti Zemaj vërtet e përkrah që të ketë një vëmendje të raportit të Auditorit për arsye se duhet të konstatohet nëse kanë përfunduar punimet në Kompleksin “Adem Jashari”, apo s’kanë përfunduar. Dhe, që ato punime vërtet të përfundojnë një herë dhe përgjegjësit ta marrin një vendimmarrje sa u përket investimeve në Kompleksin “Adem Jashari” dhe në veçanti agjencia që e kemi themeluar si Kuvend të jetë në nivelin e detyrave dhe të përgjegjësive rreth mirëmbajtjes, investimeve, por edhe llogaridhënies sa i përket kësaj çështje. Unë inkurajoj zotin Zemaj që edhe kur të jetë raporti i Agjencisë për Memorialë të jetë aktiv në këtë çështje dhe të mos adresojë në çështje të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj po e shoh emrin tënd, a është kundër-replikë? Urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Kjo nuk kishte të bëjë me propozimin e kolegut që e dha, sepse jo tash, por nëse e kthejmë memorien, Kuvendi i Kosovës gjithmonë ka dhënë përkrahje të plotë buxhetore për ndërtimin e të gjitha kapaciteteve që i ka Kompleksi “Adem Jashari” në Prekaz.

Domethënë, këtu nuk ka asnjë dilemë, ekzistojnë të gjitha procesverbalet. Unë fola për raporte publike të Auditorit Gjeneral, janë në ueb-faqen e zyrës së tij për keqpërdorimet e parasë publike që kanë ndodhur gjatë procesit, qoftë të tenderimit në të kaluarën, qoftë në të tashmen e mëvonshme për vitin 2015. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu e ka kërkuar fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Nuk desha aspak ta marr fjalën në këtë pikë të rendit të ditës, por meqë po diskutohet disa herë dhe më nuk e di nëse jemi brenda apo jashtë Rregullores, dua të them edhe unë disa fjalë sa i përket Memorialit “Adem Jashari”, në Prekaz.

Sinqerisht, unë e mbështes shumë për t’u thirrur një seancë për ta shqyrtuar raportin e Auditorit dhe të gjenden ato të shkelura ose keqpërdorime që kanë ndodhur atje, por nuk guxojmë asnjëherë që për fajin e një individi, ose të një keqpërdoruesi, kushdo qoftë ai, të rrezikojmë dhe të mos ndajmë mjete për konservimin e shtëpive-muze të Jasharajve, sepse këto shtëpi, tashmë disa herë e kemi thënë në Kuvend, por nuk duhet të mbeten vetëm fjalë të Kuvendit, por thjesht duhet të veprojmë dhe thjesht sa më shpejt të marrim hapa konkretë, sepse rrezikon të humb historia më e re e popullit të Kosovës.

Nuk na duhet betoni, nuk na duhet bari, nuk na duhen kubëzat që janë të shtruara në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, në momentin kur ne na rrëzohen shtëpitë-muze në gjendjen në të cilën janë ato sot. Ndoshta është momenti i fundit që shteti i Kosovës, në këtë rast Qeveria, Kuvendi dhe kushdo tjetër që është kompetent të ndërmarrë hapa konkretë dhe të fillojë restaurimin e atyre shtëpive, ose thjesht konservimin e atyre shtëpive, përndryshe populli i Kosovës, gjeneratat e ardhshme do të na ndëshkojnë për humbjen e historisë sonë më të vlefshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rreth kësaj teme, që ta përfundojmë, drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës sot ka dërguar shkresë, e i bëj thirrje publike që të mos sjellë shkresa kur dihet se më nuk mund të merret parasysh, për arsye se nuk është serioze.

Ka mundur ta sjellë para një muaj dite, janë evidentuar, për ta pasur parasysh sot e ka sjellë dhe kërkon mjete shtesë. Në qoftë se kanë mbetur keq për mjete shtesë në vende të caktuara, ose për punëtorë, nuk është faji i këtij Kuvendi.

Shkojmë te amendamenti 21. Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli dhe grupi i deputetëve nënshkruesve të grupit, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja deputete, fjala për ju.

MEXHIDE MJAKU TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Me këtë amendament kemi kërkuar që në kuadër të shumës së paraparë për investime kapitale të planifikohet edhe investimi në ndërtimin e shtatores së Hyrë Emini - Mira, në vlerë prej 59 mijë e 459 euro e 50 centë dhe atë në kodin buxhetor 253 dedikuar për Agjencinë për Mbrojtjen e Monumenteve Memorialë.

Unë e vlerësoj se për dëshmorët nuk duhet të flitet shumë. Hyrë Emini ishte pjesëmarrëse aktive në luftën e UÇK-së, që nga themelimi i saj. Ishte pjesëmarrëse edhe në luftën e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit dhe po ashtu në Maqedoni.

Të nderuar deputetë,

Ajo dha shumë për ne, andaj kërkoj nga ju që ta mbështetni këtë amendament për ta ndërtuar shtatoren e dëshmores Hyrë Emini - Mira, sepse shuma e kërkuar nuk do të jetë e papërbalueshme për Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

E mbështes kërkesën e koleges Mexhide Topalli për faktin se u përmend këtu memoriali "Heroinat", e mendoj që në historinë e re të Kosovës kemi shumë pak shtatore, të cilat janë shtatore të grave që kanë dhënë shumë gjatë luftës.

Po ashtu, Hyrë Emini është heroinë e Kosovës dhe meriton që Komuna e Ferizajt ta ketë shtatoren e saj. E mbështes dhe kërkoj po ashtu nga kolegët deputetë që ta mbështetin këtë nismë të koleges Mexhide Mjaku-Topalli.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, jemi te amendamenti i 21, deputetja Mexhide Mjaku-Topalli dhe grupi i deputetëve nënshkrues të grupit, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me gjithsej 65 vota, 51 për, 7 kundër, 7 abstenime, votohet amendamenti 21.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 74 deputetë, 70 për, 2 kundër, 2 abstenime dhe Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal

Komisionet parlamentare, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 7 korrik 2016, e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

E ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Naser Osmani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ne projektligjin e kemi shqyrtuar, e kemi amendamentuar, e ka vetëm një amendament. Përndryshe, ky ligj e rregullon vendimin e Qeverisë që ka të bëjë me shpërndarjen e 4 milionëve për 12 komunat me më pak se 22 mijë banorë dhe konsideroj që është një projektligj të cilin duhet votuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj që është propozuar vetëm një amendament. Vazhdojmë me votimin e amendamentit nga Komisioni Funksional.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Votojmë në tekstin e projektligjin në tërësi me amendamentin e miratuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 68 deputetë, 65 për, 2 kundër, 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015

E kemi edhe këtë dhe përfundojmë, në qoftë se dëshironi që të mos shkojmë në pauzë, përndryshe pastaj vetëm për këtë pikë duhet të kthehemi, s'kemi tjetër pikë. A vazhdojmë? Më mirë është ta përfundojmë, e pastaj shkojmë në drekë lirshëm.

Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin vjetor. Guvernator, fjala për ju! Faleminderit!

GUVERNATORI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Veseli!

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Mustafa,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Bazuar në kërkesat e Ligjit për Bankën Qendrore kam kënaqësinë që sot para jush ta paraqes raportin vjetor të Bankës Qendrore për vitin 2015. Raporti vjetor i Bankës Qendrore është punuar nga stafi i Bankës Qendrore në fillim të vitit 2016.

Në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Bankën Qendrore, raporti është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore në qershor të vitit 2016, dhe i njëjti, bazuar në nenin 58, të Ligjit të Bankës Qendrore është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 10 qershor 2016.

Gjatë vitit 2015, Banka Qendrore ka arritur t'i realizojë objektivat e saj ligjore, ku vendin kryesor e zë sigurimi i një sistemi financiar të qëndrueshëm, i cili në masë të konsiderueshme e ka arritur mbështetjen për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjatë këtij viti, Banka Qendrore ka vazhduar t'i avancojë kapacitetet e saj institucionale në të gjitha sferat e fushëveprimit të saj, duke bërë kështu të mundur zhvillimin e vazhdueshëm në linjë me praktikat bashkëkohore të bankave qendrore.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe ofrimit të shërbimeve efikase për autoritetet publike, institucionet financiare dhe publikut, në përgjithësi. Ambienti global gjatë vitit 2015 u karakterizua nga zhvillimet më të favorshme krahasuar me vitet paraprake, duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në ekonominë tonë dhe në atë të rajonit.

Kontribut mjaft të rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë globale kishte rikuperimi i ekonomisë në Eurozonë, ku masat e lehtësimit sasior, të ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane, e forcuan kërkesën e brendshme. Në vitin 2015, norma reale e rritjes ekonomike në Eurozonë arriti në 1,6% krahasuar me 0,9%, sa ishte në vitin paraprak. Zhvillimet në Eurozonë u reflektuan pozitivisht në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, të cilat në përgjithësi e përshpejtuan ritmin e rritjes ekonomike.

Mesatarja e rritjes ekonomike në vendet e rajonit për vitin 2015 arrin në 2,4% nga 1,3%, sa ishte në vitin 2014. Presionet deflacioniste në Eurozonë vazhduan të jenë të pranishme edhe gjatë vitit 2015, duke parashtruar nevojën e vazhdimit të masave të lehtësimit sasior. Zhvillimet e çmimeve në Eurozonë vazhduan të reflektohen edhe në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, ku u regjistruan norma të ulëta të inflacionit.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 arriti ta përshpejtojë ritmin e rritjes ekonomike krahasuar me vitin paraprak. Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore, norma reale e rritjes ekonomike për vitin 2015 ka qenë 3,5%. Kur jemi te norma e rritjes ekonomike, Agjencia e Statistikave të Kosovës para disa ditësh ka dalë me të dhënat preliminare ku sugjeron se rritja ekonomike mund të shkojë deri në 4% dhe nga të gjitha institucionet do t'i presim të dhënat zyrtare të këtij institucioni dhe pastaj ato do t'i bëjmë pjesë të raporteve tona.

Kjo rritje ekonomike ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe të investimeve. Rritja e kreditimit bankar, si dhe rritja e remitencave kishin kontribut të rëndësishëm në rritjen e konsumit privat gjatë vitit 2015. Gjithashtu, edhe rritja e pagave të sektorit publik dhe të pensioneve në prill të vitit 2014 e kishte efektin e plotë për vitin 2015, gjë që rezultoi në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonominë e vendit.

Në të njëjtën periudhë, rritja e investimeve të huaja direkte dhe rritja e kredive të reja investive nga sektori bankar kontribuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private. Në anën tjetër, bilanci negativ i neto-eksporteve vazhdoi të ketë kontribut negativ në rritjen së ekonomisë së vendit. Ritmi pozitiv i rritjes ekonomike që e ka karakterizuar ekonominë e Kosovës gjatë të gjitha viteve të fundit, megjithëse jo i mjaftueshëm për ta adresuar sfidën kryesore të ekonomisë së vendit - papunësinë, ka arritur t'ia sigurojë ekonomisë së vendit një shkallë të stabilitetit.

Kjo ishte posaçërisht e rëndësishme gjatë viteve të krizës globale ekonomike, kur ekonomia e Kosovës ishte ndër ekonomitë e pakta në rajon që arriti t'i mbijetojë efektet e krizës pa u zhytur në recesion. Ky stabilitet makroekonomik në masë të konsiderueshme, ndihmuar edhe nga shkalla e lartë e stabilitetit financiar që gëzon vendi, por në të njëjtën kohë ishte faktor i rëndësishëm edhe për ruajtjen e vetë stabilitetit financiar.

Mbështetja e lartë e ekonomisë së Kosovës me importin e mallrave nga jashtë që buron nga pamjaftueshmëria e prodhimit vendor për t'i plotësuar kërkesat e brendshme, si dhe niveli i ulët i eksportit paraqesin një ndër sfidat kryesore të ekonomisë së vendit. Rritja e vlerës së importit në 3,8% gjatë vitit 2015, në krahasim me rritjen e eksportit me vetëm 0,2% bëri që deficitin tregtar në këtë periudhë të arrijë në shifrën prej 2,3 miliardë euro.

Deficiti i lartë tregtar vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor i deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale që në vitin 2015 arriti në 501,8 milionë apo 8,7% i bruto-prodaktit vendor. Sidoqoftë, kontributi i deficitit tregtar në deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale vazhdon të neutralizohet në masë të konsiderueshme nga remitencat.

Në vitin 2015, vlera e remitencave të pranuar në Kosovë arriti në nivelin 752,4 milionë, duke shënuar një rritje vjetore prej 8,5%. Përveç remitencave, që në vazhdimësi janë dëshmuar të jenë burim i qëndrueshëm i financimit të konsumit në Kosovë, kontributi i Diasporës kosovare në ekonominë e vendit shprehet edhe nëpërmjet shpenzimeve që ata bëjnë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë dhe nëpërmjet investimeve të tyre të huaja direkte. Në vitin 2015, investimet e huaja direkte në Kosovë e shënuan një rritje të konsiderueshme. Vlera e investimeve të huaja direkte të pranuar në Kosovë gjatë vitit 2015 arriti në 324,4 milionë krahasuar me vlerën prej 151,2 milionë euro, që ishte në vitin paraprak.

Pjesa më e madhe e investimeve të huaja direkte të pranuar gjatë vitit 2015 e kishin për destinacion sektorin e patundshmërisë, i cili pranoi 58% të investimeve të huaja direkte të pranuar në Kosovë gjatë këtij viti. Ndërsa, nga investimet e huaja direkte rëndësi të veçantë kishin edhe investimet në industri e ndërtim, të cilat mund të konsiderohen si faktorë me potencial më të madh të gjenerimit dhe zhvillimit ekonomik.

Republika e Kosovës vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm fiskal, karakterizohet me nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Deficiti i përgjithshëm buxhetor qëndroi në 1,4% të bruto-produktit vendor, duke mbetur kështu brenda kufijve të përcaktuar nga rregulla fiskale. Pozicion të favorshëm shfaq edhe niveli i borxhit publik, i cili në vitin 2015 arriti rreth 13% të bruto-produktit vendor.

Zhvillimi i tregut të letrave me vlerë në Kosovë gjatë vitit të fundit ka arritur mundësinë e financimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën kohë ka rritur alternativat investive në tregun e brendshëm për institucionet financiare që operojnë në Kosovë. E tërë kjo ka pasur ndikim pozitiv në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend, duke mësuar një qarkullim më të madh të kapitalit brenda ekonomisë së vendit. Zhvillimet e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në ekonominë e Kosovës vazhdojnë të jenë mjaft të ngjashme me zhvillimin e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Rënia e çmimeve në tregje ndërkombëtare, sidomos e çmimit të naftës, shkaktoi presione deflacioniste në nivelin global, posaçërisht në ekonominë e Eurozonës me të cilin Kosova realizon një pjesë më të madhe të shkëmbimeve tregtare. Rrjedhimisht, këto zhvillime u reflektuan edhe në Kosovë, ku në vitin 2015 u regjistrua deflacion prej 0,5%. Duke pasur parasysh se deflacioni në Kosovë është rrjedhojë e rënies së çmimeve të mallrave të importuara dhe jo rezultat i zhvillimeve brenda ekonomisë së vendit, rënia e çmimeve mund të konsiderohet se e ka rritur fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe ka nxitur rritjen e kërkesës së përgjithshme. Aktiviteti i sistemit financiar ka vazhduar të rritet dhe të ruajë shkallë të lartë të qëndrueshmërisë, duke përfaqësuar kështu një promotor kryesor të zhvillimit dhe stabilitet ekonomik të vendit.

Rritja e vazhdueshme e numrit të institucioneve financiare e kredibile të licencuara për të operuar në Kosovë ka bërë që ekonomia e vendit të përfitojë nga rritja e ndërmjetësimit financiar dhe përmirësimi i kushteve me të cilat ofrohen këto shërbime. Aktiviteti kreditor i sektorit bankar vazhdoi të rritet me ritëm të përshpejtuar si rrjedhojë e përmirësimit të kushteve kreditore nga bankat dhe rritjes së kërkesës për kreditë nga ekonomitë familjare dhe bizneset.

Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në mbi 2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7,3%. Në kuadër të sektorëve që shënuan normën më të lartë të rritjes së kreditimit bëjnë pjesë edhe sektorët që në të kaluarën kanë qenë më pak të kredituar dhe me norma më të ulëta të kreditimit, e një prej tyre është edhe sektori i agrobiznesit, që për vitin 2015 ka pasur rritjen e kreditimit në nivel prej 20,3%.

Megjithatë, struktura e kredive të sektorit bankar vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat përfaqësuan 51,2% të gjithsej kredive për ndërmarrje. Struktura e kredive e sektorit bankar në masë të madhe reflekton vetë strukturën e ndërmarrjeve që operojnë në Kosovë, ku ndërmarrjet tregtare kanë pjesëmarrje mjaft të madhe. Një diversifikim më i madh i strukturës së kredive të sektorëve më pak të kredituara të ekonomisë, por që kanë potencial për ta përshpejtuar zhvillimin ekonomik do të ishte mjaft i dobishëm për ekonominë e Kosovës. Mirëpo, për të ndodhur kjo, në radhë të parë kërkohet një aktivizim i madh i këtyre sektorëve, në mënyrë që të krijohen mundësitë dhe besueshmëria e nevojshme për kreditim nga bankat.

Një shembull konkret lidhur me këtë mund të merret sektori i bujqësisë, ku rritja e subvencioneve nga Qeveria ndikoi në rigjallërimin e këtij sektori, me ç'rast u shoqërua edhe me rritje të kreditimit bankar për këtë sektor. Natyrisht, ne i inkurajojmë edhe bankat që të jenë më proaktive në eksplorimin e mundësive që ofron ekonomia e Kosovës, pasi diversifikimet portfolës të tyre kreditore, duke ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të ambientit ku ato operojnë, krijojnë mundësi më të mira për vetë zhvillimin e mëtejshëm të afarizmit të tyre.

Përveç ritmit të përshpejtuar të kreditimit, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 përfitoi edhe nga përmirësimi i konsiderueshëm i kushteve të kreditimit nga bankat. Norma e interesit në kredi, që për një kohë të gjatë ishte në një nga barrierat kryesore për biznes, në vitin 2015 shënoi nivel prej 7,7%, që tash është e afërt apo e ngjashme me mesataren e normave të interesit në rajon, krahasuar me normën e interesit që një vit paraprak ishte 9,3% dhe shikuar sipas veprimtarive ekonomike rënia më të theksuar të normës së interesit u evidentua në kreditë për sektorin e bujqësisë, të cilat në vitin 2015 e kishin një normë mesatare prej 7,1% krahasuar me mesataren prej 11,3%, sa ishte në vitin 2014.

Zvogëlimi i normës së interesit në kredi, ndërmjet tjerash, reflekton rritjen e vazhdueshme të konkurrencës dhe efikasitetit në sektorin bankar, por edhe përmirësimin e ambientit të jashtëm afarist, ku mund të theksojmë ndikimin e reformave në sektorin e drejtësisë, siç janë përmbaruesit privatë. Këto reforma kishin ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e rreziqeve bankare, duke çuar kështu zvogëlimin e primeve të rrezikut. Kjo tregon se sa ngushtë janë të lidhura kushtet e kreditimit bankar me ambientin ku operojnë bankat, prandaj përmirësimi i mëtejshëm i ambientit afarist do të mundësojë që sektori bankar të ketë rol edhe më të madh në zhvillimin ekonomik të vendit.

Rënie e vazhdueshme e normave të interesit në kredi po ashtu pasqyron përparimet e vazhdueshme që ka bërë Banka Qendrore e Kosovës në zhvillimin e infrastrukturës financiare, gjë e cila ka dhënë kontribut të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit dhe lehtësimin e menaxhimit të tërheqjeve bankare.

Zvogëlimi i normave të interesit në kredi është nxitur edhe nga qëndrimi në nivel të ulët i normës së interesit në depozita, e cila në vitin 2015 ishte 1,2%.

Niveli i ulët i normës së interesit në depozita është rrjedhojë e nivelit të lartë të likuiditetit të sektorit bankar, gjë që ka zvogëluar kërkesën e bankave për depozita të reja.

Përshpejtimi i rritjes së kreditimit, së bashku me zvogëlimin e normave të interesit tregon se Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në lehtësimin e qasjes në financa për individ dhe biznese.

Përmirësimi i qasjes në financa paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të pasur një zhvillim më të madh ekonomik.

Burim kryesor i financimit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhur brenda vendit, të cilat gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sektorit bankar janë dëshmuar të jenë një burim i qëndrueshëm i financimit.

Në vitin 2015, vlera gjithsej e depozitave në sektorin bankar arriti në 2.7 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6,5%.

Gjatë vitit 2015 treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar shënuan përmirësim të mëtutjeshëm.

Cilësia e portofolios kreditore gjatë vitit 2015 shënoi përmirësim. Normat e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive gjatë vitit zbritën në nivel 6,2%, krahasuar me normën prej 8,3% sa ishte në vitin paraprak dhe qëndrojmë lart më mirë se sa vendet e regjionit, ku norma mesatare e kredive joperformuese sillet diku rreth 16%.

Sektori bankar vazhdon të ketë pozicion të fuqishëm të likuiditetit. Treguesit e likuiditetit janë rreth 45%, që janë lart mbi kërkesat rregullative prej 25%.

Po ashtu sektori është mirë i kapitalizuar dhe treguesi i kapitalit është në 19%, lart mbi kërkesat rregullative prej 12%.

Në anën tjetër, të hyrat e sektorit bankar gjatë vitit 2015 ishin më të ulëta krahasuar me vitin paraprak si pasojë e rënies së normave të interesit.

Profiti i sektorit bankar ka regjistruar ngritje, viti 2015 ka qenë viti ku sektori bankar ka realizuar profitin më të lartë dhe kjo kryesisht ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të normave të interesit në depozita dhe zvogëlimit të kredive joperformuese dhe nuk ka pasur nevojë që të ndahen provizione për mbulimin e kredive joperformuese.

Sa i përket sektorit të sigurimeve, vlera e gjithsej primeve të shkruara në vitin 2015 shënoi një rënie prej 2,6%, përderisa në të njëjtën periudhë gjegjësisht dëmet e paguara shënuan një rritje prej 13,8%.

Sektori i sigurimeve vazhdon të jetë më i brishtë për sa i përket performansës financiare, ku gjatë vitit 2015 humbja e sektorit shënoi rritje.

Kjo deri në një masë u ndikua edhe nga vendimi për zbritjen e tarifës së policës kufitare të sigurimit, veprim ky i ndërmarr me qëllim të lehtësimit të ardhjes së diasporës në Kosovë.

Sektori i mikrofinancave dhe sektori financiar bankar vazhdojnë të shërbejnë si burim alternativ i financimit, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe ekonomitë familjare.

Në vitin 2015 vlera e kredive të këtij sektori arriti në 82,4 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10,7%.

Megjithatë, kreditë nga ky sektor vazhdojnë të karakterizohen me norma mjaft të larta të interesit.

Për sa u përket parashikimeve të vitit 2016, Banka Qendrore e Kosovës del me vlerësim se rritja ekonomike për vitin 2016 do të sillet diku rreth 3,7%, e cila pritet të gjenerohet, si nga rritja e konsumit, ashtu edhe nga rritja e investimeve.

Në kuadër të funksionit rregullator financiar, Banka Qendrore gjatë vitit 2015 ka bërë një punë të vazhdueshme në avancimin e legjislacionit sekondar dhe në harmonizimin e këtij legjislacioni me standarde ndërkombëtare, duke krijuar kështu një kornizë rregullative që propozon zhvillimin e shëndoshë të sistemit financiar.

Numri i institucioneve financiare të licencuara nga Banka Qendrore në vitin 2015 ka shënuar rritje, duke kontribuar kështu në rritjen e konkurrencës në tregun financiar.

Po ashtu, gjatë kësaj kohe Banka Qendrore ka vazhduar t'u ofrojë institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbime përkatëse bankare, të cilat edhe i ka siguruar një ofertë kualitative dhe kuantitative të parasë së gatshme.

Ka vazhduar të ofrojë infrastrukturë efikase financiare, duke siguruar një sistem efikas të sistemit të pagesave dhe gjithashtu të gjitha ankandet e publikuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë përmbyllur me kohë dhe dyfishi i asaj se çka është kërkuar.

Vëmendje të veçantë kemi vazhduar t'i kushtojmë edhe avancimit të funksionit të brendshëm të Bankës Qendrore, duke siguruar një qeverisje të mirë kualitative, me ç' rast kemi ndërmarrë sisteme të qëndrueshme të kontrollit të brendshëm.

Pjesë e raportit të Bankës Qendrore janë pasqyrat financiare të audituara dhe bashkë me opinionin bashkangjitur të auditorit të jashtëm, i cili ka konstatuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Në përmbyllje, deputetë të nderuar,
Më lejoni t'ju falënderoj për vëmendjen dhe jam në dispozicion të gjitha çështjeve që mund të ngritën nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Guvernator, faleminderit! Kërkojmë falje në qoftë se ka pasur pak mosfokus. Tani, a dëshiron dikush të flasë, se s'po punon teknika. A ka dikush? nga LDK-ja nuk ka. Nga PDK-ja, Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe ka ardhur në përfundim se raporti është i detajuar me të dhënat siç e parasheh Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës dhe vota e Grupit Parlamentar për këtë raport do të jetë për.

Nga raporti shohim se kemi performansë pozitive pothuajse në të gjithë sektorët, të cilat i mbikëqyrë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Banka i ka realizuar suksesshëm aktivitetet për të cilat e ngarkon ligji. Vërehet se gjatë vitit 2015 kemi një sistem të qëndrueshëm financiar.

Banka Qendrore e Kosovës ka afruar shërbime efikase për autoritetet publike dhe ka realizuar objektivat e saj ashtu siç e parasheh Ligji për Bankën Qendrore.

Sipas vlerësimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, në Kosovë gjatë vitit 2015 ka pasur rritje ekonomike prej 4% si rezultat i rritjes së investimeve dhe konsumit privat, rritjes së remitencave, ndikimit të rritjes së pagave të sektorit publik.

Kosova ende përballet me deficit të lartë tregtar, që vërehet edhe nga ky raport i Bankës Qendrore, ky deficit është 2,3 miliardë euro.

Eksporti i mbulon importin vetëm me 12,3%, çka vërehet se ka ulje në krahasim me vitin 2014. Mbetet obligim i Qeverisë të rishikojë politikat ekonomike në mënyrë që të reflektojnë pozitivisht në zvogëlimin e deficitit të lartë tregtar.

Gjatë vitit 2015 remitencat kanë qenë 8,5%, apo më të larta në krahasim me vitin e kaluar, apo 752,4 milionë euro.

Nga raporti vërejmë se është rritur vlera e investimeve të huaja direkte, gjë që është pozitive dhe duhet vlerësuar, nga 152.1 milionë euro sa ishte vlera e investimeve të huaja direkte në vitin 2014, kemi rritje në 324,4 milionë euro në vitin 2015.

Normat e interesit, sipas raportit të Bankës Qendrore, janë zvogëluar në 7,7% që janë në nivel me vendet e rajonit, e krahasuar me vitin 2014 ka një ulje të këtyre normave për 1,6%.

Rënia e kësaj norme është evidente sidomos në sektorin e bujqësisë, që është për t'u vlerësuar, sepse sektori i bujqësisë është një nga sektorët kryesor që ndikon po ashtu në rritjen ekonomike.

Normat e depozitave kanë shënuar rritje të lehtë krahasuar me vitin 2014.

Norma e kredive joperformuese është zvogëluar për 2,1% krahasuar me vitin 2014.

Nga raporti vërejmë se ka filluar rritja e borxhit publik krahasuar me një ritëm pak më të lartë krahasuar me vitin 2014, shihet që borxhi i brendshëm ka rritje për 47,3% krahasuar me vitin 2014, për çka Qeveria duhet të jetë e kujdesshme në rritjen e borxhit në mënyrë që të mos ngarkojë gjeneratat e ardhshme me borxhe të shumta dhe sidomos rritja e borxhit të bëhet vetëm në ata sektorë, të cilët kanë impakt në zhvillimin ekonomik të vendit.

Të nderuar deputetë,

Edhe më tutje mbetet shqetësuese mosnxjerrja e Ligjit për mikrofinancat, ky sektor ka rritje të aktivitetit kredidhënës për 6%.

Mikrofinancat kanë realizuar profit për 2,5 milionë euro dhe është si rezultat i të hyrave më të larta, të cilat i kanë pasur në krahasim me shpenzimet me të cilat është përballur ky sektor.

Mikrofinancat veprojnë si organizatë joqeveritare me status të beneficuar, pra si organizata joprofitabile dhe nuk paguajnë tatimin në fitimin e realizuar. Çështja e tyre ka mbetur e parregulluar në mungesë të ligjit që e rregullon këtë fushëveprimtari të këtyre institucioneve, edhe pse Banka Qendrore e Kosovës bën mbikëqyrjen e tyre sipas rregullativës që është në fuqi.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka përkrahur rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për të votuar pro këtij raporti dhe i fton të gjithë deputetët e Grupit Parlamentar dhe deputetët e tjerë ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Osmani e ka fjalën. Shqipe Pantina është lajmëruar nga “Vetëvendosja” pastaj.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!
Unë do të flas në emër të Komisionit për Buxhet e Financa.

KRYETARI: Kërkoj falje, por ishte dashur në fillim të sqaroni këtë.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar,
I nderuar guvernator,
Të nderuar deputetë,
Banka Qendrore e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës i ka dorëzuar Kuvendit raportin vjetor të punës për vitin 2015 brenda afatit ligjor.

Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës ofron të dhëna për gjendjen ekonomike në përgjithësi, për ekonominë e Kosovës që përfshin sektorin real, sektorin fiskal, sektorin e jashtëm dhe sektorin financiar, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

Përveç kësaj, raporti përmban shërbime të siguruara për autoritetet, komunitetin financiar, publikun si dhe zhvillimet e brendshme dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës.

Ekonomia e Kosovës është karakterizuar me rritje të aktiviteteve gjatë viteve 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas vlerësimeve të BQK-së, norma reale e rritjes së brutoproduktit vendor ishte 3,5%. Rritja ekonomike gjatë vitit 2015 u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, bazuar në rritjen e konsumit dhe investimeve private, ndërsa konsumi publik dhe investimet publike vlerësohen të kenë shënuar rënie. Po ashtu rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e transfereve nga jashtë në formë të remitencave që kanë arritur shumën prej 752.4 milionë euro dhe kompensimin e punëtorëve, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në rritjen e konsumit privat.

Gjithashtu rritja e pagave dhe e pensioneve të sektorit publik në prill të vitit 2014 kishte efekt të plotë në vitin 2015, gjë që rezulton në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonominë e vendit.

Në të njëjtën periudhë, rritja e investimeve të huaja direkte që arrin shumën 324,4 milionë euro, paraqet një rritje prej 173,2 milionë euro, krahasuar me vitin paraprak, që ishte 151,2 milionë euro.

Niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë në vitin 2015 është karakterizuar me deficit prej 0,5% krahasuar me inflacionin prej 0,4% në vitin 2014.

Problem vazhdon të paraqesë deficitin i lartë tregtar, ku eksportet në vitin 2015 arritën vlerën prej 325.3 milionë euro, që përkon me një rritje të dobët vjetore prej 0,2%. Rritja kryesisht u atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të plastikës e gomës, si dhe eksporteve të pijeve dhe duhanit. Ndërsa vlera gjithsej e importeve në Kosovë arrin në 2,6 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3,8%.

Struktura e detyrimeve në sektorin bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 79.8% të gjitha detyrimeve.

Gjithsej vlera e depozitave në sektorin bankar të Kosovës arrin në 2,7 miliardë euro, në vitin 2015, që paraqet rritje vjetore prej 6,5% nga 3,6 sa ishte në vitin 2014.

Normat e interesit në kredi gjatë vitit 2015 kanë shënuar një rënie të theksuar. Norma mesatare e interesit në kredi është zvogëluar në 7,7, sa ishte 9,3 në vitin 2014 dhe norma mesatare e interesit në depozita arrin në 1,2%, nga 1,1 sa ishte në vitin 2014.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, indikatorët e paraqitur në raportin e guvernatorit para Komisionit për Buxhet e Financa, që konsiderojmë një raport të kompletuar dhe që paraqet të dhëna të duhura për ekonominë dhe gjendjen financiare në Kosovë, konsideroj se raportimi i guvernatorit drejtpërdrejt para deputetëve është një praktikë e mirë, të cilën duhet vazhduar.

Prandaj, Komisioni për Buxhet e Financa ka vlerësuar se raporti është gjithëpërfshirës dhe përmban të dhëna e informata që kërkohen me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë atë.

Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa dhe u rekomandon deputetëve të votojnë raportin e Bankës Qendrore.

KRYETARI: Faleminderit shumë, kryetar! Në të njëjtën kohë, për shkak të lëshimit të teknikës, sepse është dashur të fillojmë së pari nga Komisioni. Nga Lëvizja Vetëvendosje Shqipe Pantina e ka fjalën. Lista serbe e “6+” me radhë.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues! Në fakt, raporti i Bankës Qendrore të Kosovës prezenton të dhëna interesante, por për fat të keq, nuk janë fare inkurajuese dhe tregojnë për rrugën që e ka marrë vendi ynë drejt zhvillimit ekonomik.

Edhe guvernatori sapo prezantoi se një ndër sektorët apo të hyrat kryesore në fakt që vijnë në Kosovë janë ato nga bashkatdhetarët tanë, pra nga remitencat, shuma e të cilave në këtë vit ka arritur në 752,4 milionë. Por, e gjithë kjo para, e cila vjen në Kosovë nuk po ndihmon në

zhvillimin ekonomik të vendit, sepse këto para kryesisht shfrytëzohen për konsum dhe blerjen e produkteve, të cilat ne i importojmë. Pra, edhe diaspora jonë nuk po kontribuon direkt në zhvillimin e vendit, por më shumë po ndihmon në zhvillimin e ekonomive të fqinjëve tanë, produktet e të cilëve ne po i konsumojmë si import.

Prandaj, kjo do të duhej të ishte vetëm një shqetësim për Qeverinë, sepse ende ne po jetojmë nga ndihmat, të cilat kësaj here na vijnë nga bashkatdhetarët, gjegjësisht djemtë e vajzat tona që jetojnë jashtë vendit.

Do të duhej të ishte natyrisht lajm i mirë fakti se sektori bankar ka shënuar sukses dhe ka shënuar fitim edhe në vitin e kaluar. Por, kur e dimë faktin se nga 10 banka që operojnë në Kosovë, vetëm 2 nga to janë vendore, për të cilat pastaj mund të konkludojmë se edhe fitimet e tyre i investojnë dhe i kthejnë prapa në Kosovë, përderisa 8 banka të tjera janë banka të huaja. Ato kanë ardhur në Kosovë dhe me çmimet e tyre dhe norma të larta të interesit dhe sidomos kohët e fundit me rritjen e çmimit të shërbimeve. Vetëm të kujtojmë se për një transfer të vetëm qytetarët tanë paguajnë deri në 5 euro dhe ajo çka po bëjnë këto banka është se po i zhvatin qytetarët e Kosovës dhe fitimet e tyre natyrisht se i dërgojnë tek shteti nga ato vijnë.

Te raporti i Bankës Qendrore, kur flitet për licencimin, thuhet se me rastin e licencimit të bankave të reja duhet të ndiqet parimi i drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Megjithatë, edhe vetë guvernatori e ka pranuar se nuk ka trajtim të njëjtë të bankave, ato që janë vendore u nënshtrohen kontrolleve më të mëdha, sepse bordet e tyre duhet të jenë vendore, ndërsa ato që janë filiale të huaja nuk kanë kontroll të mjaftueshëm këtu, sepse bordet e tyre operojnë jashtë dhe këtë në një mënyrë ua mundëson edhe ligji.

Mirëpo, zotëri guvernator ka qenë edhe ministër më herët dhe nuk e di pse nuk ka bërë ndryshime në ligj në kohën kur ka qenë ministër i Ekonomisë dhe Financave, në mënyrë që bankat tona të mos diskriminohen dhe t'u nënshtrohen kontrolleve më të rrepta, që është gjë e mirë, por pse të njëjtave kontrolle nuk u nënshtrohen edhe bankat e tjera, të cilat tek ne operojnë si filiale.

Edhe tani në raport, ndonëse Banka Qendrore bën kontroll dhe i monitoron bankat, mirëpo nuk kemi parë ndonjë rekomandim se si do të mund të përmirësohej edhe performansa e tyre, nëse është e nevojshme, por mbi të gjitha si do të mund të përmirësohej infrastruktura në atë mënyrë që të jenë qytetarët përfitues nga shërbimet e bankave, e jo të jenë bankat ato që po përfitojnë nga xhepi i varfër i Kosovës.

Po ashtu, guvernatori tha se numri i kredive joperformuese është më i ulët se sa i të gjitha vendeve të rajonit. Kjo nuk ka ndikuar dukshëm në uljen edhe të kamatave. Ka ulje të kamatave të interesit dhe në të njëjtën kohë ka ulje të interesit edhe në depozita, kështu që sërish nuk janë qytetarët e vendit ata që po përfitojnë, po prapë janë bankat ato që vetëm sa i kanë rritur fitimet e tyre, përsëri në kurriz të qytetarëve, duke i rritur edhe shërbimet e tjera.

Edhe ulja e shpenzimeve të bankave prapë ka shkuar në dëm të klientëve dhe kjo dëshmohet edhe në numrin e rritur të ankesave, të cilët kanë ardhur nga klientët, i cili është rritur në vitin

2015 në krahasim me vitin 2014 dhe atë kryesisht në sektorin bankar, kryesisht në fushën e kredive.

Një fakt tjetër shqetësues natyrisht mbetet edhe mënyra e operimit të institucioneve mikrofinanciare, me theks të veçantë ato që e kanë statusin e beneficionit publik.

Mesatarja e normave të kamatave le që s'është zvogëluar, përkundër faktit se është zvogëluar numri i kredive joperformuese dhe po ashtu me licencimin e përmbaruesve tanimë këto institucione nuk kanë probleme në inkasimin e kredive, por është rritur kjo kamatë sidomos për kreditë që shkojnë për konsum familjar dhe në këtë vit norma e interesit ka shkuar në 24.4% dhe Banka Qendrore nuk ka bërë asnjë ndërhyrje. Ne e kuptojmë që ky është treg i lirë dhe do të duhej t'i rregullonte, megjithatë banka si institucion duhet të shërbejë si rregullator dhe mbi të gjitha ta ketë parasysh mbrojtjen e interesit publik karshi interesit të bizneseve, të cilat qëllimin kryesor e kanë thjesht fitimin e vet, edhe atëherë kur kjo ndoshta bëhet në kurriz të qytetarëve, të cilin interes do të duhej ta mbronte shteti, e në këtë rast përmes Bankës Qendrore.

Shqetësues, edhe një herë, mbetet mënyra e licencimit të bankave të huaja dhe këtu urgjentisht Qeveria e Kosovës do të duhej të bënte ndryshime të nevojshme ligjore dhe, siç e thashë edhe më herët, Banka Qendrore do të duhej të luante një rol më proaktiv këtu, ndoshta edhe duke ardhur me rekomandime të caktuara se si do të mund të përmirësohej kjo gjendje.

Kaq për momentin, kurse kolegët e mi do të shprehin edhe vërejtje të tjera në përmbajtje të raportit.

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë, "6+" dhe Lista serbe, nuk kemi diskutues. Tani i kemi edhe 5 diskutues. Zonja Salihe Mustafa e ka fjalën, le të përgatitet zotëri Zemaj.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj të falënderoj guvernatorin për këtë ekspozë gjithëpërfshirëse dhe për të shprehur vlerësimin tim të lartë për punën e suksesshme që po bën Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Me të vërtetë është kënaqësi të dëgjojmë tregimet e suksesshme në vendin tonë. Dhe një mundësi të tillë sot na e ka ofruar pikërisht raportimi i guvernatorit mbi të arriturat e Bankës Qendrore dhe zhvillimin e sistemit financiar.

Në kohën kur një pjesë e institucioneve tona ende vazhdon të ballafaqohet me sfida të ndryshme të ndërtimit të kapaciteteve, Banka Qendrore e Kosovës paraqet një ndër institucionet e pakta që në vazhdimësi ka marrë vlerësime të larta në raportet e institucioneve ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Komisioni Evropian, çka flet për një shembull të mirë të zhvillimit institucional që duhet ndjekur edhe institucionet e tjera të vendit.

Për sa i përket sistemit financiar, raportimi i guvernatorit për rritjen e kreditimit dhe rënien e normave të interesit në kredi, pa dyshim se paraqet një lajm shumë të mirë për vendin dhe në këtë kontest shfrytëzoj rastin të inkurajoj Bankën Qendrore që brenda kompetencave që ka të vazhdojë punën për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të financimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, e keni fjalën! Le të përgatitet zoti Topalli!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Pasi e kemi të pranishëm edhe guvernatorin, do të doja të shfrytëzoj rastin që, sipas mundësive, edhe të marrim përgjigje në pyetjet për çështjet që na interesojnë neve si deputetë për rolin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Konkretisht, fokusi im është te mbikëqyrja e licencimi që ka të bëjë me kompanitë e sigurimit, për Kartonin e Gjellbër.

Problemi i Kartonit të Gjellbër që nga paslufta është parë më shumë, ta quaj edhe në gjuhë pak më të ashpër, si plaçkitje e mërgimtarëve tanë, por edhe e banorëve të Republikës së Kosovës, të cilët duhet të paguajnë në dalje një shumë të madhe në shtetet që nuk e njohin sigurimin e Republikës së Kosovës dhe interesimi im është që të dimë se cilat janë përpjekjet e Bankës Qendrore që të licencohemi apo të anëtarësohemi për Kartonin e Gjellbër.

Shumat nuk do t'i përmendja këtu, sepse janë paraqitur edhe në raport, me të drejtë. Mund të kemi dilema në shpërndarjen e tyre, qoftë të premive të marra, por edhe premive të dhëna. Ajo mbetet në aspektin procedural të mbikëqyrjes, sepse shumat e premive të marra janë shumë të mëdha në raport me ato të shpërndara. E si dhe qysh, besoj se janë organet e tjera që këtë e përcjellin, edhe pse shpeshherë kemi ankesa nga qytetarët se këto vonohen, stërzgjaten dhe dëmet nuk paguhen në mënyrën e duhur dhe sipas ligjit.

Besoj se kjo problematikë duhet të ketë vëmendje të veçantë nga Kuvendi i Kosovës, edhe pse Komisioni për Buxhet e Financa, saktësisht në njërin prej viteve të fundit ka arritur bashkërisht me Qeverinë dhe Bankën Qendrore ta zvogëlojë shumën e pagesës, prapëseprapë kjo është një shtesë dhe taksë tatimore, e cila konsiderohet e pakuptimtë dhe e padrejtë për mërgimtarët tanë që jetojnë në botën e jashtme.

Zoti guvernator, ndoshta ju mund të na jepni një sqarim dhe mbi të gjitha të kemi edhe një pasqyrë apo premtim se si do të zgjidhet kjo çështje, sepse tanimë vetëm i kemi dëgjuar bisedimet që bëhen edhe me Brukselin, por sido që të jetë, mendoj se roli juaj është i pazëvendësueshëm dhe është kryesor në zgjidhjen e kësaj problematike, sepse është e padrejtë që sot e kësaj dite mërgimtarët tanë përballën me pagesën e padrejtë të kësaj takse tatimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Topalli e keni fjalën! Le të përgatiten zoti Mustafa dhe zoti Rexhepi!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti guvernator, Bedri Hamza,

BQK sigurisht se është një institucion i rëndësishëm, i cili përmes politikave të saj ka mundësi të marrë hapa të rëndësishëm në kuptimin e krijimit të kushteve për zhvillimit të vendit.

Mjerisht ky rol i BQK-së është reduktuar në mbledhjen dhe prezantimin e raporteve të bankave të tjera, por pa asnjë ndikim në krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik dhe politikave, të cilat pastaj kanë të bëjnë drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve.

Si shembull dua të marr kamatat e larta të bankave komerciale, të cilat janë sigurisht më të lartat në Evropë dhe nuk është mirë të krahasohen vetëm në rajon, por duhet krahasuar edhe me vendet e tjera. Kështu që në disa prej vendeve evropiane kemi kamata të cilat fillojnë me 0,8%, ndërsa te ne këtu, tek mikrofinancat paguajmë 24%, që në fakt këto mikrofinancat është dashur t'u ndihmojnë qytetarëve për të kaluara të caktuara, dhe nuk ka asnjë reagim të Bankës Qendrore për këtë çështje.

Kur është fjala për t'u mundësuar për t'u pasuruar, për të krijuar zhvillim, për t'u zhvilluar institucionet e huaja, thuhet se jemi treg i lirë. Ndërsa, kur është fjala për çështjet të cilat kanë të bëjnë me qytetarët tanë, qoftë në Kosovë, qoftë jashtë vendit, kjo çështja e tregut të lirë përfundon dhe unë do të lidhem me çështjen e Kartonit të gjelbër, ku Banka Qendrore e Kosovës, në kundërshtim me Ligjin për konkurrencën ka lejuar që të krijohet monopol sa i përket Kartonit të Gjelbër dhe ky monopol ekziston për disa vjet me radhë dhe nuk është bërë asnjë ndryshim deri tash.

Ka pasur shpesh arsye që - jo ne nuk mund të bëhemi pjesë e Kartonit të Gjelbër për arsye se Kosova nuk është pjesë e OKB-së. Kjo nuk qëndron, për arsye se Zvicra është pjesë e Kartonit të Gjelbër prej fillimit, ndërsa anëtare e OKB-së është bërë tek në vitin 2010. Pra, ky fakt nuk qëndron.

Pjesa tjetër, për të cilën dua të diskutoj, është kjo që raportin e kam shikuar në kuptimin më shumë nga aspekti çfarë përfitojnë qytetarët, çfarë është ndryshuar për jetën e shumicës së qytetarëve dhe cilat janë perspektivat që ata i kanë në zhvillimet e trendëve ekonomikë?

Banka Qendrore e Kosovës thotë se kemi një rritje prej 3.5% të produktit vjetor dhe se kjo rritje mbështetet në rritjen e kërkesave të brendshme, nga njëra anë nga rritja e konsumit dhe, nga ana tjetër, nga investimet private.

Në raportin e BQK-së, dhe kjo u përmend disa herë, thuhet se këtë vit remitenat u shtuan dhe arritën lartësi prej 752,4 milionë euro, që është një shumë bukur e madhe.

Financimi i pagave dhe pensione nuk vjen si rezultat i një ekonomie prodhuese, por ato në shumicën e tyre financohen prej tatimit, që do të thotë se paratë i marrin prej qytetarëve që konsumojnë dhe ua japin përsëri qytetarëve pa siguruar ndonjë vlerë të shtuar.

Në këtë kuptim, BQK mund të paraqesë rritje të produktit bruto vendor, por për qytetarët kjo nuk manifestohet në rritje të mirëfilltë të mirëqenies.

Realisht, rritja e remitenave, sado që ato janë të mirëseardhura, flet për një rritje të varfërisë në Kosovë. Sa më shumë që shtohen këto remitenca, do të thotë se aq më shumë shtohet varfëria në Kosovë sepse, përndryshe, mërgimtarët tanë nuk kishin pasur arsye për të dërguar remitenca, pasi që ata do t'i përmbushnin nevojat e tyre me mjetet që i krijojnë këtu.

Unë dua t'ju përkujtoj se nga Buxheti i Kosovës për këtë vit ndahen 549 milionë euro për paga e mëditje, ndërsa diaspora paguan 752 milionë, që i bie sa gjysma e Buxhetit të Kosovës, respektivisht 203,4 milionë më shumë se sa ato që i jep Qeveria për paga e mëditje.

E di që nuk është rast i përshtatshëm, por thjesht, për t'ju përkujtuar se kjo shumë e madhe e mjeteve, sa gjysma e Buxhetit të Kosovës, vjen nga ata mërgimtarë të Kosovës, të cilat disa i quajnë “shaci”, por ne edhe si Kuvend, edhe si Qeveri nuk ua lejojmë të drejtën elementare për të votuar, respektivisht teoretikisht me ligj ua lejojmë mundësinë, por praktikisht i përjashtojmë nga mundësia për të votuar në Kosovë.

22% e të gjitha familjeve në Kosovë jetojnë prej remitencave. Pra, kemi një rritje prej 3,5% të bruto produktit vendor, por në të njëjtën kohë një përkeqësim të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Prognozat për vitin e ardhshëm, duke u mbështetur në shifrat që ofron Banka Qendrore e Kosovës, nuk janë të mira.

Nëse vazhdohet me këtë trend, atëherë në vitin e ardhshëm gjendja nuk do të ndryshojë për shumicën e qytetarëve të Kosovës, sidomos kur e kemi para sysh që ajo që është duke u shtuar, janë kryesisht borxhet, respektivisht kreditë që i marrin qytetarët e Kosovës, duke pasur aktualisht një borxh për vitin 2015 prej 2.2 miliardë eurosh.

Mirëqenia e mirëfilltë në Kosovë është përmirësuar për bankat, sigurimet, institucionet mikrofinanciare, por jo edhe për qytetarët e varfër.

Raporti i BQK-së mund të miratohet dhe ai do të miratohet nga shumica parlamentare, por mund të them se është shumë i cektë dhe pa informacione të mjaftueshme për gjendjen ekonomike në vend, dhe sidomos me pak informacione për reagimet që i ka bërë BQK-ja.

Ky raport, megjithatë, sjell dy informacione të rëndësishme. Njëri informacion i dokumentuar me shifra të BQK-së është se kjo Qeveri, përkundër shumë premtimeve, nuk ka sjellë dhe nuk mund të sjellë zhvillim ekonomik.

Informacioni i dytë është, po ashtu, shumë i rëndësishëm se këtë vit, dhe sigurisht edhe në vitin e ardhshëm, nuk do të ketë ndryshime sa i përket gjendjes ekonomike në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Rexhepi dhe zoti Mustafa, janë dy deputetë që e marrin fjalën dhe e përfundojmë.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Përsëritës guvernatorin dhe mendoj është shumë pozitive se e kemi guvernatorin këtu të raportojë para Kuvendit. Besoj se kjo i kontribuon forcimit të rolit dhe pavarësisë së rolit kushtetues të Bankës Qendrore.

Mund të themi se Banka Qendrore një pjesë të funksionit të saj shumë të rëndësishëm që kujdeset për stabilitetin makroekonomik e ka kryer me sukses. Sistemi financiar në Kosovë është stabil, performansa e bankave është e mirë, mirëpo janë 3-4 çështje që në aspektin afatgjatë ne duhet t'i hulumtojmë edhe më thellë dhe duhet t'u japim rrugëzgjdhje.

E para është, le të mbesim te performansa e bankave. Fitimet e bankave të ne janë shumë të mëdha dhe norma e fitimeve të bankave në Kosovë është shumë më e madhe se sa në secilin vend në rajon, me përjashtim që në Shqipëri pak a shumë është e ngjashme, por është më e vogël se në Kosovë.

Kjo, natyrisht se për bankat është mirë, është një performansë e mirë, mirëpo ne duhet të shohim sa bankat janë bërë faktorë të zhvillimit dhe investimeve në Kosovë, konkretisht të sektorit privat dhe sektorit prodhues të Kosovës, eksportet në Kosovë.

Një fakt pozitiv që ka ndodhur, krahas normës së ulët të kredive joperformuese, është se ka rënë edhe norma e interesit. E kemi pasur gjithmonë një cak, është mbërritur diku rreth 7% ose nën 7% dhe ndoshta për disa kredi bankat i japin edhe normat më të ulëta, por në të njëjtën kohë, normat e interesit në depozita kanë rënë, por në të njëjtën kohë edhe janë rritur çmimet në shërbime të tjera, kështu që bankat realizojnë fitime për shkak të çmimeve në shërbimet e tjera, përpos kredive.

Unë mendoj se në të ardhmen duhet një analizë më e thellë dhe të shohim se kjo performansë e bankave, ky fitim në vit 70 milionë në vit, 100 milionë në vit, aty diku, që 70 milionë është sjellë në vitet e fundit, sa është rezultat i performansës së bankave, i uljes së shpenzimeve dhe rritjes së efikasitetit të tyre dhe sa është eventualisht rezultat i një pozite oligo-polistike, e cila nuk është e shkruar, por i bën të shtrenjta transaksionet bankare të ne, qoftë kreditë, qoftë shërbimet bankare. Dhe, në këtë mënyrë bankat kanë fitime të mëdha, por bizneset e tyre dhe kreditë e bizneseve sa po rriten. Ndoshta është mirë të analizohet ky fenomen në të ardhmen dhe kisha sugjeruar të analizohet në esencën e tij dhe të shohim çka duhet bërë, sepse bankat duhet të jenë në funksion të rritjes ekonomike dhe të investimeve dhe të stabilitetit makro-ekonomik dhe financiar.

Kjo është ajo çështje esenciale që ndoshta na duhen analiza më të thelluara, edhe të Bankës Qendrore, edhe të Ministrisë së Financave, edhe të faktorëve të tjerë. Kjo është çështja e parë që desha ta them.

Çështja e dytë, që nuk lidhet shumë drejtpërsëdrejti me Bankën Qendrore, por ndërlidhet me të, e kam theksuar edhe në diskutim për buxhetin se ne kemi diku të imobilizuar 30% të GDP-së. 30% e GDP-së të Kosovës është e imobilizuar, nuk qarkullon. Dhe, në qoftë se e kemi parasysh edhe importin e lartë që remitancat nuk multiplikohen me zhvillim këtu, për arsye se shkojnë në import të shërbimeve, atëherë ky është ai rezultati i një kontraktimi të ekonomisë së Kosovës dhe e kemi shumë vështirë të prodhojmë normë më të madhe të rritjes ekonomike, kur i kemi kaq mjete të imobilizuara dhe kur kemi kredi të tilla.

Prandaj, ne në aspektin zhvillimor dhe në aspektin e masave afatgjata duhet të shohim se çka mund të bëjmë që kjo pjesë e brutoprodhimit të GDP-së së Kosovës, që është e imobilizuar, qysh të kthehet në funksion ekonomik.

Natyrisht se këtu rolin kryesor e ka Ministria e Financave, por edhe Banka Qendrore duhet të mendojë, sepse Banka Qendrore është gardian dhe monitorues i këtyre mjeteve, i Trustit, i privatizimit dhe i shumë të tjerave. Domethënë, ju e keni detyrë për t'i ruajtur, e kuptoj, por

ndoshta duhet diskutuar dhe krijuar një taskforcë prej ekspertëve të brendshëm e të jashtëm se si këto mjete mund t'i fusim në funksion të tyre ekonomik.

Kjo ishte një çështje për të cilën ndoshta na duhen analiza edhe më të thella dhe unë për këtë dëshiroj të ketë sukses të mëtutjeshëm. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!
Përshëndetje për guvernatorin!

Edhe unë para pak ditësh e lexova raportin vjetor të Bankës Qendrore, por edhe sot, në parim e përkrah plotësisht fjalën dhe informatën që e dha para Kuvendit guvernatori i Bankës Qendrore, që besoj me shumë përkushtim është duke e udhëhequr Bankën Qendrore të vendit dhe sigurisht se është gardian i krejt asaj që u tha këtu, por edhe nga parafolësi, nga deputeti profesor Mustafa.

Unë meqë e mora fjalën po i bashkëngjitem vetëm pyetjes së fundit, për të marrë opinionin e guvernatorit lidhur me mjetet ose fondet të cilat janë jashtë vendit – cila do të ishte strategjia, mundësia e Bankës dhe po ashtu, edhe unë po them bashkë me institucionet që realisht këto mjete të vijnë në funksion të investimeve brenda vendit në një afat të mundshëm kohor sa më të shpejtë, në mënyrë që ajo që u tha nga ju, por edhe që e kemi përcjellë më herët, që nëse sot është GDP e vendit apo bruto produkti vendor me një shkallë të rritjes prej 4%, atëherë të shohim se në vitet në vijim a mund të arrijmë në 6, apo në 8, sepse nevojat janë të mëdha për investime dhe zhvillim ekonomik për t'i plotësuar ato nevoja të punësimit dhe zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Prandaj me opinionin tuaj do të dëshiroja të di se cila është mundësia dhe çka mendon guvernatori dhe Bordi i saj në ndryshimin e strategjisë për t'i vënë në funksion këto mjete? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zogaj.

BISLIM ZOGAJ: Unë do të mundohem të mos zgjatem, por desha ta falënderoj guvernatorin për një raport të shkëlqyeshëm dhe, mbi të gjitha, për atë që e ka prezantuar një realitet financiar që ekziston në Republikën e Kosovës dhe lirisht mund të themi se ky raport është një nga më të mirët e raporteve që vijnë në Kuvend, por edhe një nga sihariqet apo një nga rezultatet më të mira që ka një institucion në Kosovë, prandaj për këtë e përgëzoj për punën që është duke e bërë në kuadër të Bankës Qendrore të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, e kam edhe një vërejtje nga disa parafolës dhe për atë se në media shpeshherë flitet për provizione te pagesat. Unë mendoj se këtu nuk mund të ndikojë aq edhe Banka Qendrore kur dihet se pagesat varrojnë prej bankës në bankë dhe mund të zgjedhë qytetari se ku do t'i bëjë pagesat, dhe në ndërkohë mund të përdorë edhe teknologjinë informative, të cilët mund t'i kryejnë këto pagesa nga shtëpia dhe të mos akuzojnë shumë për çmime të larta.

Pra, më shumë e mora fjalën për të falënderuar guvernatorin për punën e bërë dhe për sigurimin e një sistemi stabil financiar në Kosovë. Faleminderit, zoti guvernator.

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka të tjerë të paraqitur për fjalë! Zoti guvernator, nëse e doni fjalën, mund ta merrni. Urdhëroni!

GUVERNATORI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dëshiroj t'i falënderoj deputetët për diskutimet e tyre. Besoj se me kujdes i kam përcjellë diskutimet dhe kam arritur t'i shënoj ato që u ngritën këtu dhe do të bëj përpjekje për t'i dhënë disa sqarime shtesë në çështjet që u ngritën nga disa deputetë dhe besoj se do të jap përgjigjen e njëjtë për të gjithë.

Do të filloj me zonjën Pantina, që njëherësh e falënderoj për diskutimin dhe për çështjen që e ka ngritur. Pra, sa i përket çështjes së tarifave, të cilat i aplikojnë bankat, nëse i referohem raportit, shihet se fitimi i bankave, dhe fillimisht ne e dimë se bankat janë ndërmarrje, e nuk janë organizata bamirëse dhe qëllimin e fundit e kanë fitimin, profitin. Për atë edhe themelohen, mirëpo nuk del se fitimi i bankave ka ardhur si rezultat i rritjes së të hyrave të bankave, por ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të bankave që kryesisht i referohen zvogëlimit të normës së interesit në depozita dhe stabilitetit të kredive joperformuese dhe zvogëlimit të tyre. Bankat nuk kanë pasur nevojë të ndajnë provizione për mbulimin e kredive joperformuese dhe kjo ka reflektuar edhe në afarizmin pozitiv të bankave.

Sa i përket çmimit të tarifave, kjo është ekonomi e lirë e tregut, por si Bankë Qendrore kemi marrë veprime që kemi licencuar edhe një numër të institucioneve të tjera dhe institucione financiare jobankare që kanë të drejtë të merren me çështjen e pagesave dhe pastaj mbeten në autoritetin e atyre që bëjnë pagesa, personave fizikë e juridikë dhe në këtë rast ne kemi dhënë licencën edhe për një kompani publike dhe ju them qartë se për të njëjtin shërbim në një institucion financiar mund të paguash edhe 3 euro, por për të njëjtin shërbim në institucion financiar tjetër mund të paguash 50 centë.

Prandaj unë i inkurajoj dhe i thërras të gjithë qytetarët e të gjitha bizneseve që ta zgjedhin institucionin ku realisht paguajnë më së paku.

Sa i përket statusit të bankave, që janë të regjistruara si degë dhe si subjekte të varura, nuk e kanë statusin e subjekteve të varura vetëm dy bankat lokale, por e kanë edhe një numër tjetër i bankave të huaja që janë me kapital të jashtëm që janë bankat e Kosovës, e kanë të njëjtin statut. Do të thotë nuk e kanë vetëm dy bankat lokale, por e kanë një numër i konsiderueshëm i bankave. Dhe unë besoj që në një të ardhme Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta adresojë këtë çështje dhe do të vijë në një situatë ku të gjitha bankat do ta kenë statusin e njëjtë që të jenë subjekte të varura.

Pyetja, pse në të kaluarën është aprovuar ligji në këtë format çfarë është, kjo ngase ka qenë një ligj, i cili është sponsorizuar dhe ka qenë pjesë e programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe është i draftuar prej Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe i është njohur e drejta që bankat në Kosovë të kenë mundësi të regjistrohen si degë të bankave të huaja dhe si subjekte të varura.

Pjesa më e madhe e bankave, sidomos bankat e mëdha, janë të regjistruara si subjekte të varura.

Sa u përket të drejtave në treg, i kanë të drejtat e njëjta. Dhe sa u përket obligimeve, unë jam, e kam thënë edhe në Komision për Buxhet e Financa, e po e them edhe sot në këtë Kuvend të nderuar, se jam në përkrahje të asaj që ligji, në momentin e parë, kur hyn në procedurë të amendamentimit, të ketë një trajtim të barabartë me të gjitha subjektet që veprojnë në këtë fushë.

Kosova nivelin e kredive joperformuese, po flas me të dhënat e qershorit të këtij viti, e ka 5.3, që është diçka shumë pozitive, mirëpo realisht se ka ndikuar në normën e interesit. Sepse, nëse e shikojmë normën e interesit dhe historikun e normës së interesit dhe kthehemi para 3-4 vjetëve del se mesatarja e normës së interesit, po flas për mesataren efektive të normës së interesit, ka qenë 14 - 15% dhe është zvogëluar brenda 3-4 viteve të fundit për më shumë se 50%. Dhe nëse flasim për normën e interesit në vendet e regjionit, i kam të dhënat zyrtare të muajit të tretë të këtij viti, Kosova normën mesatare të interesit e ka 7,45. Mali i Zi 8,04, Shqipëria 5,32, Maqedonia 5,07, Bullgaria 7,63 dhe Bosnja e Hercegovina 7,83. Do të thotë, Kosova, prej një norme të interesit prej 14 deri 15%, brenda 3-4 vjetëve të fundit është zvogëluar në mesataren e vendeve të regjionit.

Kur jemi te norma mesatare e interesit, këtu përfshihen të gjitha llojet e kredive, mirëpo realisht bizneset, po edhe qytetarët, ata që kanë krijuar një historik, ata që kanë një kolateral, ata që kanë treguar një disiplinë, sot janë duke realizuar kredi me normë të interesit prej 4 deri 7 - 8%. Aty sillen normat e interesit.

Sa i përket çështjes së trajtimit të ankesave. Ne, me qëllim që t'i njohim edhe të drejtat e konsumatorit, kemi krijuar departament të veçantë brenda Bankës Qendrore për trajtimin e ankesave, dhe mbi bazën e ankesave të klientëve të bankave, të personave fizikë dhe juridikë, Banka Qendrore shpeshherë ka marrë edhe vendime, të cilat i ka sanksionuar institucionet financiare. Nuk është dëshirë e jona që ne t'i sanksionojmë, mirëpo nëse ka shkelje të ligjit, nëse ka shkelje të drejtës së konsumatorit, sidomos sa i përket shpalosjes së normës efektive të interesit, ka pasur sanksione dhe vendime në këtë drejtim.

Sa i përket çështjes së Kartanit të Gjelbër, nuk është qëllimi që Banka Qendrore të ikë nga përgjegjësia. Mirëpo, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin për sigurimet e detyrueshme nga auto-përgjegjësia.

Neni 17 i këtij ligji, që është besoj vullnet dhe dëshirë e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës dhe të gjitha institucioneve të Kosovës që bashkatdhetarët tanë, edhe pse është zvogëluar çmimi i policës kufitare dhe është 15 euro, edhe pse është më i liri në regjion, sepse e dimë, të gjithë udhëtojmë, por prapëseprapë nuk është arritur ajo çka ne dëshirojmë dhe çka ata donë. Te qytetari i Republikës së Kosovës që jeton në diasporë nuk është veç aspekti material sa paguan, por është edhe procedura dhe nuk dëshiron që në kufi të vendit të vet, për të cilin ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë, të ndalet e të maltretohet me ato procedura. Mirëpo, ligji – neni 17, thotë: “Drejtuesi i mjetit motorik, me regjistrimin e huaj i cili nuk ka një dokument ndërkombëtar të vlefshëm të sigurimit të auto-përgjegjësisë, sipas paragrafit 1 të nenit 16 të këtij ligji, është i detyruar të lidhë kontratë të sigurimit kufitar të auto-përgjegjësisë të vlefshme për territorin e Republikës së Kosovës”. Është çështje e ligjit.

Përgjegjës për Kartonin e Gjellbër dhe për këtë çështje, ky ligj, kreu 3, ku flet për Byronë Kosovare të Sigurimeve, thotë: “Byroja Kosovare e Sigurimeve është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllim jofitimprurës. Qeveria e Republikës së Kosovës i njeh këtij institucioni statusin e Byrosë Nacionale të Sigurimit me të drejtat e pakufizuara në cilësinë e byrosë së pagesave dhe byrosë trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve sa i përket Kartonit”.

Do të thotë përgjegjësinë ligjore, sa i përket policës kufitare dhe Kartonit të Gjellbër, është e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, që është e themeluar me ligj të veçantë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka bërë përpjekje edhe jashtë kompetencave ligjore të japë kontribut në këtë drejtim.

Shumë prej kushteve të cilat i ka kërkuar Byroja Evropiane e Kartonit të Gjellbër, janë përmbushur: themelimi i Byrosë; krijimi i Qendrës informative; formimi i Fondit të Kompensimit, mirëpo në kërkesën që e ka bërë byroja, dhe prapë po them byroja, jo Banka Qendrore, se ata janë përgjegjës, është kthyer përgjigja se Kosova ka nevojë të jetë edhe anëtare e Kartonit të Gjellbër.

Kemi raste edhe për çështje të tjera, siç ka qenë Swift-kodi bankar. Edhe aty për herë të parë Kosova është anëtarësuar pa qenë e listuar në Kombet e Bashkuara.

Unë besoj se të gjitha institucionet do të bëjnë përpjekje që këtë çështje ta shtyjme përpara.

Ka praktika ku është përdorur edhe Kartoni i Gjellbër i vendit të tretë. Jemi në negociatë, kemi biseduar, to të ishte më e lehta, më e mira të merret Kartoni i Gjellbër i Republikës së Shqipërisë. Mirëpo, për shkak të vështirësive të cilat ata i kanë, një gjë e tillë Byroja Evropiane e Kartonit të Gjellbër nuk e ka lejuar.

Jemi duke biseduar edhe me shtete të tjera që ndoshta në një të ardhme kemi mundësi të jemi shfrytëzues të Kartonit të Gjellbër deri sa të gjendet një alternativë tjetër.

U përmendën remitencat dhe varfëria. Jo remitencat nuk e rrisin varfërinë në Kosovë. Është mirë të rritet prodhimi i brendshëm, është mirë të rriten eksportet, është mirë të zvogëlohen importet, është mirë të rritet punësimi, por edhe nëse rritet punësimi, edhe nëse rritet prodhimi i brendshëm dhe të gjitha këto ndodhin, prapëseprapë remitencat s’e varfërojnë Kosovën, por e pasurojnë Kosovën, prandaj unë uroj që të vazhdojë kjo lidhje e qytetarëve të Kosovës me familjarët e tyre dhe ata të vazhdojnë të dërgojnë remitenca në Kosovë, sepse ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe është më mirë të kanalizohen në investime, por edhe në konsum që e kanë kontributin e vet në rritjen ekonomike.

Fitimi i bankave. Bankat janë institucione, janë ndërmarrje që ato nuhasin në fitime. Po, realisht, do të ishte shumë shqetësuese, më shumë bile se shqetësuese, sikur bankat të mos kenë performansa të mira.

Ne duhet të punojmë të gjithë së bashku që të lehtësohet qasja në kredi, të zvogëlohen normat e interesit, të rritet kreditimi, edhe pse, realisht e shikojmë raportin, del se rritja e kreditimit është 100% më shumë se sa rritja ekonomike e vendit. Është rritja më e madhe e kreditimit në krejt vendet e regjionit. Nëse u referohemi të dhëna të gjashtëmujorit të këtij viti, rritja e kreditimit është 9%, ndërsa po shohim se rritja ekonomike po sillet diku në mes 3 dhe 4%, prandaj një prej kontribuesve të mëdhenj në rritjen ekonomike të vendit është edhe çështja e kreditimit.

Mjetet jashtë vendit. Banka Qendrore i ka në dispozicion disa fonde që janë pjesë e bilancit bankar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Fondit të Privatizimit. Ne jemi ithtarë dhe përkrahës të asaj që është mirë se është kompletuar Bordi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe urojmë që sa më shpejt të përmbyllen procedurat e procesit të likuidimit, të kompensohen kreditorët potencialë dhe tepricat nga ky fond të vijnë e derdhen në buxhetin e Kosovës dhe Kuvendi vendos për destinimin e këtyre mjeteve.

Në situatën aktuale, realisht Banka Qendrore ka vështirësi shumë të madhe në menaxhimin e këtyre fondeve për shkak të ecurive në tregjet financiare, që dihet se normat e interesit janë negative në shumicën e instrumenteve dhe letrave me vlerë të qeverie të vendeve evropiane, po edhe në llogari rrjedhëse.

Kjo ishte një përpjekje për të përmbledhur dhe në mënyrë telegrafike t'i jap disa përgjigje dhe unë, edhe një herë, ju falënderoj për kontributin dhe në çdo kohë, e në çdo moment jemi të gatshëm të japim sqarime dhe informata shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju deputetë të “Vetëvendosjes”, që jeni paraqitur pas kohës, nuk keni të drejtë të diskutoni pas ministrit dhe prapa raportuesit. Debati zhvillohet pas raportit. Si do që të jetë, unë me kërkesë të kryetarit të Kuvendit po jua jap fjalën, të dyve, fjalën e ka Shqipe Pantina. Unë e kam për detyrë ta interpretoj Rregulloren.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Guvernator, është e vërtetë se bankat i vendosin vetë tarifat. Aty në raport nuk përmendet, dhe tani ju e thatë se keni licencuar një institucion publik. Ne javën e kaluar kemi marrë në Komision për Buxhet një kërkesë nga Posta e Kosovës, e cila po punon me humbje dhe për deri sa ajo do të mund të kryente shërbime të cilat do t'i ndihmonin qytetarit, sepse në fund të fundit interesi ynë është që të përfitojë qytetari. Është e rëndësishme që edhe bankat, në këtë rast si ndërmarrje, të mos punojnë me humbje, por interesi ynë dhe institucionet janë të thirrura për mbrojtje të interesit të qytetarit, e qytetari ynë sot paguan deri në 5 euro vetëm për një transfer bankar, kështu që ne shpresojmë se së shpejti ky institucion publik do të funksionalizohet dhe e shoh se ka mundësi kur shteti ndërhyr për të ndihmuar qytetarët.

Është e vërtetë se ka ulje të kamatave, do të thotë të interesit të kamatave në kredi, por ju thatë se ato janë prapë më të lartat në rajon, dhe ju nuk përmendët se janë ulur edhe depozitat.

Kamata e interesit në depozita, në fakt është vetëm 1,2%. Prapë mbetet 6,5% dallimi në mes të interesit në kamata dhe interesit në depozita. Edhe remitencat vazhdojnë ta mirëmbajnë varfërinë. Ndoshta ato nuk e rrisin, por thjesht, e mirëmbajnë, sepse po të gjendeshin politika dhe ka mundësi që shteti e në këtë rast edhe banka të mendojnë në formë kreative që këto remitenca

të kanalizohen ndryshe dhe në mënyrë që nuk do të ndikonin në rritjen e importit, por thjesht të ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik.

KRYESUESI: Faton, të lutem, shkurt!

FATON TOPALLI: Po, po i bie shkurt, sepse po shoh mazhoranca është lodhur, edhe pse ka pushuar për dy orët e para, por nuk është lodhur vetëm për këtë diskutim, por në përgjithësi është lodhur.

Unë desha ta sqaroj vetëm një çështje që, sa i përket remitencave, nuk thamë se ato shkaktojnë varfëri në Kosovë. Thashë se remitencat tregojnë se varfëria në Kosovë po rritet. Këtë desha ta sqaroj.

Dhe e dyta. Sa i përket Kartonit të gjelbër, e pata një pyetje shumë konkrete, në të cilën guvernatori nuk m'u përgjigj. Ai tha se për shërbime bankare mund të shkohet në banka të ndryshme. Më tregoni mua, si mërgimtar, në qoftë se vij në Kosovë, çfarë shërbime të tjera mund të marr, për arsye se kjo çështje është monopolizuar.

Detyrë e bankës është që ta pengojë monopolin. Me ligj është, ju keni lejuar monopol. Më tregoni pse po lejoni monopolin të Kartoni i Gjelbër?

Kjo çështje nuk është zgjidhur për arsye se këto shoqata të sigurimit kanë interes dhe kanë përfutur rreth 200 milionë euro viteve të fundit.

Pyetja ime është: Çka po bën Banka për ta thyer këtë monopol, të cilin e ka edhe për detyrë ligjore, sepse nuk duhet të lejojë të krijohet monopoli? Vetëm në këtë pyetje, ju lutem, më jepni përgjigje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza, dy fjalë dhe do të votojmë.

GUVERNATORI BEDRI HAMZA: Edhe një herë, faleminderit deputete Pantina dhe deputet Topalli. Sa i përket licencimit të kompanisë publike PTK, është e licencuar si institucion financiar jobankar dhe kryen shërbime të pagesave. E ka licencën dhe kryen.

Sa i përket çështjes së Kartoni të Gjelbër, ligji të cilin e ka aprovuar ky Kuvend ia ka dhënë këtë të drejtë Byrosë Kosovare të Kartoni të Gjelbër, dhe nuk mundet Banka Qendrore në një çështje që e ka rregulluar Kuvendi me ligj të veçantë, Banka Qendrore jashtë kompetencave të veta të veprojë. Këtë e ka rregulluar Kuvendi me ligj të veçantë. Byrosë Kosovare të Sigurimeve ia ka dhënë këtë përgjegjësi, prandaj kur Kuvendi vendos që mund të ketë edhe ndonjë institucion tjetër që të merret me këtë punë, është çështje e Kuvendit.

(Ndërrhyrje)

Jo e Bankës Qendrore, sepse Kuvendi është më i madh se ne.

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se diskutimet kanë përfunduar. Kemi numër të mjaftueshëm për të votuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Mund të përsërisim, por tash s'ka numër të mjaftueshëm të deputetëve. Dolën dhe s'ka numër të mjaftueshëm.

59 deputetë janë në sallë, prandaj këtë do ta votojmë në seancën e ardhshme.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*